

**FRANÇESKU**

**KRISHTI  
JETON**

***(CHRISTUS VIVIT)***

NXITJE APOSTOLIKE  
PAS-SINODALE  
DREJTUAR TË RINJVE  
DHE TË GJITHË POPULLIT  
TË HYJIT

*PËRKTHYESJA*  
ANGJELINA GJEKA

*LEKTORI*  
DOM PREKA LAZRI

*REDAKTORJA*  
LORETA TOMAJ

*FAQOSJA DHE GRAFIKAT*  
LUIGJ MILA

© Copyright: [www.vatican.va](http://www.vatican.va)

© Copyright në shqip  
ARQIPESHK VIA METROPOLITANE  
SHKODËR-PULT

Shtypur  
SHTYPSHKRONJA “VOLAJ”

GUSHT 2019

## PARAQITJE

Mes këtij dokumenti dhe dokumenteve të tjera të kolanës së gjatë që kemi botuar, me dëshirën që të gjithë t'i lexojnë në gjuhën shqipe Mësimet e Papëve dhe të Kishës, ka një ndryshim thelbësor: ndërsa dokumentet e tjera i drejtoheshin çdo gjymtyre të Kishës, kjo Nxitje i drejtohet në mënyrë të veçantë të rinjve, si edhe të gjithë besimtarëve.

Është rezultati i rrugëtimit sinodal të Kishës, që e ka trajtuar këtë temë me të rinjtë, duke u bërë më e vetëdijshme për rëndësinë dhe rolin që të rinjtë kanë në të.

Kjo Nxitje na bën më të vetëdijshëm si për rezultatin e këtij ballafaqimi sinodal, ashtu edhe për mendimin e Papa Françeskut në lidhje me të rinjtë e sotëm katolikë, aq të ndryshëm prej një modeli me të cilin, ideologjikisht, ishim mësuar.

Në këtë Nxitje vihen re dëshirat që të rinjtë kanë ndaj Kishës, si edhe ndjenja e madhe e përgjegjësisë që del prej zemrës së Papës dhe prej të gjithë barinjve për këta besimtarë katolikë, që jo vetëm janë e ardhmja, siç thuhet zakonisht, por pikë së pari janë e tashmja e Kishës dhe e shoqërisë ku ata jetojnë.

Të rinjtë, sipas Papës, janë stimuli i nevojshëm për ripërtëritjen e Kishës, për të cilën aq shumë është duke u folur kohët e fundit, në përpjekjen ungjillore për të gërshetuar të vjetrën me të renë, vlerën e përjetshme me mënyrën e vënies së saj në jetë, që mund dhe duhet të ndryshojë, me qëllim që mesazhi dhe vetë jeta e Jezusit të mbeten gjithnjë të gjalla, të freskëta dhe aktuale.

Shqipëria është një komb me një përqindje të lartë të rinjsh dhe, si rrjedhojë, Kisha në Shqipëri është Kisha me përqindjen më të lartë të të rinjve, fytyrat e të cilëve Papa Françesku i ka parë pesë vite më përpara.

Shumë prej ftesave që bëhen në këtë Nxitje duket se janë menduar duke na shikuar neve dhe situatën tonë aktuale; do të ishte mëkat nëse kjo Nxitje nuk do të shkonte, e përkthyer, në duart e secilit prej të rinjve tanë. Kjo është dëshira e Papës dhe ne e ndiejmë për detyrë që ta plotësojmë atë.

Uroj që çdo bashkësi e krishterë e Kishës sonë të bëhet ndërmjetëse, që çdo adoleshenti dhe çdo të riu t'i jepet një kopje e kësaj Nxitjeje. Po ashtu, uroj që të bëhen takime, gjatë të cilave kjo Nxitje të paraqitet, të lexohet dhe të reflektohet, si edhe, duke u nisur prej saj, të mendohet për një mënyrë të re të përfshirjes së të rinjve në strukturat tona kishtare: freskia e rinisë së tyre – jam i bindur – do të sjellë një erë të re edhe për Kishën tonë në Shqipëri.

Po ashtu, uroj që kjo Nxitje të kontribuojë në uljen e numrit të të rinjve që largohen nga Shqipëria dhe të shtojë guximin tonë për të krijuar mundësi të reja realizimi të tyre, pavarësisht brishtësisë së strukturave sociale dhe politike të vendit tonë në këtë moment delikat që ai po kalon.

Me këto shpresa në zemër ia besoj shtëpisë botuese këtë përkthim, shoqëroj shpërndarjen dhe përdorimin e tij me lutjen time drejtuar Trinisë së shenjtë, duke thirrur ndërmjetësinë e Martirëve tanë, sidomos të më të rinjve prej grupit të të Lumëve, ndërsa ju jap bekimin tim.

*Shkodër, më 29 qershor, e Kremtja e Shën Palit dhe e Shën Pjetrit, të vitit 2019.*

† **Imzot Angelo Massafra O.F.M.**  
Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult

1. **KRISHTI JETON.** Ai është shpresa jonë dhe rinia më e bukur e kësaj bote. Gjithçka që Ai prek bëhet e re, mbushet me jetë. Prandaj, fjalët e para që dua t'i drejtoj çdo të riu të krishterë janë: Ai jeton dhe do që edhe ti të jetosh!

2. Ai është në ty, Ai është me ty dhe nuk ikën kurrë. Sado që të largohesh, pranë teje është i Ngjalluri, që të thërret dhe që të pret për t'ia rifilluar. Kur ndihesh plak prej trishtimit, inateve, frikave, dyshimeve apo dështimeve, Ai do të jetë aty për të të ridhënë forcë dhe shpresë.

3. Të gjithë të rinjve të krishterë ua shkruaj me dashuri këtë Nxitje apostolike, domethënë një letër që përkujton disa bindje të fesë sonë dhe, në të njëjtën kohë, nxit për t'u rritur në shenjtëri dhe në angazhimin për thirrjen personale. Megjithatë, meqenëse bëhet fjalë për një gur themeli brenda një ecjeje sinodale, i drejtohem njëkohësisht gjithë Popullit të Hyjit, barinjve dhe besimtarëve, meqë reflektimi mbi të rinjtë dhe për të rinjtë na thërret e na nxit të gjithëve ne. Prandaj, në disa paragrafë do t'u flas drejtpërdrejt të rinjve dhe në të tjerë do të paraqes qasje më të përgjithshme për shohitjen kishtare.

4. Më ka frymëzuar pasuria e reflektimeve dhe e dialogjeve të Sinodit të vitit të kaluar. Nuk do të t'i përmbledh këtu të gjitha ndihmesat, të cilat mund t'i lexoni në Dokumentin Përfundimtar, por jam përpjekur të marr, në hartimin e kësaj letre, propozimet që më dukeshin më domethënëse. Në këtë mënyrë, fjala ime do të pasurohet prej mijëra zërave të besimtarëve të të gjithë botës, që i kanë sjellë mendimet e tyre në Sinod. Edhe të rinjtë jo besimtarë, që kanë dashur të marrin pjesë me reflektimet e tyre, kanë paraqitur çështje që më kanë bërë të mendoj.

## KAPITULLI I PARË

### Ç'THOTË FJALA E HYJIT NË LIDHJE ME TË RINJTË?

5. Le të shqyrtojmë disa thesare të Shkrimit të shenjtë, në të cilin disa herë flitet për të rinjtë dhe për mënyrën se si Zoti u del atyre përpara.

#### NË BESËLIDHJEN E VJETËR

6. Në një epokë në të cilën të rinjtë kishin pak rëndësi, disa tekste tregojnë se Hyji shikon me sy të tjerë. Për shembull, shohim se Jozefi ishte pothuajse më i vogli i familjes (krh. Zan 37,2-3). Megjithatë, Hyji i komunikoi gjëra të mëdha në ëndërr dhe ai ua kaloi të gjithë vëllezërve të vet në detyra të rëndësishme kur ishte rreth njëzet vjeç (krh. Zan 37-47).

7. Te Gjedeoni shohim sinqeritetin e të rinjve, që nuk e kanë zakon ta ëmbëlsojnë realitetin. Kur iu tha se Zoti ishte me të, ai u përgjigj: «Nëse Zoti është me ne, pse na gjetën të gjitha këto të zeza?» (Gjq 6,13). Por Hyji nuk u bezdis prej atij qortimi dhe ia dyfishoi rrezikun: «Me atë fuqi që ke shko dhe çliroje Izraelin» (Gjq 6,14).

8. Samueli ishte një i ri i pasigurt, por Zoti komunikonte me të. Falë këshillës së një të rrituri, e hapi zemrën e vet për të dëgjuar thirrjen e Hyjit: «Fol, o Zot, se të dëgjon shërbëtori yt» (1 Sam 3,9,10). Prandaj ishte profet i madh, pasi ka ndërhyrë në momente të rëndësishme për atdheun e vet. Edhe Sauli mbret ishte ende djalë i ri kur Zoti e thirri për të kryer misionin e tij (krh. 1 Sam 9,2).

9. Davidi mbret u zgjodh kur ende ishte djalë i ri. Kur Samueli profet ishte duke kërkuar mbretin e ardhshëm të Izraelit, një njeri i paraqiti si kandidatë djemtë e vet më të mëdhenj dhe më të ditur. Por, profeti i tha se i parazgjedhuri ishte Davidi, që kulloste delet (krh. 1 Sam 16,6-13), sepse «njeriu sheh çka duket përjashta, kurse Zoti vëren zemrën» (rr. 7). Lavdia e rinisë gjendet në zemër më shumë sesa në forcën fizike apo në përshtypjen që ngjall te të tjerët.

10. Salomoni, kur duhej të pasonte të atin, u ndie i përhumbur dhe i tha Hyjit: «Unë jam djalosh i ri dhe nuk di si duhet mbretëruar» (1 Mbr 3,7). Megjithatë, guximi i rinisë e nxiti t'i kërkonte Hyjit urtinë dhe iu kushtua misionit të tij. Diçka e ngjashme i ndodh Jeremisë profet, i thirrur për ta zgjuar popullin kur ishte ende shumë i ri. Me druajtjen e vet tha: «Eheu, o Zot Hyj! Po, unë nuk di të flas, sepse jam fëmijë» (Jer 1,6), por Zoti i kërkoi të mos thoshte ashtu (krh. Jer 1,7) dhe shtoi: «Mos ki kurrfarë frike para tyre, sepse unë jam me ty për të të mbrojtur» (Jer 1,8). Përkushtimi i Jeremisë profet ndaj misionit të tij tregon se çfarë mund të bëhet nëse bashkohen freskia e rinisë dhe fuqia e Hyjit.

11. Një vajzë hebreje, që ishte në shërbim të ushtarit të huaj Naaman, ndërhyri me fe për ta ndihmuar që të shërohej prej sëmundjes së tij (krh. 2 Mbr 5,2-6). Ruta e re është një shembull bujarie, meqë zgjodhi të qëndronte me vjehrrën e vet fatkeqe (krh. Rt 1,1-18) dhe dëftoi edhe guximin e vet për të ecur përpara në jetë (krh. Rt 4,1-17).

#### NË BESËLIDHJEN E RE

12. Një shëmbëlltyrë e Jezusit (krh. Lk 15,11-32) tregon se djali “më i ri” dëshiroi të largohej prej shtëpisë së të atit drejt një vendi të largët (krh. rr. 12-13). Por ëndrrat e tij për autonomi u shndërruan në shkapërderdhje e vese (krh. rr. 13) dhe përjetoi ashpërsinë e vetmisë e të varfërisë (krh. rr. 14-16). Megjithatë, që i aftë të ndërronte mendje për t'ia rifilluar (krh. rr. 17-19) e vendosi të ngrihej (krh. rr. 20). Një zemër e re është e gatshme për ndryshim, është në gjendje të ringrihet dhe të mësojë prej jetës. Si të mos shoqërohet djali në këtë sipërmarrje të re? Por, vëllai më i madh tashmë kishte një zemër të vjetër dhe ia lejoj vetes të zotërohej prej grykësisë, egoizmit dhe smirës (krh. rr. 28-30). Jezusi e lëvdon të riun mëkatar që i kthehet rrugës së mirë më shumë sesa atë që beson se është besnik, por nuk e jeton shpirtin e dashurisë dhe të mëshirës.

13. Jezusi, përjetësisht i riu, dëshiron të na dhurojë një zemër gjithmonë të re. Fjala e Hyjit na kërkon: «Pastrohuni prej tharmit të vjetër që të bëheni brumë i ri» (1 Kor 5,7). Në të njëjtën kohë, na fton të zhvishemi prej «njeriut të vjetër» për t'u veshur me njeriun «e ri» (krh. Kol 3,9.10).<sup>[1]</sup> Dhe kur shpjegon se çfarë do të thotë të vishesh me atë rini «që përtërihet» (rr. 10), tregon se do të thotë të jemi «me zemër të dhimbshme, me mirësi, me përvujtëri, me butësi, me duresë. Durojeni njëri-tjetrit dhe faleni njëri-tjetrit në qoftë se ndokush ka ndonjë ankim kundër tjetrit» (Kol 3,12-13). Pra, rini e vërtetë do të thotë të kemi një zemër që është e aftë të dojë. Anasjellas, shpirtin e plak gjithçka që na ndan prej të tjerëve. Ja përse përfundon kështu: «Përmbi të gjitha vishuni me dashurinë! Ajo i mban së bashku të gjitha virtytet» (Kol 3,14).

14. Vërejmë se Jezusit nuk i pëlqente fakti se të rriturit i shikonin me përbuzje më të rinjtë ose i mbanin në shërbim të tyre në mënyrë despotike. Përkundrazi, kërkonte: «Më i madhi ndër ju të jetë si të ishte më i riu» (Lk 22,26). Për Të, moshë nuk përcaktonte privilegje dhe nëse ndokush ishte më i ri nuk donte të thoshte se vlente më pak apo se kishte më pak dinjitet.

15. Fjala e Hyjit pohon se të rinjtë duhet të trajtohen «si vëllezër» (1 Tim 5,1) dhe i porosit prindërit: «Mos i tutukatni fëmijët tuaj që të mos e humbin guximin» (Kol 3,21). Një të riu nuk mund t'i hiqet guximi, karakteristikë e tij është të ëndërrojë gjëra të mëdha, të kërkojë horizonte të gjera, të guxojë më shumë, të ketë dëshirë ta pushtojë botën, të dijë të pranojë propozime angazhuese dhe të dojë të japë maksimumin e vet për të ndërtuar diçka më të mirë. Prandaj

këmbëngul që të rinjtë të mos lejojnë t'u vidhet shpresa dhe secilit i përsëris: «Askush të mos e përbuzë moshën tënde të re» (1 Tim 4,12).

16. Megjithatë, në të njëjtën kohë të rinjtë porositen: «Dëgjojini eprorët» (1 Pjt 5,5). Bibla na fton gjithmonë të kemi një respekt të thellë për të moshuarit, sepse ata zotërojnë një përvojë të madhe, kanë përjetuar sukseset dhe dështimet, gëzimet dhe dhimbjet e mëdha të jetës, shpresat dhe zhgënjimet, dhe në heshtjen e zemrës së tyre ruajnë shumë histori që mund të na ndihmojnë të mos gabojmë dhe të mos mashtrohemi prej mirazheve. Fjala e një të moshuari të urtë na fton që t'i pranojmë disa kufizime dhe të dimë ta përmbajmë veten në momentin e duhur: «Nxiti të rinjtë që të jenë të përkormë» (Tit 2,6). Nuk është mirë të biem në kultin e rinisë, ose në një qëndrim rinor që i përbuz të tjerët për moshën e tyre apo sepse janë të një epoke tjetër. Jezusi thoshte se personi i urtë di të nxjerrë gjëra të reja dhe gjëra të vjetra prej thesarit të vet (krh. Mt 13,52). Një i ri i urtë i hapet të ardhmes, por është gjithmonë i aftë t'i japë vlerë diçkaje që i përket përvojës së të tjerëve.

17. Në Ungjillin e Markut shfaqet një person që, kur Jezusi i kujton urdhërimet, pohon: «Të gjitha këto i kam zbatuar që prej rinisë sime» (10,20). E thoshte edhe Psalmi: «Ti, o Zot, je shpresa ime, shpresa ime, o Zot, që prej rinisë sime. [...] Ti më ke mësuar, o Hyj, që prej rinisë sime dhe ende sot i kumtoj mrekullitë e tua» (Ps 71,5.17). Njeriu nuk duhet të pendohet se e shpenzon rininë e vet duke qenë i mirë, duke ia hapur zemrën Zotit, duke jetuar në një mënyrë tjetër. Asnjëra prej këtyre nuk na e heq rininë, por e forcon dhe e përtërin atë: «Do të përtërihet si e shqiponjës rinia jote» (Ps 103,5). Prandaj Shën Agustini ankohej: «Vonë të desha, o bukuri kaq e vjetër dhe kaq e re! Vonë të desha!».<sup>[2]</sup> Megjithatë, djali i pasur, që i kishte qëndruar besnik Hyjit në rininë e vet, lejoi që vitet t'ia merrnin ëndrrat dhe parapëlqeu të mbetej i lidhur me pasuritë e veta (krh. Mk 10,22).

18. Ndërsa në Ungjillin e Mateut shfaqet një i ri (krh. Mt 19,20.22) që i afrohet Jezusit për të kërkuar më shumë (krh. rr. 20), me atë shpirt të hapur tipik të të rinjve, në kërkim të horizonteve të reja dhe të sfidave të mëdha. Në të vërtetë, shpirti i tij nuk ishte aq i ri, sepse tashmë ishte kapur pas pasurive dhe rehatisë. Me gojë pohonte se donte diçka më shumë, por kur Jezusi i kërkoi të ishte bujar dhe t'ua shpërndante pasurinë të varfërve, djaloshi kuptoi se nuk ishte i aftë të shkëputej prej asaj që kishte. Në fund, «kur djaloshi dëgjoi këtë fjalë, shkoi i trishtuar» (rr. 22). Kishte hequr dorë prej rinisë së vet.

19. Ungjilli na flet edhe për disa të reja të matura që ishin të gatshme e të vëmendshme, ndërsa të tjerat jetonin të shpërqendruara e të fjetura (krh. Mt 25,1-13). Në të vërtetë, njeriu mund ta kalojë rininë e vet i shpërqendruar, duke u endur mbi sipërfaqen e jetës, i fjetur, i paftë për të krijuar marrëdhënie të thella dhe për të hyrë në zemrën e jetës. Në këtë mënyrë përgatit një të ardhme të varfër, pa thelb. Ose e shpenzon rininë e vet duke kultivuar gjëra të bukura e të mëdha dhe në këtë mënyrë përgatit një të ardhme plot me jetë e me pasuri të brendshme.

20. Nëse ke humbur fuqinë e brendshme, ëndrrat, entuziazmin, shpresën dhe bujarinë, para teje del Jezusi siç doli para djalit të vdekur të vejushës, dhe me gjithë fuqinë e vet si i Ngjallur, Zotëria të nxit: «Djalosh, ty po të them: çohu!» (Lk 7,14).

21. Pa dyshim ka edhe shumë tekste të tjera të Fjalës së Hyjit që mund të na ndriçojnë në lidhje me këtë stinë të jetës. Do t'i analizojmë disa prej tyre në kapitujt e ardhshëm.

## KAPITULLI I DYTË

### JEZU KRISHTI GJITHMONË I RI

22. Jezusi është «i ri mes të rinjsh për të qenë shembulli i të rinjve dhe për t'ia kushtuar ata Zotit».<sup>[3]</sup> Prandaj Sinodi ka pohuar se «rinia është një periudhë origjinale dhe stimuluese e jetës, që vetë Jezusi e ka jetuar, duke e shenjtëruar atë».<sup>[4]</sup> Çfarë na tregon Ungjilli në lidhje me rininë e Jezusit?

#### RINIA E JESUSIT

23. Zotëria «dha shpirt» (Mt 27,50) në kryq kur ende ishte pak më shumë se tridhjetë vjeç (krh. Lk 3,23). Është e rëndësishme të ndërjegjësohemi se Jezusi ka qenë djalë i ri. Ka dhënë jetën e vet në një fazë që sot përcaktohet si ajo e një të riu - të rritur. Në kulmin e rinisë filloi misionin e vet publik dhe kështu «lindi drita» (Mt 4,16), veçanërisht kur dha jetën e vet. Fundi i tij nuk është improvizuar, përkundrazi, e gjithë rinia e tij ka qenë një përgatitje e çmueshme, në secilin prej momenteve të veta, sepse «gjithçka në jetën e Jezusit është shenjë e misterit të tij»<sup>[5]</sup> dhe «e gjithë jeta e Krishtit është mister i shëlbimit».<sup>[6]</sup>

24. Ungjilli nuk flet për fëmijërinë e Jezusit, por na tregon disa ngjarje të adoleshencës dhe të rinisë së tij. Mateu e vendos periudhën e rinisë së Zotërisë mes dy ngjarjeve: kthimit të familjes së tij në Nazaret, pas kohës së mërgimit, dhe pagëzimit në Jordan, kur filloi misionin e tij publik. Imazhet e fundit të Jezusit fëmijë janë ato të një vogëlushi të ikur në Egjipt (krh. Mt 2,14-15) e pastaj ato të një të kthyeri në Nazaret (krh. Mt 2,19-23). Imazhet e para të Jezusit të ri - të rritur janë ato që na e paraqesin atë mes turmës pranë lumit Jordan, ku po merrte pagëzimin nga kushëri i tij Gjon Pagëzuesi, si njëri prej turmës (krh. Mt 3,13-17).

25. Ai pagëzim nuk ishte si i yni, që na shtie në jetën e hirit, por ishte një kushtim para se të fillonte misionin e madh të jetës së tij. Ungjilli thotë se pagëzimi i tij ishte arsyeja e gëzimit dhe e miratimit të Atit: «Ti je Biri im – Djali i dishirit» (Lk 3,22). Menjëherë Jezusi u shfaq i mbushur me Shpirtin Shenjt dhe Shpirti e çoi në shkretëtirë. Në këtë mënyrë bëhej gati të shkonte për të predikuar e për të bërë mrekulli, për të liruar e për të shëruar (krh. Lk 4,1-14). Çdo i ri, kur ndihet i thirrur për të kryer një mision në këtë tokë, është i ftuar të ndiejë brenda vetes po ato fjalë që Hyji Atë ia drejton atij: «Ti je biri im – djali i dishirit».

26. Mes këtyre tregimeve gjejmë një që e dëfton Jezusin në mes të adoleshencës. Është momenti kur ai u kthye me prindërit e vet në Nazaret, pasi e kishin humbur dhe gjetur në Tempull (krh. Lk 2,41-51). Këtu thotë se «i dëgjonte» (krh. Lk 2,51), pasi nuk e kishte mohuar familjen e vet. Menjëherë Luka shton se Jezusi «përparonte në dije, në moshë e në hir para Hyjit e para njerëzve» (Lk 2,52). Domethënë ishte duke u përgatitur dhe në atë periudhë ishte duke e thelluar marrëdhënien e vet me Atin dhe me të tjerët. Shën Gjon Pali II ka shpjeguar se nuk rritej vetëm fizikisht, por se «në Jezusin ka pasur edhe një rritje shpirtërore», sepse «plotësia e hirit në Jezusin ishte e lidhur me moshën: ishte gjithmonë plotësi, por një plotësi që rritej me rritjen në moshë».<sup>[7]</sup>

27. Në bazë të këtyre të dhënave ungjillore mund të pohojmë se, në fazën e tij rinore, Jezusi ishte «duke u formuar», ishte duke u përgatitur për të realizuar planin e Atit. Adoloshenca dhe rinia e tij e kanë orientuar drejt këtij misioni suprem.

28. Në adoleshencë dhe në rini marrëdhënia e tij me Atin ishte ajo e Birit të dashur; i tërhequr prej Atit, ai rritej duke u marrë me punët e tij: «A nuk e dinit se më duhet të merrem me punët e Atit tim?» (Lk 2,49). Megjithatë, nuk duhet të mendojmë se Jezusi ishte një adoloshent i vetmuar apo

një i ri që mendonte për veten e vet. Marrëdhënia e tij me njerëzit ishte ajo e një të riu që bënte jetën e një familjeje fshatare. Ka mësuar punën e të atit dhe pastaj e ka zëvendësuar atë si zdrukthëtar. Prandaj, në Ungjill, në një rast e quajnë «i biri i zdrukthëtarit» (Mt 13,55) dhe një herë tjetër thjesht «zdrukthëtar» (Mk 6,3). Kjo hollësi tregon se ishte një djalë fshatar si gjithë të tjerët dhe se kishte marrëdhënie krejt normale. Askush nuk e konsideronte një të ri të çuditshëm apo të ndarë prej të tjerëve. Pikërisht për këtë arsye, kur Jezusi u paraqit për të predikuar, njerëzit nuk e kuptonin se nga e merrte atë urti: «Vallë, a nuk është ky biri i Jozefit?» (Lk 4,22).

29. Puna është se «Jezusi nuk u rrit në një marrëdhënie të mbyllur dhe ekskluzive me Marinë e Jozefin, por lëvizte me gëzim në familjen e zgjeruar ku bënin pjesë të afërmit dhe miqtë».<sup>[8]</sup> Kështu kuptojmë se përse, në momentin e kthimit nga shtegtimi në Jerusalem, prindërit ishin të qetë duke menduar se ai djalë dymbëdhjetë vjeçar (krh. Lk 2,42) po ecte i sigurt me njerëzit e vet, megjithëse nuk e kishin parë gjithë ditën: «Duke qenë të bindur se është me turmën, ecën ashtu një ditë rrugë» (Lk 2,44). Sigurisht – mendonin – Jezusi ishte aty, shkante e vinte mes të tjerëve, qeshte e luante me bashkëmoshatarët e vet, dëgjonte tregimet e të rriturve dhe bashkëndante gëzimet e trishtimet e karvanit. Fjala greke që përdor Luka për karvanin e shtegtarëve – synodía – tregon pikërisht këtë “bashkësi në ecje”, pjesë e të cilës është Familja e shenjtë. Falë besimit të prindërve të vet, Jezusi lëviz i sigurt dhe mëson të ecë me gjithë të tjerët.

#### RINIA E TIJ NA NDRIÇON

30. Këto aspekte të jetës së Jezusit mund të jenë një frymëzim për çdo të ri, që rritet dhe përgatitet për të kryer misionin e vet. Kjo kërkon që të piqet në marrëdhënien me Atin, me vetëdijen se është anëtar i familjes dhe i bashkësisë, se mund të hapet për t’u mbushur prej Shpirtit Shenjt dhe për t’u drejtuar që të kryejë misionin që Hyji i beson, thirrjen e vet. Asnjëra nga këto nuk duhet të shpërfillet në baritoren rinore për të mos krijuar projekte që i izolojnë të rinjtë prej familjes e botës, ose që i shndërrojnë ata në një pakicë të përzgjedhurish e që i ruajnë nga çdo infektim. Kemi nevojë për projekte që i forcojnë, i shoqërojnë dhe i projektojnë drejt takimit me të tjerët, drejt shërbimit zemërgjerë, drejt misionit.

31. Jezusi nuk ju ndriçon ju, të rinj, nga larg apo nga jashtë, por prej rinisë së tij, të cilën ai e bashkëndan me ju. Është shumë e rëndësishme ta sodisim Jezusin e ri që paraqesin Ungjijtë, sepse Ai ishte me të vërtetë njëri prej jush dhe në Të mund të shihen shumë aspekte tipike të zemrave të reja. E shohim këtë, për shembull, në karakteristikat që vijnë: «Jezusi kishte një besim të pakushtëzuar në Atin, u kujdes për miqësinë me nxënësit e vet dhe në momentet e krizës qëndroi besnik. Tregoi dhembshuri të madhe ndaj më të dobëve, veçanërisht ndaj të varfërve, të sëmurëve, mëkatarëve dhe të përjashtuarve. Pati guximin t’u bëjë ballë autoriteteve fetare e politike të kohës së vet; bëri përvojën e të ndierit i pakuptuar dhe i përjashtuar; provoi frikën e vuajtjes dhe njohu brishtësinë e Mundimeve; e hodhi vështrimin e vet drejt të ardhmes duke iu besuar duarve të sigurta të Atit dhe forcës së Shpirtit. Në Jezusin të gjithë të rinjtë mund ta gjejnë veten e tyre».<sup>[9]</sup>

32. Nga ana tjetër, Jezusi është ngjallur dhe dëshiron të na bëjë të marrim pjesë në risinë e ngjalljes së tij. Ai është rinia e vërtetë e një bote të plakur dhe është edhe rinia e një gjithësie që pret me «dhimbjet e lindjes» (Rom 8,22), që të vishet me dritën dhe jetën e tij. Afër Tij mund të pjmë prej burimit të vërtetë, që i mban gjallë ëndrrat, projektet e idealet tona të mëdha, si edhe që na drejton në shpalljen e jetës që ia vlen ta jetosh. Në dy hollësi interesante të Ungjillit të Markut mund ta shohim thirrjen në rininë e vërtetë të të ngjallurve. Nga njëra anë, në mundimet e Zotit shfaqet një i ri i frikësuar që kërkonte ta ndiqte Jezusin, por që iku lakuriq (krh. 14,51-52), një i ri që nuk pati forcë të rrezikonte gjithçka për ta ndjekur Zotin. Ndërsa, afër varrit të zbrazët, shohim një të ri «të veshur me petk të bardhë» (16,5) që na fton ta mposhtim frikën dhe të shpallim gëzimin e ngjalljes (krh. 16,6-7).



33. Zoti na thërret që të ndezim yje në natën e të rinjve të tjerë; na fton që të shikojmë drejt yjeve të vërtetë, atyre shenjave aq të larmishme që Ai na jep në mënyrë që të mos mbetemi në vend, por të imitojmë mbjellësin që vërente yjet për të punuar tokën. Hyji ndez yje për ne në mënyrë që ne të vazhdojmë të ecim: «Yjet ndriçojnë në vendin e vet e gëzohen: i thirri e thanë: ‘Tek jemi!’» (Bar 3,34-35). Por vetë Krishti është për ne drita e madhe e shpresës dhe e drejtimit në natën tonë, sepse Ai është «ylli i ndritshëm i mëngjesit» (Zb 22,16).

#### RINIA E KISHËS

34. Të qenit i ri, më shumë se një moshë, është një gjendje zemre. Pra, një institucion i hershëm si Kisha mund të përtërihet dhe të bëhet përsëri i ri në faza të ndryshme të historisë së vet shumë të gjatë. Në fakt, në momentet e saj më tragjike Kisha ka ndier thirrjen për t’iu kthyer gjërave thelbësore që e kanë bërë të dashurohet me Të. Duke kujtuar këtë të vërtetë, Koncili II i Vatikanit pohonte se «e pasur me një të kaluar të gjatë gjithmonë të gjallë në të, dhe duke ecur drejt përsosurisë njerëzore në kohë e drejt fateve të fundit të historisë dhe të jetës, ajo është rinia e vërtetë e botës». Në të është gjithmonë e mundur të takohet Krishti «shoku dhe miku i të rinjve».<sup>[10]</sup>

#### NJË KISHË QË E LË VETEN TË PËRTËRIHET

35. Le t’i kërkojmë Zotit që ta lirojë Kishën nga ata që duan ta plakin atë, ta ngulin në të kaluarën, ta frenojnë dhe ta bëjnë të palëvizshme. Le t’i kërkojmë edhe që ta lirojë prej një tundimi tjetër: nga pretendimi se është e re, sepse i hap rrugë gjithçkaje që bota i ofron; nga besimi se përtërihet, sepse fsheh mesazhin e vet dhe mimetizohet me të tjerët. Jo. Është e re kur është vetvetja, kur merr çdo ditë forcën gjithmonë të re të Fjalës së Hyjit, të Eukaristisë, të pranisë së Krishtit dhe të forcës së Shpirtit të tij. Është e re kur është e aftë të kthehet vazhdimisht te burimi i saj.

36. Është e vërtetë se ne anëtarët e Kishës nuk duhet të jemi tipa të çuditshëm. Duhet të bëjmë të mundur që të gjithë të na ndiejnë vëllezër e të afërm, sikurse Apostujt, të cilët «mbarë populli i kishte fort për hir» (Vap 2,47; krh. 4,21.33; 5,13). Por, në të njëjtën kohë, duhet të kemi guxim që të jemi të ndryshëm, të tregojmë ëndrra të tjera që kjo botë nuk i ofron, të dëshmojmë bukurinë e zemërgjerësisë, të shërbimit, të pastërtisë, të forcës, të faljes, të besnikërisë ndaj thirrjes personale, të lutjes, të luftës për drejtësi dhe për të mirën e përbashkët, të dashurisë për të varfrit, të miqësisë shoqërore.

37. Kisha e Krishtit mund të bjerë gjithmonë në tundimin që ta humbë entuziazmin e vet, sepse nuk e dëgjon më thirrjen e Zotit për të rrezikuar për fenë, për të dhënë gjithçka pa marrë parasysh rreziqet dhe kërkon siguritë e rreme të botës. Janë pikërisht të rinjtë ata që mund ta ndihmojnë që ajo të mbetet e re, që të mos korruptohet, që të mos ndalet, që të mos krenohet, që të mos shndërrohet në një sekt, që të jetë më e varfër dhe e aftë për dëshmi, që të rrijë afër njerëzve të fundit, atyre që janë përjashtuar prej shoqërisë, që të luftojë për drejtësi, që me përvujtëri të lejojë që ta pyesin. Ata mund t’i sjellin Kishës bukurinë e rinisë kur nxisin «aftësinë për t’u gëzuar për atë që fillon, për t’u dhuruar pa kthim, për t’u përtërirë e për t’u rinisur për arritje të reja».<sup>[11]</sup>

38. Ata që nuk janë më të rinj kanë nevojë për raste që të kenë afër zërin e të rinjve dhe nxitjen e tyre, pasi «afërsia krijon kushtet që Kisha të jetë hapësirë dialogu dhe dëshmie vëllazërore që mahnit».<sup>[12]</sup> Kemi nevojë të krijojmë më shumë hapësira ku të jehojë zëri i të rinjve: «Dëgjimi bën të mundur një shkëmbim dhuratash, në një kontekst empatie. [...] Në të njëjtën kohë krijon kushtet për një shpallje të Ungjillit që arrin me të vërtetë në zemër, në mënyrë ndikuese e të frytshme».<sup>[13]</sup>

#### NJË KISHË E VËMENDSHME NDAJ SHENJAVE TË KOHËVE

39. «Nëse për shumë të rinj Hyji, besimi dhe Kisha duken fjalë të zbrazëta, ata janë të ndjeshëm ndaj figurës së Jezusit, kur paraqitet në mënyrë tërheqëse dhe efikase».<sup>[14]</sup> Prandaj duhet që Kisha të mos jetë tepër e përqendruar te vetja e vet, por të pasqyrojë mbi të gjitha Jezu Krishtin. Kjo kërkon që të pranojë me përvujtëri se disa gjëra konkrete duhet të ndryshojnë dhe për këtë qëllim ajo ka nevojë edhe që të pranojë vizionin e madje edhe kritikën e të rinjve.

40. Në Sinod është pohuar se «një numër i madh të rinjsh, për arsye të ndryshme, nuk i kërkojnë asgjë Kishës, sepse nuk e konsiderojnë atë domethënëse për ekzistencën e tyre. Madje, disa kërkojnë shprehimisht që të lihen rehat, sepse e ndiejnë praninë e saj si të bezdisshme e madje acaruese. Kjo kërkesë shpesh nuk lind nga një përbuzje akritike e impulsive, por i ka rrënjët edhe në arsye serioze e të respektueshme: shkandujt seksualë e ekonomikë; papërgatitja e mbarështuesve të shuguruar që nuk dinë ta kuptojnë siç duhet ndjeshmërinë e të rinjve; kujdesi i mangët në përgatitjen e homelisë dhe në paraqitjen e Fjalës së Hyjit; roli pasiv që u caktohet të rinjve brenda bashkësisë së krishterë; vështirësia e Kishës për t'i argumentuar pozicionet e veta doktrinale dhe etike përballë shoqërisë bashkëkohore».<sup>[15]</sup>

41. Edhe pse ka të rinj që janë të kënaqur kur shohin një Kishë që dëftohet përvujtërisht e sigurt për dhuratat e veta, si dhe e aftë të ushtrojë një kritikë të çiltër e vëllazërore, të rinj të tjerë kërkojnë një Kishë që dëgjon më shumë, që nuk rri vazhdimisht duke dënuar botën. Nuk duan të shohin një Kishë të heshtur e të druajtur, por as gjithmonë në luftë për dy-tri tema që e obsesiojnë atë. Për të qenë e besueshme në sytë e të rinjve, nganjëherë ajo ka nevojë të rifitojë përvujtërinë dhe thjeshtë të dëgjojë, të shohë në atë që të tjerët thonë një dritë që mund ta ndihmojë atë vetë për ta zbuluar më mirë Ungjillin. Një Kishë që vetëmbrohet, që harron përvujtërinë, që nuk dëgjon më, që nuk lejon të vihet në diskutim, e humb rininë dhe shndërrohet në mumje. Si mund t'i pranojë kështu ajo ëndrrat e të rinjve? Megjithëse ka të vërtetën e Ungjillit, kjo nuk do të thotë se e ka kuptuar atë plotësisht; ajo duhet ta kuptojë gjithnjë e më shumë këtë thesar të pashtershëm.<sup>[16]</sup>

42. Për shembull, një Kishë tepër e druajtur dhe e strukturuar mund të jetë vazhdimisht kritike ndaj të gjithë argumenteve në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vërë në dukje rreziqet dhe gabimet e mundshme të këtyre pretendimeve. Anasjellas, një Kishë e gjallë mund të reagojë duke u kushtuar vëmendje pretendimeve të ligjshme të grave që kërkojnë drejtësi e barazi më të madhe. Mund të kujtojë historinë dhe të pranojë një autoritarizëm nga burrat, nënshtrim, forma të ndryshme skllavërie, abuzime e dhunë maskiliste. Me këtë nënshtrim do të jetë e aftë t'i bëjë të vetat ato pretendime të drejtash dhe do të japë ndihmesën e vet me bindje për një ndërsjellshmëri më të madhe mes burrave e grave, edhe duke mos qenë gjithmonë dakord me gjithçka që propozojnë disa grupe feministe. Në këtë linjë, Sinodi ka dashur të përtërijë angazhimin e Kishës «kundër çdo diskriminimi e dhune me bazë gjinore».<sup>[17]</sup> Ky është reagimi i një Kise që mbetet e re dhe që lejon që ta pyesë dhe ta nxisë ndjeshmëria e të rinjve.

#### MARIA, VAJZA E NAZARETIT

43. Në zemrën e Kishës shkëlqen Maria. Ajo është modeli i madh për një Kishë të re, që dëshiron ta ndjekë Krishtin me freski e butësi. Kur ajo ishte shumë e re, mori lajmin e engjëllit dhe nuk la pyetje pa bërë (krh. Lk 1,34). Por kishte një shpirt të gatshëm dhe në fund i tha: «Unë jam shërbëtorja e Zotit» (Lk 1,38).

44. «Gjithmonë të bën përshtypje forca e “po”-së së Marisë, vajzë e re. Forca e asaj “më ndodhtë” që i tha engjëllit. Kjo përgjigje nuk ka lidhje me një pranim pasiv apo me qëndrimin e atij që dorëzohet. Nuk ka lidhje as me “po”-në e atij që thotë: “Mirë, le ta provojmë e të shohim se çfarë ndodh”. Maria nuk e njihte këtë shprehje: të shohim se çfarë ndodh. Ishte e vendosur, ka kuptuar se për çfarë bëhej fjalë dhe ka thënë “po”, pa lojëra fjalësh. Ka qenë diçka më shumë, diçka e ndryshme. Ka qenë “po”-ja e atij që dëshiron të përfshihet e të rrezikojë, e atij që dëshiron të fusë në lojë gjithçka, pa garanci tjetër përveç sigurisë se është bartës i një premtimi. Dhe e pyes secilin

prej jush: a ndiheni bartës të një premtimi? Cili është premtimi që unë bart në zemër, të cilin duhet ta realizoj? Maria, pa dyshim, po merrte përsipër një mision të vështirë, por vështirësitë nuk ishin një arsye për të thënë “jo”. Sigurisht që do të kishte ndërlikime, por nuk do të ishin ato ndërlikime që lindin kur jeta na paralizon për faktin se nuk kemi gjithçka të qartë apo të siguruar që më parë. Maria nuk ka blerë një siguracion për jetën! Maria e ka futur veten në lojë dhe për këtë arsye është e fortë, për këtë arsye është një *influencere*, është *influencere* e Hyjit! “Po”-ja dhe dëshira për të shërbyer janë më të forta, sesa dyshimet dhe vështirësitë».<sup>[18]</sup>

45. Pa rënë pre e ikjeve apo e iluzioneve, «Ajo diti ta shoqëronte të Birin, [...] ta mbështeste me vështrimin e vet dhe ta mbronte me zemrën e vet. Dhimbja e provoi fort, por nuk e përkuli atë. Ajo ishte gruaja e fortë e “po”-së, që mbështet dhe shoqëron, që mbron dhe përfaqon. Ajo është rojtarka e madhe e shpresës. [...] Prej saj mësojmë t’i themi “po” durimit kokëfortë dhe krijimtarisë së atyre që nuk e humbin guximin dhe rifillojnë nga e para».<sup>[19]</sup>

46. Maria, vajzë me shpirt të madh, brohoriste me hare (krh. Lk 1,47); sytë e saj ishin të ndriçuar prej Shpirtit: ajo e sodiste jetën me fe dhe gjithçka e ruante në zemrën e vet (krh. Lk 2,19,51). Ishte vajza e paqetë dhe e gatshme për t’u nisur, pasi, sapo mori vesh se kushërira e saj kishte nevojë për të, nuk mendoi për planet e veta, por u nis «me nxitim» (Lk 1,39) drejt krahinës malore.

47. Kur u paraqit nevoja që ta mbronte fëmijën e saj, shkoi së bashku me Jozefin në një vend të largët (krh. Mt 2,13-14). Pastaj qëndroi në mes të nxënësve të bashkuar në lutje në pritje të Shpirtit Shenjt (krh. Vap 1,14). Kështu, me praninë e saj, lindi një Kishë e re, me Apostuj që punonin për të krijuar një botë të re (krh. Vap 2,4-11).

48. Ajo vajzë sot është Nëna që rri zgjuar mbi bijtë e vet, mbi ne bijtë e saj që shpesh ecim në jetë të lodhur e nevojtarë, por me dëshirën që drita e shpresës të mos na shuhet kurrë. Kjo është ajo që duam: që drita e shpresës të mos na shuhet kurrë. Nëna jonë e vështron këtë popull shtegtar, popull të rinjsh që ajo e do fort, popull që e kërkon duke bërë heshtje në zemrën e vet, pavarësisht se gjatë ecjes ka shumë zhurmë, biseda e shpërqendrimë. Por para syve të Nënës ka vend vetëm për heshtjen e mbushur me shpresë. E kështu Maria e ndriçon përsëri rininë tonë.

#### TË RINJ TË SHENJTË

49. Zemra e Kishës është edhe plot me të rinj të shenjtë, që kanë dhënë jetën e tyre për Krishtin, shumë prej tyre deri në martirizim. Kanë qenë pasqyrime të çmueshme të Krishtit të ri që shkëlqejnë për të na nxitur dhe për të na bërë të dalim prej përgjumjes. Sinodi ka pohuar se «shumë të rinj të shenjtë kanë bërë të shkëlqejnë karakteristikat e moshës rinore në të gjithë bukurinë e tyre dhe kanë qenë profetë të vërtetë të ndryshimit në epokën e tyre; shembulli i tyre tregon se për çfarë janë të aftë të rinjtë kur i hapen takimit me Krishtin».<sup>[20]</sup>

50. «Nëpërmjet shenjtërisë së të rinjve Kisha mund të përtërijë zellin shpirtëror dhe fuqinë e vet apostolike. Balsami i shenjtërisë së krijuar prej jetës së mirë të shumë të rinjve mund t’i mjekojë plagët e Kishës dhe të botës, duke na çuar në atë plotësi dashurie në të cilën kemi qenë të thirrur gjithmonë: të rinjtë e shenjtë na nxisin t’i kthehemi dashurisë sonë të parë (krh. Zb 2,4)».<sup>[21]</sup> Ka shenjtër që nuk e kanë njohur jetën prej të rrituri dhe na kanë lënë dëshminë e një tjetër mënyre të të jetuarit të rinisë. Le të kujtojmë të paktën disa prej tyre, që e kanë jetuar shenjtërinë, në periudha të ndryshme historike, secili në mënyrën e vet.

51. Në shekullin III, Shën Sebastiani ishte kapiten i gardës pretoriane. Tregojnë se fliste për Krishtin kudo dhe përpiquej t’i kthente shokët e vet, deri kur i urdhëruan që të hiqte dorë prej fesë së vet. Meqë nuk pranoi, e gjuajtën me një shi shigjetash, por mbijetoi dhe vazhdoi ta shpallte Krishtin pa frikë. Në fund, e fshikulluan deri sa vdiq.

52. Shën Françesku i Asizit, kur ishte shumë i ri dhe plot ëndrra, ndjeu thirrjen e Jezusit për të qenë i varfër si Ai dhe për ta rindërtuar Kishën me dëshminë e vet. Hoqi dorë me gëzim prej gjithçkaje duke u bërë shenjti i vëllazërisë së përgjithshme, vëllai i të gjithëve, që lavdëronte Zotin për krijesat e tij. Vdiq në vitin 1226.

53. Shenjtja Zhana d'Ark lindi në vitin 1412. Ishte një e re fshatare që, pavarësisht prej moshës së re, luftoi për ta mbrojtur Francën nga pushtuesit. E pakuptuar për pamjen dhe mënyrën e saj të jetuarit të fesë, u dogj në turrën e druve.

54. I lumi Endrju Phû Yën ishte një i ri vietnamez i shekullit XVII. Ishte katekist dhe ndihmonte misionarët. E burgosën për arsye të fesë së tij dhe, meqenëse nuk pranoi të hiqte dorë prej saj, e vranë. Vdiq duke thënë: “Jezus!”.

55. Në të njëjtin shekull, Shenjtja Kateri Tekakuitha, një e re laike nga Amerika e Veriut, u përdoq për fenë e saj dhe duke ikur përshkoi në këmbë më shumë se treqind kilometra përmes pyjeve të dendura. Iu kushtua Hyjit dhe vdiq duke thënë: “Jezus, të dua!”.

56. Shën Domenik Savio ia kushtonte Marisë të gjitha vuajtjet e veta. Kur Shën Gjon Bosko i mësoi se shenjtëria kërkon që të jemi gjithmonë të gëzueshëm, ia hapi gëzimin e vet një gëzimi ngjites. Përpiquej t'u rrinte afër shokëve të vet më të mënjanuar e të sëmurë. Vdiq në vitin 1857, kur ishte vetëm 14 vjeç, duke thënë: “Çfarë mrekullie jam duke parë!”.

57. Shën Tereza e Jezusit Fëmijë lindi në vitin 1873. Kur ishte 15 vjeçe, duke kapërcyer shumë vështirësi, arriti të hynte në një kuvend karmelitan. Jetoi rrugën e ngushtë të besimit të plotë në dashurinë e Zotit, duke i vënë vetes si qëllim që ta ushqente me lutjen e vet zjarrin e dashurisë që nxit Kishën.

58. I lumi Çeferin Namuncura ishte një i ri argjentinaz, i biri i një kryetari të rëndësishëm të popullsisë vendase. U bë seminarist salezian, me dëshirën e fortë që të kthehej në fisin e vet për të çuar aty Jezu Krishtin. Vdiq në vitin 1905.

59. I lumi Izidor Bakanja ishte një laik i Kongos që dëshmonte fenë e vet. U torturua gjatë, sepse u fliste për krishterimin të rinjve të tjerë. Vdiq në vitin 1909, duke falur xhelatin e vet.

60. I lumi Pier Xhorxho Frasati, që vdiq në vitin 1925, «ishte një i ri me një gëzim përfshirës, një gëzim që tejkalonte edhe shumë vështirësi të jetës së tij».<sup>[22]</sup> Dashurinë e Krishtit që merrte në Kungim donte t'ua dhuronte të varfërve, duke i vizituar dhe i duke ndihmuar ata.

61. I lumi Marsel Kalo ishte një i ri francez që vdiq në vitin 1945. Në Austri e burgosën në një kamp përqendrimi ku ngushëllonte në fe shokët e vet të burgut.

62. E reja e lume Kiara Badano, që vdiq në vitin 1990, «ka përjetuar se si dhimbja mund të shndërrohet në dashuri [...]. Çelësi i paqes dhe i gëzimit të saj ishte besimi i plotë në Zotin dhe pranimi edhe i sëmundjes si shprehje e mistershme e vullnesës të tij për të mirën e saj dhe të të gjithëve».<sup>[23]</sup>

63. Ata, së bashku me shumë të rinj që, shpesh në heshtje e në anonimat, e kanë jetuar thellësisht Ungjillin, ndërmjetësofshin për Kishën, që të jetë plot me të rinj të gëzueshëm, të guximshëm e të angazhuar që t'i dhurojnë botës dëshmi të reja shenjtërie.

## KAPITULLI I TRETË

## JU JENI E TASHMJA E HYJIT

64. Pasi kemi shqyrtuar Fjalën e Hyjit, nuk mund të kufizohemi duke thënë se të rinjtë janë e ardhmja e botës: në fakt, ata janë e tashmja, janë ata që e pasurojnë botën me ndihmën e tyre. Një i ri nuk është më fëmijë, gjendet në një moment të jetës së vet kur fillon të marrë përsipër përgjegjësi të ndryshme, duke marrë pjesë së bashku me të rriturit në zhvillimin e familjes, të shoqërisë, të Kishës. Por kohët ndryshojnë dhe lind pyetja: si janë të rinjtë sot, çfarë po u ndodh atyre?

### POZITIVISHT

65. Sinodi ka pranuar se besimtarët e Kishës jo gjithmonë kanë qëndrimin e Jezusit. Në vend që të jemi të gatshëm t'i dëgjojmë në thellësi, «nganjëherë mbizotëron prirja për të dhënë përgjigje të parapërgatitura dhe receta të gatshme, pa lënë që të dalin në pah pyetjet rinore me risinë e tyre dhe pa e pranuar provokimin e tyre».<sup>[24]</sup> Nga ana tjetër, kur Kisha i braktis skemat e ngurta dhe i hapet një dëgjimi të gatshëm e të vëmendshëm të të rinjve, kjo empati e pasuron atë, sepse «u lejon të rinjve t'i dhurojnë bashkësisë ndihmesën e tyre, duke e ndihmuar atë që të pranojë ndjeshmëri të reja dhe t'i bëjë vetes pyetje të reja».<sup>[25]</sup>

66. Sot ne të rriturit rrezikojmë të bëjmë një listë të telasheve dhe të të metave të rinisë së kohës sonë. Disa ndoshta do të na duartrokasim, sepse dukemi ekspertë në gjetjen e aspekteve negative dhe të rreziqeve. Por cili do të ishte rezultati i këtij qëndrimi? Një largësi gjithnjë e më e madhe, më pak afërsi, më pak ndihmë e ndërsjellë.

67. Vështrimi i vëmendshëm i atyre që janë thirrur për të qenë etër, barinj dhe udhërrëfyes të të rinjve duhet të gjejë flakën e vogël që vazhdon të digjet, kallamin që duket se po thyhet, por që vetëm është përkulur (krh. Is 42,3). Është aftësia për të gjetur rrugë aty ku të tjerët shohin vetëm mure, është të dish të shohësh mundësi aty ku të tjerët shohin vetëm rreziqe. Kështu është vështrimi i Hyjit Atë: i aftë të vlerësojë dhe të ushqejë sythet e të mirës së mbjellë në zemrën e të rinjve. Prandaj zemra e çdo të riu duhet të konsiderohet “tokë e shenjtë”, bartëse e farave të jetës hyjnore dhe përpara të cilës duhet “të heqim sandalet” nëse duam t'i afrohem dhe ta njohim më thellë Misterin.

### SHUMË RINI

68. Mund të përpiqemi që t'i përshkruajmë karakteristikat e të rinjve të sotëm, por para së gjithash dua të paraqes një vërejtje të Etërve sinodalë: «Vetë përbërja e Sinodit ka bërë të dukshme praninë dhe ndihmesën e vendeve të ndryshme të botës, duke vënë në dukje bukurinë e të qenit Kishë e gjithëmbarshme. Megjithëse në një kontekst globalizimi në rritje, Etërit sinodalë janë përpjekur të vënë në dukje ndryshimet e shumta mes konteksteve e kulturave, edhe brenda të njëjtit vend. Ekziston një pluralitet botësh rinore, aq sa në disa vende ekziston prirja për ta përdorur termin “rini” në shumës. Gjithashtu, grupmosha që ka pyetur ky Sinod (16-29 vjeç) nuk përfaqëson një tërësi homogjene, por është e përbërë nga grupe që jetojnë situata specifike».<sup>[26]</sup>

69. Në këndvështrimin demografik, në disa vende ka shumë të rinj, ndërsa disa të tjerë kanë një nivel lindshmërie shumë të ulët. Megjithatë, «një ndryshim i mëtejshëm vjen prej historisë, që i bën të ndryshme vendet dhe kontinentet me traditë të hershme të krishterë, kultura e të cilave është bartëse e një kujtese që nuk duhet humbur, prej vendeve dhe kontinenteve që përkundrazi karakterizohen nga tradita të tjera fetare dhe në të cilat krishterimi është një prani minoritare dhe nganjëherë e kohëve të fundit. Pastaj në territore të tjera bashkësitë e krishtera dhe të rinjtë që bëjnë pjesë në to janë objekt i përndjekjes».<sup>[27]</sup> Gjithashtu, duhet të dallohen ata të rinj «që kanë qasje në një numër gjithnjë e më të madh mundësish të ofruara prej globalizimit, nga ata që përkundrazi

jetojnë në skajet e shoqërisë apo në botën rurale dhe vuajnë efektet e formave të ndryshme të përjashtimit e të skartimit».<sup>[28]</sup>

70. Ka edhe shumë ndryshime të tjera që do të ishte e ndërlikuar t'i përshkruaja me hollësi këtu. Prandaj, nuk më duket me vend që të ndalem për të bënë një analizë të plotë të të rinjve në botën e sotme, se si jetojnë dhe se çfarë është duke u ndodhur atyre. Megjithatë, meqenëse nuk mund të mos e shoh realitetin, do të paraqes shkurtimisht disa ndihmesa që kanë ardhur para Sinodit dhe të tjera që pata mundësi të mbledh gjatë zhvillimit të tij.

#### DISA GJËRA QË U NDODHIN TË RINJVE

71. Rinia nuk është një objekt që mund të analizohet në terma abstraktë. Në fakt, "rinia" nuk ekziston, ekzistojnë të rinjtë me jetët e tyre konkrete. Në botën e sotme, plot me përparime, shumë prej këtyre jetëve janë të rrezikuara prej vuajtjes dhe manipulimit.

#### TË RINJTË E NJË BOTE NË KRIZË

72. Etërit sinodalë kanë vënë në dukje me dhimbje se «shumë të rinj jetojnë në kontekste lufte dhe pësojnë dhunë në një larmi të panumërt formash: grabitje, zhvatje, kriminalitet i organizuar, tregti e qenieve njerëzore, skllavëri dhe shfrytëzim seksual, përdhunime gjatë luftës, etj. Të rinj që, për shkak të fesë, e kanë të vështirë të gjejnë një vend në shoqëritë e tyre dhe pësojnë lloje të ndryshme përndjekjesh, deri edhe vrasjen. Të shumtë janë të rinjtë që, me detyrim ose prej mungesës së alternativave, jetojnë duke bërë krime e duke ushtruar dhunë: fëmijët ushtarë, bandat e armatosura e kriminale, trafiku i drogës, terrorizmi, etj. Kjo dhunë këput në mes shumë jetë të reja. Abuzimet e varësitë, ashtu sikurse dhuna dhe shkelja e ligjeve janë ndër arsytet që i çojnë të rinjtë në burg, me një ndikim të veçantë në disa grupe etnike e shoqërore».<sup>[29]</sup>

73. Shumë të rinj janë të ideologjizuar, të instrumentalizuar dhe të përdorur si mish për top ose si forcë përplasëse për të shkatërruar, për të frikësuar apo për të vënë në lojë të tjerët. Dhe gjëja më e keqe është se shumë shndërrohen në subjekte individualiste, armiq e mosbesues ndaj të gjithëve, dhe kështu bëhen pre e lehtë e propozimeve çnjerëzorizuese dhe e planeve shkatërrimtare të përpunuara nga grupe politike apo pushtete ekonomike.

74. Përsëri «edhe më të shumtë janë në botë të rinjtë që pësojnë forma mënjanimi dhe përjashtimi shoqëror, për arsye fetare, etnike apo ekonomike. Le të kujtojmë situatën e vështirë të adoleshenteve dhe të të rejave që mbeten shtatëzënë dhe plagën e abortit, ashtu si edhe përhapjen e SIDA-s, format e ndryshme të varësisë (drogat, bixhozi, pornografia, etj.), situatën e fëmijëve dhe të të rinjve të rrugës, që nuk kanë shtëpi, familje dhe burime ekonomike».<sup>[30]</sup> Pastaj, kur bëhet fjalë për gjininë femërore, këto situata bëhen dyfish të dhimbshme dhe të vështira.

75. Nuk mund të jemi një Kishë që nuk qan përpara këtyre dramave të bijve të vet të rinj. Nuk duhet kurrë të mësohemi me to, sepse kush nuk di të qajë nuk është nënë. Ne duam të qajmë që edhe shoqëria të jetë më shumë nënë, që, në vend që të vrasë të mësojë të lindë, që të jetë premtim jete. Qajmë kur kujtojmë ata të rinj që kanë vdekur për shkak të mjerimit e të dhunës dhe i kërkojmë shoqërisë që të mësojë të jetë një nënë solidare. Ajo dhimbje nuk ikën, na shoqëron në çdo hap, sepse realiteti nuk mund të fshihet. Gjëja më e keqe që mund të bëjmë është të përdorim recetën e shpirtit të botës, që i vë në gjumë të rinjtë me lajme të tjera, me argëtime dhe me banalitete.

76. Ndoshta «ne që bëjmë një jetë pak a shumë pa nevoja nuk dimë të qajmë. Disa realitete të jetës shihen vetëm me sytë e pastruar prej lotëve. Ftoj secilin prej jush që ta pyesë veten: a kam mësuar të qaj? Kur shoh një fëmijë të uritur, një fëmijë të droguar rrugës, një fëmijë pa shtëpi, një fëmijë të braktisur, një fëmijë të abuzuar, një fëmijë të përdorur si skllav për shoqërinë? Apo vaji im është vaji tekanoz i atij që qan sepse do të donte të kishte diçka më shumë?».<sup>[31]</sup> Përpiqu të mësosh të

qash për të rinjtë që janë më keq se ti. Mëshira dhe dhembshuria shprehen edhe duke qarë. Nëse nuk të vjen, kërkoja Zotit që të të bëjë të derdhësh lotë për vuajtjen e të tjerëve. Vetëm kur të mësosh të qash do të jesh i aftë të bësh diçka për të tjerët me gjithë zemër.

77. Nganjëherë dhimbja e disa të rinjve është e thekshme; është një dhimbje që nuk mund të shprehet me fjalë; është një dhimbje që na godet si shuplakë. Këta të rinj munden vetëm t'i thonë Hyjit se vuajnë shumë, se është tepër e vështirë për ta që të ecin përpara, se nuk besojnë më në askënd. Por, në këtë britmë copëtuese i bëjnë të pranishme fjalët e Jezusit: «Lum ata që qajnë sepse do të ngushëllohen» (Mt 5,4). Ka të rinj që kanë arritur të hapin një shteg në jetë, sepse u ka arritur ky premtim hyjnor. Ekzistoftë gjithmonë një bashkësi e krishterë afër një të riu që vuan, për të bërë që këto fjalë të shoqërohen me gjeste e ndihma konkrete!

78. Është e vërtetë se të fuqishmit japin disa ndihma, por shpesh me një çmim të lartë. Në shumë vende të varfra, ndihma ekonomike e disa vendeve më të pasura apo e disa organizmave ndërkombëtare zakonisht është e lidhur me pranimin e propozimeve perëndimore në fushën e seksualitetit, të martesës, të jetës apo të drejtësisë shoqërore. Ky kolonializim ideologjik dëmton në mënyrë të veçantë të rinjtë. Në të njëjtën kohë, shohim se si njëfarë publiciteti u mëson personave që të jenë gjithmonë të pakënaqur dhe ndihmon kulturën e skartimit, në të cilën vetë të rinjtë përfundojnë të bëhen një material “njepërdorimësh”.

79. Kultura e sotme paraqet një model personi të lidhur ngusht me figurën e të riut. Ndihet i bukur ai që duket i ri, që bën trajtime për të zhdukur gjurmët e kohës. Trupat e rinj përdoren vazhdimisht nëpër reklama. Modeli i bukurisë është një model rinor, por duhet të kemi kujdes, sepse ky nuk është një lavdërim drejtuar të rinjve. Do të thotë vetëm se të rriturit duan ta vjedhin rininë për vete, jo se i respektojnë, jo se i duan të rinjtë apo se kujdesen për ta.

80. Disa të rinj «i ndiejnë traditat familjare si shtypëse dhe nuk i respektojnë ato nën shtytjen e një kulture të globalizuar që nganjëherë i lë pa pika referimi. Ndërsa në anë të tjera të botës mes të rinjve dhe të rriturve nuk ka një konflikt të vërtetë breznor, por një ftohtësi të ndërsjellë. Nganjëherë të rriturit nuk kërkojnë ose nuk arrijnë të përçojnë vlerat themelore të ekzistencës ose marrin stile rinore, duke përmbysur marrëdhënien mes brezave. Në këtë mënyrë marrëdhënia mes të rinjve dhe të rriturve rrezikon të mbetet në planin afektiv, pa prekur dimensionin edukativ e atë kulturor».<sup>[32]</sup> Sa keq u bën kjo të rinjve, megjithëse disa nuk e kuptojnë këtë gjë! Vetë të rinjtë na kanë vënë në dukje se kjo e pengon tepër përçimin e fesë «në ato vende ku nuk ka liri shprehjeje, ku të rinjve [...] nuk u lejohet të marrin pjesë në jetën e Kishës».<sup>[33]</sup>

#### DËSHIRA, PLAGË DHE KËRKIME

81. Të rinjtë e pranojnë se trupi dhe seksualiteti janë thelbësore për jetën e tyre dhe për rritjen e identitetit të tyre. Megjithatë, në një botë që emfazizon ekskluzivisht seksualitetin, njerëzit e kanë të vështirë të ruajnë një marrëdhënie të mirë me trupin e tyre dhe t'i jetojnë kthjellësisht marrëdhëniet afektive. Për këtë dhe për arsye të tjera, morali seksual shpesh është «shkak moskuptimi dhe largimi nga Kisha, sepse perceptohet si një hapësirë gjykimi dhe dënimi». Në të njëjtën kohë, të rinjtë shprehin «një dëshirë të qartë ballafaqimi për çështjet që kanë lidhje me ndryshimin mes identitetit mashkullor e atij femëror, me ndërsjellshmërinë mes burrave e grave, me homoseksualitetin».<sup>[34]</sup>

82. Në kohën tonë, «zhvillimet e shkencës e të teknologjisë biomedike ndikojnë shumë në perceptimin e trupit, duke futur idenë se ai mund të modifikohet pa kufi. Aftësia për të ndërhyrë në ADN-në tonë, mundësia për të futur elemente artificiale në organizëm (*cyborg*) dhe zhvillimi i neuroshkencave përbëjnë një burim të madh, por në të njëjtën kohë ngrejnë pikëpyetje antropologjike dhe etike».<sup>[35]</sup> Mund të na bëjnë të harrojmë se jeta është një dhuratë, se jemi qenie të krijuara e të kufizuara dhe se mund të na përdorin lehtë ata që kanë në dorë pushtetin

teknologjik.<sup>[36]</sup> «Gjithashtu, në disa kontekste rinore po përhapet tërheqja ndaj sjelljeve të rrezikshme si mjet për të eksploruar vetveten, për të ndier emocione të forta dhe për të arritur mirënjohje. [...] Këto dukuri, nga të cilat rrezikohen brezat e rinj, përbëjnë një pengesë për një pjekurim të kthjellët».<sup>[37]</sup>

83. Në shpirtin e të rinjve gjejmë të ngulitur edhe goditjet e pësuar, dështimet dhe kujtimet e trishtuara. Shumë herë «janë plagët e humbjeve të historisë personale, të dëshirave të frustruara, të diskriminimeve dhe të padrejtësive të pësuar, të të mos ndierit të dashur apo të njohur». «Pastaj janë plagët morale, pesha e gabimeve personale, ndjenjat e fajit për gabimet e bëra.<sup>[38]</sup> Jezusi bëhet i pranishëm në këto kryqe të të rinjve, për t'u dhënë atyre miqësinë e vet, lehtësimin e vet, shoqërinë e vet shëruese dhe Kisha dëshiron të jetë mjete i tij në këtë rrugëtim drejt shërimit të brendshëm dhe paqes së zemrës.

84. Tek disa të rinj shohim një dëshirë për Hyjin, edhe pse jo me të gjitha përvijimet e Hyjit të zbuluar. Tek disa të tjerë mund të dallojmë një ëndërr vëllazërie, që nuk është pak. Tek shumë të tjerë mund të ketë një dëshirë reale për t'i zhvilluar aftësitë e tyre dhe për t'i dhënë diçka botës. Tek disa të tjerë shohim një ndjeshmëri të veçantë artistike apo një kërkim harmonie me natyrën. Tek të tjerë ndoshta mund të ketë një nevojë të madhe për komunikim. Tek shumë prej tyre do të gjejmë një dëshirë të thellë për një jetë ndryshe. Janë pikënisje të njëmendta, energji të brendshme që presin nxitje, dritë dhe inkurajim.

85. Sinodi ka trajtuar në mënyrë të veçantë tri tema shumë të rëndësishme, përfundimet e të cilave dëshiroj t'i paraqes tekstualisht, edhe pse kjo do të thotë të vazhdojmë me analiza të mëtejshme, duke zhvilluar kështu një aftësi përgjigjeje më të përshtatshme dhe më të efektshme.

#### MJEDISI DIXHITAL

86. «Mjedisi dixhital karakterizon botën bashkëkohore. Kategori të mëdha njerëzish janë të zhytura në të në mënyrë të zakonshme dhe të vazhdueshme. Nuk bëhet fjalë më vetëm për “përdorimin” e mjeteve të komunikimit, por për të jetuar në një kulturë gjerësisht të dixhitalizuar që ka ndikime shumë të thella në nocionin e kohës dhe të hapësirës, në perceptimin e vetes, të të tjerëve e të botës, në mënyrën e të komunikuarit, të të kuptuarit, të të informuarit, të të hyrit në marrëdhënie me të tjerët. Një qasje me realitetin që priret të privilegjojë figurën më shumë se dëgjimin dhe leximin ndikon në mënyrën e të mësuarit dhe në zhvillimin e sensit kritik».<sup>[39]</sup>

87. Interneti dhe rrjetet sociale kanë krijuar një mënyrë të re të komunikimit dhe të krijimit të lidhjeve, e «janë një shesh ku të rinjtë kalojnë shumë kohë dhe takohen lehtë, edhe pse jo të gjithë kanë të njëjtin akses, veçanërisht në disa zona të botës. Sidoqoftë ato përbëjnë një mundësi të jashtëzakonshme dialogu, takimi dhe shkëmbimi mes personave, përveç aksesit në informacion dhe në njohje. Gjithashtu, konteksti dixhital është një kontekst pjesëmarrjeje socio-politike e qytetarie aktive dhe mund të lehtësojë qarkullimin e informacionit të pavarur, që është i aftë të ruajë në mënyrë më të efektshme personat më të dobët, duke i bërë të njohura cenimet e të drejtave të tyre. Në shumë vende *web*-i e rrjetet sociale përfaqësojnë tashmë një vend të domosdoshëm për t'i arritur dhe për t'i përfshirë të rinjtë, edhe në nisma e veprimtari baritore».<sup>[40]</sup>

88. Megjithatë, për ta kuptuar këtë dukuri në tërësinë e saj, duhet të pranojmë se, si çdo realitet njerëzor, ajo ka kufizimet dhe mangësitë e veta. Nuk është mirë të ngatërrohet komunikimi me kontaktin e thjeshtë virtual. Në të vërtetë, «mjedisi dixhital është edhe një territor vetmie, manipulimi, shfrytëzimi e dhune, deri në rastin e skajshëm të *dark web*-it. Mediat dixhitale mund ta vënë personin në rrezikun e varësisë, të izolimit dhe të humbjes progresive të kontaktit me realitetin konkret, duke penguar zhvillimin e marrëdhënieve ndërpersonale të vërteta. Forma të reja dhune



përhapen nëpërmjet mediave sociale, si p.sh. saiberbulizmi; *web*-i është edhe një kanal i përhapjes së pornografisë dhe i shfrytëzimit të personave me qëllim seksual apo nëpërmjet bixhozit».<sup>[41]</sup>

89. Nuk duhet të harrojmë se «në botën dixhitale veprojnë interesa tejet të mëdha ekonomike, të afta të krijojnë forma kontrolli sa të holla aq edhe depërtuese, duke krijuar mekanizma manipulimi të ndërjegjeve dhe të procesit demokratik. Funkionimi i shumë platformave shpesh favorizon takimin mes personave që mendojnë në të njëjtën mënyrë, duke penguar ballafaqimin mes ndryshimeve. Këto qarqe të mbyllura lehtësojnë përhapjen e informacioneve dhe të lajmeve të rreme, duke nxitur paragjykime dhe urrejtje. Lulëzimi i *fake news*-eve është shprehje e një kulture që e ka humbur kuptimin e të vërtetës dhe i ndryshon faktet sipas interesave të veçanta. Nderi i personave vihet në rrezik nëpërmjet proceseve të përgjithësuara *on line*. Kjo dukuri ka lidhje edhe me Kishën dhe barinj të e saj».<sup>[42]</sup>

90. Në një dokument të përgatitur prej 300 të rinjsh nga mbarë bota para Sinodit, ata kanë pohuar se «marrëdhëniet *on line* mund të bëhen çnjerëzorizuese. Hapësirat dixhitale na bëjnë të verbër ndaj brishtësisë së tjetrit dhe pengojnë introspeksionin vetjak. Probleme të tilla, si p.sh. pornografia e shtrembërojnë perceptimin e seksualitetit njerëzor nga ana e të rinjve. Teknologjia e përdorur në këtë mënyrë krijon një realitet paralel mashtues, që e shpërfill dinjitetin njerëzor».<sup>[43]</sup> Zhytja në botën virtuale ka favorizuar njëfarë “migrimi dixhital”, domethënë një distancim nga familja, nga vlerat kulturore e fetare, që i shtyn shumë persona drejt një bote vetmie dhe vetësajimi, deri në përvojën e një mungese rrënjësh, megjithëse mbeten fizikisht në të njëjtin vend. Jeta e re dhe shpërthyes e të rinjve, që nxit dhe kërkon afirmimin e personalitetit të tyre, përballet sot me një sfidë të re: ndërveprimi me një botë reale e virtuale në të cilën hyjnë vetëm si në një kontinent të panjohur. Të rinjtë e sotëm janë të parët që e bëjnë këtë sintezë mes asaj që është personale, asaj që është specifike e një kulture dhe asaj që është globale. Por kjo kërkon që të arrijnë të kalojnë prej kontaktit virtual në një komunikim të mirë e të shëndoshë.

#### MIGRANTËT SI PARADIGMË E KOHËS SONË

91. Si të mos kujtojmë të rinjtë e shumtë të përfshirë drejtpërdrejt në migrimet e pafundme? Këto «përfaqësojnë në nivel botëror një dukuri strukturore dhe jo një emergjencë kalimtare. Migrimet mund të ndodhin brenda të njëjtit vend ose mes vendeve të ndryshme. Shqetësimi i Kishës ka lidhje veçanërisht me ata që ikin nga lufta, nga dhuna, nga përndjekja politike apo fetare, nga fatkeqësitë natyrore të shkaktuara prej ndryshimeve klimaterike dhe prej varfërisë së skajshme: shumë prej tyre janë të rinj. Në përgjithësi janë në kërkim të shanseve për veten dhe për familjen e tyre. Ëndërrojnë një të ardhme më të mirë dhe dëshirojnë të krijojnë kushtet që kjo të realizohet».<sup>[44]</sup> Migrantët «na kujtojnë gjendjen zanafillore të fesë, pra atë të të qenit “të huaj dhe udhëtarë përmbi tokë” (Heb 11,13)».<sup>[45]</sup>

92. Migrantë të tjerë janë «të tërhequr prej kulturës perëndimore, duke ushqyer nganjëherë pritshmëri jo realiste që i vënë para zhgënjimeve të mëdha. Pastaj janë trafikantët e paskrupuj, shpesh të lidhur me organizatat e drogës e të armëve, që shfrytëzojnë dobësinë e migrantëve, që gjatë rrugëtimit të tyre shpesh ndeshin dhunën, tregtinë, abuzimin psikologjik e fizik dhe vuajtje të patregueshme. Duhet vënë në dukje dobësia e veçantë e migrantëve të mitur jo të shoqëruar dhe situata e atyre që janë të detyruar të kalojnë shumë vite në kampet e refugjatëve apo që mbeten të bllokuar për një kohë të gjatë në vendet e tranzitit, pa mundur të vazhdojnë shkollën dhe as të shprehin talentet e tyre. Në disa prej vendeve ku ata mbërrijnë, dukuritë migratore ngjallin alarm e frikë, shpesh të nxitura e të shfrytëzuara për qëllime politike. Kështu përhapet një mendësi ksenofobe, mbylljeje në vetvete, ndaj të cilës duhet të reagojmë me vendosmëri».<sup>[46]</sup>

93. «Të rinjtë që migrojnë përjetojnë ndarjen prej kontekstit të tyre të origjinës dhe shpesh edhe një çrrënjosje kulturore e fetare. Kjo ndarje ka lidhje edhe me bashkësitë e prejardhjes, që humbin

elementet e tyre më të fuqishëm e sipërmarrës, si edhe me familjet, veçanërisht kur migron njëri apo të dy prindërit, duke i lënë fëmijët në vendin e prejardhjes. Kisha ka një rol të rëndësishëm si pikë referimi për të rinjtë e këtyre familjeve të ndara. Por ato të migrantëve janë edhe histori takimi mes personave e kulturave: për bashkësitë dhe shoqëritë ku arrijnë janë një mundësi pasurimi e zhvillimi të tërësishëm njerëzor për të gjithë. Nismat e mikpritjes që i referohen Kishës kanë një rol të rëndësishëm nga ky këndvështrim dhe mund të rigjallërojnë ato bashkësi që janë të afta për t'i realizuar ato».<sup>[47]</sup>

94. «Falë prejardhjes së ndryshme të Etërve, në lidhje me temën e migrantëve Sinodi ka parë takimin e shumë perspektivave, në veçanti mes vendeve prej nga ata nisen dhe vendeve ku ata mbërrijnë. Gjithashtu, ka jehuar britma e alarmit e atyre Kishave anëtarët e të cilave janë të detyruar të ikin nga lufta e nga përndjekja dhe që në këto migrime të detyruara shohin një kërcënim për ekzistencën e tyre. Fakti i përfshirjes së të gjitha këtyre perspektivave të ndryshme bën që Kisha të jetë në gjendje të ushtrojë një rol profetik ndaj shoqërisë mbi temën e migrimeve»<sup>[48]</sup>. U kërkoj veçanërisht të rinjve që të mos bien në rrjetat e atyre që duan t'i vënë kundër të rinjve të tjerë, që arrijnë në vendet e tyre, duke i përshkruar ata si subjekte të rrezikshme dhe si të mos kishin të njëjtin dinjitet të pacenueshëm sikurse çdo qenie njerëzore.

#### T'I JEPET FUND ÇDO FORME ABUZIMI

95. Kohët e fundit na është kërkuar me forcë që ta dëgjojmë britmën e viktimave të llojeve të ndryshme të abuzimeve të bëra nga disa ipeshkvij, meshtarë, rregulltarë e laikë. Këto mëkate shkaktojnë te viktimat «vuajtje që mund të zgjasin gjithë jetën dhe të cilat nuk mund t'i shërojnë asnjë pendim. Kjo dukuri është e përhapur në shoqëri, prek edhe Kishën dhe përbën një pengesë serioze për misionin e saj».<sup>[49]</sup>

96. Është e vërtetë se «plaga e abuzimeve seksuale të të miturve është një dukuri historikisht e përhapur mjerisht në të gjitha kulturat e shoqëritë», sidomos brenda vetë familjeve dhe në institucione të ndryshme, përhapja e të cilës është vënë në dukje veçanërisht «falë ndryshimit të ndjeshmërisë së opinionit publik». Megjithatë, «universaliteti i kësaj plage, ndërsa pohon peshën e rëndë të saj në shoqëritë tona, nuk e pakëson mbrapshtinë e saj të tmerrshme brenda Kishës» dhe «në zemërimin, e justifikuar, të njerëzve, Kisha sheh pasqyrimin e zemërimit të Hyjit, të tradhtuar e të rrahur».<sup>[50]</sup>

97. «Sinodi thekson angazhimin e vendosur për marrjen e masave të rrepta parandaluese që pengojnë përsëritjen e saj, duke nisur nga përzgjedhja dhe nga formimi i atyre të cilëve do t'u besohen detyra përgjegjësie dhe edukimi».<sup>[51]</sup> Në të njëjtën kohë, nuk duhet të braktiset më vendimi për të zbatuar «veprime e sanksione kaq të nevojshme».<sup>[52]</sup> Dhe e gjithë kjo me hirin e Krishtit. Nuk mund të kthehem më mbrapa.

98. «Ekzistojnë lloje të ndryshme abuzimi: abuzim pushteti, ekonomik, ndërgjegjeje dhe seksual. Bëhet e qartë detyra për t'i çrrënjësuar format e ushtrimit të autoritetit mbi të cilat mbështeten ato dhe për të kundërshtuar mungesën e përgjegjësisë e të transparencës me të cilën janë trajtuar shumë raste. Dëshira për sundim, mungesa e dialogut dhe e transparencës, format e jetës së dyfishtë, zbrazëtira shpirtërore, si dhe dobësitë psikologjike janë terreni ku lulëzon korrupsioni».<sup>[53]</sup> Klerikalizmi është një tundim i vazhdueshëm i meshtarëve, që e interpretojnë «shërbesën që kanë marrë si një pushtet për ta ushtruar dhe jo si një shërbim falas e bujar për ta ofruar; dhe kjo i bën të mendojnë se i përkasin një grupi që i ka të gjitha përgjigjet dhe që nuk ka më nevojë të dëgjojë e të mësojë asgjë».<sup>[54]</sup> Pa dyshim, klerikalizmi i vë personat e kushtuar para rrezikut që ta humbin respektin për vlerën e shenjtë dhe të pacenueshme të çdo personi dhe të lirisë së tij.

99. Së bashku me Etërit sinodalë, dua t'ua shpreh me dashuri «mirënjohjen time atyre që kanë guximin ta padisin të keqen e pësuar: ata e ndihmojnë Kishën që të ndërgjegjësohet për atë që ka ndodhur dhe për nevojën që ajo të reagojë me vendosmëri».<sup>[55]</sup> Megjithatë, një mirënjohje të veçantë meriton «angazhimi i sinqertë i laikëve dhe i laikeve, i meshtarëve, i të kushtuarve, i të kushtuarave dhe i ipeshkvijve të panumërt, që çdo ditë punojnë me ndershmëri e përkushtim në shërbim të të rinjve. Vepra e tyre është një pyll që rritet pa bërë zhurmë. Shumë prej të rinjve të pranishëm në Sinod kanë shfaqur mirënjohje ndaj atyre që i kanë shoqëruar dhe kanë theksuar nevojën e madhe për figura referimi».<sup>[56]</sup>

100. Faleminderit Hyjit, meshtarët që kanë bërë këto krime të tmerrshme nuk janë shumica, e cila përkundrazi, përbëhet nga ata që jetojnë një shërbesë besnike e zemërgjerë. Të rinjve u kërkoj që ta lejojnë veten të nxiten nga kjo shumicë. Sidoqoftë, nëse shihni një meshtar në rrezik, sepse e ka humbur gëzimin e shërbesës së vet, sepse kërkon kompensime afektive apo ka marrë rrugën e gabuar, kini guximin t'ia kujtoni angazhimin e tij ndaj Hyjit dhe ndaj popullit të tij, shpalljani ju vetë Ungjillin atij dhe nxiteni të rrijë në rrugën e duhur. Duke bërë kështu, jepni një ndihmesë të paçmueshme në një aspekt themelor: parandaloni përsëritjen e këtyre mizorive. Kjo re e zezë bëhet edhe një sfidë për të rinjtë që e duan Jezun Krishtin dhe Kishën e tij, sepse mund të ndihmojnë shumë në shërimin e kësaj plage, nëse fusin në lojë aftësinë e tyre për të përtërirë, për të pretenduar dhe për të kërkuar koherencë e dëshmi, për të ëndërruar dhe për të gjetur mënyra e rrugë të reja.

101. Ky nuk është i vetmi mëkat i gjymtyrëve të Kishës, historia e të cilës paraqet shumë hije. Mëkatet tona janë para syve të të gjithëve; pasqyrohen pa mëshirë në rrudhat e fytyrës mijëvjeçare të Nënës dhe të Mësueses sonë. Sepse ajo ecën që prej dy mijë vjetësh, duke bashkëndarë «gëzimet dhe shpresat, trishtimet dhe ankthet e njerëzve».<sup>[57]</sup> Dhe ecën ashtu siç është, pa përdorur asnjë ndërhyrje estetike. Nuk ka frikë t'i bëjë të njohura mëkatet e gjymtyrëve të saj, që nganjëherë disa prej tyre përpiqen t'i fshehin, para dritës së zjarrtë të Fjalës së Ungjillit që pastron e bën xixë. Dhe nuk resht së përsërituri çdo ditë, me turp: «Ki mëshirë për mua, o Hyj, sipas mëshirës sate; [...] mëkatin tim përherë e kam para sysh» (Ps 51,3.5). Por le të kujtojmë se Nëna nuk braktiset kur është e plagosur, përkundrazi, ajo shoqërohet derisa të nxjerrë prej vetes gjithë forcën dhe aftësinë e vet për t'ia filluar përherë nga e para.

102. Në mes të kësaj tragjedie që, me të drejtë, na plagos shpirtin, «Zoti Jezus, që nuk e braktis kurrë Kishën e vet, i jep asaj forcën dhe mjetet për një ecje të re».<sup>[58]</sup> Kështu, ky moment i errët, «me ndihmën e çmueshme të të rinjve, mund të jetë me të vërtetë një mundësi për një reformë me përmasa epokale»,<sup>[59]</sup> për t'iu hapur Rrëshajëve të reja dhe për të filluar një fazë pastrimi e ndryshimi që i jep Kishës një rini të përtërirë. Por të rinjtë mund të ndihmojnë shumë më tepër nëse me gjithë zemër ndihen pjesë e «Popullit të shenjtë e të durueshëm të Hyjit, të mbështetur e të gjallëruar prej Shpirti Shenjt», pasi «do të jetë pikërisht ky Popull i shenjtë i Hyjit që do të na lirojë prej plagës së klerikalizmit, që është terreni i frytshëm për të gjitha këto llahtare».<sup>[60]</sup>

#### KA NJË RRUGËDALJE

103. Në këtë kapitull jam ndalur për të parë realitetin e të rinjve në botën e sotme. Disa aspekte të tjera me siguri do të dalin në pah në kapitujt e ardhshëm. Siç thashë, nuk pretendoj të jem gjithëpërfshirës në këtë analizë. I nxis bashkësitë të bëjnë me respekt dhe seriozitet një shqyrtim të realitetit të tyre rinor më të afërt, që të dallojnë ecjet baritore më të përshtatshme. Por nuk dua ta mbyll këtë kapitull pa ia drejtuar disa fjalë secilit prej jush.

104. Të kujtoj lajmin e gëzueshëm që na është dhuruar mëngjesin e Ngjalljes: se në të gjitha situatat e errëta dhe të dhimbshme për të cilat flasim ka një rrugëdalje. P. sh., është e vërtetë se bota dixhitale mund të të vërë para rrezikut të mbylljes në vetvete, të izolimit apo të kënaqësisë së

zbrazët. Por mos harro se ka të rinj që edhe në këto fusha janë krijues dhe nganjëherë gjenialë. Është rasti i të riut, të Nderueshmit Karlo Akutis.

105. Ai e dinte shumë mirë se mjetet e komunikimit, të publicitetit dhe të rrjeteve sociale mund të përdoren për të na bërë subjekte të fjetura, të varura nga konsumi dhe nga risitë që mund të blejmë, të obsesionuara nga koha e lirë, të mbyllura në negativitet. Por ai ka ditur t'i përdorë teknikat e reja të komunikimit për të përçuar Ungjillin, për të komunikuar vlera dhe bukuri.

106. Nuk ka rënë në kurth. Shihte se shumë të rinj, megjithëse në dukje të ndryshëm, në fund ishin njësoj si të tjerët, duke vrapuar pas atyre gjërave që të fuqishmit u imponojnë nëpërmjet mekanizmave të konsumit dhe të trulllosjes. Në këtë mënyrë, nuk lejojnë të lulëzojnë dhuratat që Zoti u ka dhënë, nuk i ofrojnë kësaj bote ato aftësi aq personale e unikale që Hyji ka mbjellur te secili. Kështu, thoshte Karloja, ndodh që “të gjithë lindin si origjinalë, por shumë vdesin si fotokopje”. Mos lejo që kjo të të ndodhë edhe ty.

107. Mos lejo që të ta vjedhin shpresën e gëzimin, që të të drogojnë për të të përdorur si skllav për interesat e veta. Guxo të jesh më shumë, sepse qenia jote është më e rëndësishme se gjithçka tjetër. Nuk ke nevojë të zotërosh apo të dukesh. Mund të arrish të jesh ai që Hyji, Krijuesi yt, e di se ti je, nëse pranon se je i thirrur për diçka më shumë. Thirre Shpirtin Shenjt dhe ec me besim drejt pikësnyimit të madh: shenjtërisë. Në këtë mënyrë nuk do të jesh një fotokopje, por do të jesh plotësisht vetvetja.

108. Prandaj ke nevojë të pranosh një gjë themelore: të jesh i ri nuk do të thotë vetëm të kërkosh kënaqësi kalimtare dhe suksese sipërfaqësore. Që rinia ta realizojë qëllimin e vet gjatë jetës tënde, ajo duhet të jetë një kohë e dhurimit zemërgjerë, e kushtimit të sinqertë, e flijimeve që kanë çmim të lartë, por që na bëjnë të frytshëm. Është ashtu siç thoshte një poet i madh: *«Nëse për të rimarrë atë që kam rimarrë më është dashur të humb atë që kam humbur, nëse për të arritur atë që kam arritur më është dashur të duroj atë që kam duruar, nëse për të qenë tani i dashuruar më është dashur të plagosem, mendoj se ka qenë e drejtë të vuaja atë që kam vuajtur, mendoj se ka qenë e drejtë të qaja atë që kam qarë. Sepse, në fund, kam vënë re se një gjë e mirë nuk shijohet veçse pasi të kesh vuajtur për të. Sepse, në fund, kam kuptuar se lulet e pemës jetojnë falë asaj që ndodhet nën dhe»*.<sup>[61]</sup>

109. Nëse je i ri në moshë, por ndihesh i dobët, i lodhur apo i zhgënjyer, kërkoi Jezusit që të të rinojë. Me Të nuk mungon shpresa. Të njëjtën gjë mund të bësh nëse ndihesh i zhytur në vese, në zakone të këqija, në egoizëm apo në rehatinë e sëmurë. Jezusi, plot me jetë, dëshiron të të ndihmojë që t'ia vlejë barra qiranë të jesh i ri. Kështu nuk do ta lësh botën pa atë ndihmë që vetëm ti mund ta japësh, duke qenë unikal dhe i papërsëritshëm siç je.

110. Por, dua të të kujtoj edhe se «është shumë e vështirë të luftojmë kundër lakmisë sonë dhe kundër kurtheve e tundimeve të djallit dhe të botës egoiste nëse jemi të izoluar. I tillë është bombardimi i cili na josh, nëse jemi tepër vetëm e humbasim lehtë kuptimin e realitetit, qartësinë e brendshme, dhe rrëzohemi».<sup>[62]</sup> Kjo vlen sidomos për të rinjtë, sepse së bashku ju keni një forcë të admirueshme. Kur entuziazmoheni për një jetë së bashku, jeni të aftë të bëni flijime të mëdha për të tjerët dhe për bashkësinë. Përkundrazi, izolimi ju dobëson dhe ju vë para të këqijave më të mëdha të kohës sonë.

## KAPITULLI I KATËRT

### SHPALLJA E MADHE PËR TË GJITHË TË RINJTË

111. Përtej çdo rrethane, të gjithë të rinjve dua t'u shpall tani gjënë më të rëndësishme, gjënë e parë, atë për të cilën nuk duhet të heshtet kurrë. Bëhet fjalë për një shpallje që përfshin tri të vërteta të mëdha që të gjithë kemi nevojë t'i dëgjojmë gjithmonë, shumë herë.

#### NJË HYJ QË ËSHTË DASHURI

112. Para së gjithash dua t'i them secilit të vërtetën e parë: "Hyji të do". Nëse e ke dëgjuar më parë, nuk ka rëndësi, dua të ta kujtoj: Hyji të do. Mos dysho kurrë për këtë, çfarëdo që të të ndodhë në jetë. Në çfarëdo rrethane, je pafundësisht i dashur.

113. Ndoshta përvoja e atësisë që ke bërë nuk ka qenë më e mira, babai yt tokësor ndoshta të ka qëndruar larg apo nuk ka qenë i pranishëm ose, ndoshta, ka qenë sundues dhe përvetësues; ose thjesht nuk ka qenë babai për të cilin kishe nevojë. Nuk e di. Por ajo që mund të të them me siguri është se mund të hidhesh krejt i sigurt në krahët e Atit tënd hyjnor, të atij Hyji që të ka dhënë jetën dhe që ta jep atë në çdo moment. Ai do të të mbështesë fort dhe, në të njëjtën kohë, do të provosh se e respekton deri në fund lirinë tënde.

114. Në Fjalën e tij gjejmë shumë shprehje të dashurisë së tij. Është si të jetë duke kërkuar mënyra të ndryshme për ta shfaqur atë, me qëllim që të shohë nëse ndonjëra prej atyre fjalëve mund të arrijë në zemrën tënde.

Nganjëherë paraqitet si ata prindërit e dashur që luajnë me fëmijët e tyre: «I tërhiqja me litarë për njerëz, me zinxhirë të dashurisë; isha për ta, porsi ai që fëmijën e ngre deri në mollëzat e veta» (Oz 11,4).

Nganjëherë shfaqet plot me dashuri si ato nënat që i duan sinqerisht fëmijët e tyre, me një dashuri të thellë që është e paaftë të harrojë dhe të braktisë: «E harron – thua – gruaja foshnjën e vet, që të mos ketë dhimbje për bamin e barkut të vet? Po edhe nëse ndonjëra do të harronte, unë ty kurrë nuk të harroj» (Is 49,15).

Paraqitet madje edhe si një i dashuruar që arrin deri në atë pikë sa ta bëjë tatuazh personin e dashur në pëllëmbën e dorës, që ta ketë gjithmonë afër fytyrën e tij: «Shih, të kam shkruar në duart e mia» (Is 49,16).

Herë të tjera thekson forcën dhe vendosmërinë e dashurisë së tij, që nuk lejon të mposhtet: «Malet mund të zhduken, kodrat mund të tranden, porse dashuria ime s'do të zhduket prej teje as besëlidhja e paqes sime nuk do të trandet» (Is 54,10).

Ose na thotë se na ka pritur që prej amshimit, sepse nuk kemi ardhur në këtë botë rastësisht. Ende para se të ekzistonim, ishim një projekt i dashurisë së tij: «Të desha me dashuri të amshueshme, prandaj ruajta për ty mëshirën» (Jer 31,3).

Ose na vë në dukje se Ai di ta shohë bukurinë tonë, atë që asnjë tjetër nuk mund ta shohë: «U bërë i çmueshëm në sytë e mi, dhe i lavdishëm; unë të dua» (Is 43,4).

Ose na bën të zbulojmë se dashuria e tij nuk është e trishtuar, por gëzim i pastër që përtërihet kur lejojmë që Ai të na dojë: «Në mesin tënd është Zoti Hyji yt, trim mbi trima Shpëtimtar! Do të galdojë për ty hareshëm, i përmalluar nga dashuria, do të kërcejë për ty me gëzim» (Sof 3,17).

115. Për Të ti je realisht i çmueshëm, nuk je i parëndësishëm, je i rëndësishëm për Të, sepse je vepër e duarve të tij. Prandaj të kushton vëmendje dhe të kujton me dashuri. Duhet të kesh besim në «kujtimin e Hyjit: kujtesa e tij nuk është një *hard disc* që regjistron dhe arkivon të gjitha të dhënat tona, kujtesa e tij është një zemër e pasur me dhembshuri, që gëzohet kur fshin përfundimisht çdo gjurmë tonën të së keqes».<sup>[63]</sup> Nuk dëshiron të mbajë llogarinë e gabimeve të tua dhe, në çdo rast, do të të ndihmojë të mësosh diçka edhe prej rrëzimeve të tua. Sepse të do. Përpiqu të qëndrosh një moment në heshtje duke lejuar që Ai të të dojë. Përpiqu t'i bësh të heshtin të gjithë zërat dhe të gjitha britmat e brendshme dhe rri një moment në përqaftimin e tij të dashurisë.

116. Është një dashuri «që nuk imponohet dhe nuk shtyp, një dashuri që nuk mënjanon e nuk bën të heshtë e nuk hesht, një dashuri që nuk poshtëron e nuk nënshtron. Është dashuria e Zotit, dashuri e përditshme, e matur dhe respektuese, dashuri lirie dhe për lirinë, dashuri që shëron e lartëson. Është dashuria e Zotit, që di më shumë për ringritjet sesa për rrëzimet, për pajtimin e sa për ndalimin, për të dhënë një mundësi të re sesa për të dënuar, për të ardhmen sesa për të kaluarën».<sup>[64]</sup>

117. Kur të kërkon diçka ose kur thjesht i lejon sfidat që jeta të paraqet, pret që ti t'i bësh vend për të të shtyrë përpara, për të të nxitur, për të të bërë të piqesh. Nuk e bezdis fakti që ti i shpreh dyshimet e tua, ajo që e shqetëson është kur ti nuk i flet, kur ti nuk i hapesh me sinqeritet Atij. Bibla tregon se Jakobi luftoi me Hyjin (krh. Zan 32,25-31), por kjo nuk e largoi prej rrugës së Zotit. Në të vërtetë Ai vetë na nxit: «Ejani të pleqërohemi» (Is 1,18). Dashuria e tij është kaq reale, kaq e vërtetë, kaq konkrete, se na ofron një marrëdhënie plot dialog të sinqertë dhe të frytshëm. Në fund, kërkoje përqaftimin e Atit tënd qiellor në fytyrën e dashur të dëshmitarëve të tij të guximshëm mbi tokë!

#### KRISHTI TË SHPËTON

118. E vërteta e dytë është se Krishti, për dashuri, ka dhuruar vetveten deri në fund për të të shpëtuar ty. Krahët e tij të hapur në kryq janë shenja më e çmueshme e një miku të aftë për të arritur deri në limit: «Pasi i deshi të vetët – ata që ishin në botë – i deshi deri në fund» (Gjn 13,1). Shën Pali pohonte se jetonte duke iu besuar asaj dashurie që ka dhënë gjithçka: «Këtë jetë që tani e jetoj në trup, e jetoj në fenë e Birit të Hyjit, i cili më deshi dhe e flijoi vetveten për mua» (Gal 2,20).

119. Ai Krisht që na ka shpëtuar mbi kryq prej mëkateve tona, me të njëjtin pushtet të dhurimit të plotë të vetvetes vazhdon të na shpëtojë e të na shëlbojë sot. Shikoje Kryqin e tij, kapu pas Tij, lejo që të të shpëtojë, sepse «ata që lejojnë që Ai t'i shpëtojë janë të liruar prej mëkatit, prej trishtimit, prej zbrazëtisë së brendshme, prej izolimit».<sup>[65]</sup> E nëse mëkaton e largohesh, Ai të ngre përsëri me pushtetin e Kryqit të vet. Mos harro kurrë se «Ai fal shtatëdhjetë herë shtatë. Kthehet për të na vënë mbi shpatullat e veta herë pas here. Askush nuk mund të na e heqë dinjitetin që na jep kjo dashuri e pafundme dhe e patundur. Ai na lejon ta ngrejme kokën e t'ia rifillojmë, me një butësi që nuk na zhgënjën kurrë dhe që gjithmonë mund të na e kthejë gëzimin e humbur».<sup>[66]</sup>

120. Ne «na shpëtoi Jezusi: sepse Ai na do dhe nuk mund të mos na dojë. Mund t'i bëjmë çfarëdo gjëje, por Ai na do dhe na shpëton. Sepse vetëm ai që duhet mund të shpëtohet. Vetëm ai që përqafohet mund të shndërrohet. Dashuria e Zotit është më e madhe se të gjitha kundërshtitë tona, se të gjitha dobësitë tona dhe se të gjitha vogëlsitë tona. Por, pikërisht nëpërmjet kundërshtive, dobësive dhe vogëlsive tona Ai dëshiron ta shkruajë këtë histori dashurie. Ka përqaftuar djalin plangprishës, ka përqaftuar Pjetrin pas mohimeve të tij dhe na përqafton gjithmonë, gjithmonë, gjithmonë pas rrëzimeve tona, duke na ndihmuar që të ngrihemi dhe të rrimë përsëri në këmbë. Sepse rrëzimi i vërtetë, kujdes këtë, ai që mund të na e shkatërrojë jetën, është të rrimë përtokë dhe të mos lejojmë që Ai të na ndihmojë për t'u ngritur».<sup>[67]</sup>

121. Falja dhe shpëtimi i tij nuk janë diçka që e kemi blerë apo që duhet ta arrijmë me veprat apo përpjekjet tona. Ai na fal dhe na liron falas. Dhurimi i tij në kryq është diçka aq e madhe sa ne nuk mund dhe as nuk duhet ta paguajmë, duhet vetëm ta pranojmë me mirënjohje të pafund dhe me gëzimin se na do më shumë sesa mund ta mendojmë: «Ai na deshi më parë» (1 Gjn 4,19).

122. Të rinj të dashur nga Zoti, sa shumë vleni ju që jeni shpërblyer prej gjakut të çmueshëm të Krishtit! Të dashur të rinj, ju «tejkaloni çdo çmim! Nuk jeni pjesë për t'u shitur në ankand! Ju lutem, mos e lini veten të bliheni, mos e lini veten të josheni, mos e lini veten të skllavëroheni prej kolonializimeve ideologjike që na fusin ide të çuditshme në kokë dhe në fund bëhemi skllavër, të varur, të dështuar në jetë. Ju tejkaloni çdo çmim: duhet t'ia përsërisni vetes gjithmonë: nuk jam në

ankand, tejkaloj çdo çmim. Jam i lirë, jam i lirë! Dashurohuni me këtë liri, me lirinë që jep Jezusi».<sup>[68]</sup>

123. Shiko krahët e hapur të Krishtit të kryqëzuar, lejo të të shpëtojë përsëri e përsëri. Dhe kur të afroresh për të rrëfyer mëkatet e tua, beso në mënyrë të patundur në mëshirën e tij që të liron prej fajit. Sodite gjakun e tij të derdhur me shumë dashuri dhe lejo që ky gjak të të pastrojë. Kështu do të rilindësh përsëri e përsëri.

AI JETON!

124. Por është edhe një e vërtetë e tretë, që është e pandashme nga ajo e mëparshme: Ai jeton! Duhet ta kujtojmë shpesh, pasi rrezikojmë ta marrim Jezu Krishtin vetëm si një shembull të mirë të së kaluarës, thjesht si një kujtim, si dikë që na ka shpëtuar dy mijë vjet më përpara. Kjo nuk do të na shërbente për asgjë, do të na linte njësoj si më përpara, nuk do të na lironte. Ai që na mbush me hirin e vet, Ai që na liron, Ai që na shndërron, Ai që na shëron dhe na ngushëllon është dikush që jeton. Është Krishti i ngjallur, plot me gjallëri mbinatyrore, i veshur me dritë të pafundme. Prandaj Shën Pali pohonte: «Po në qoftë se Krishti nuk është ngjallur, e kotë është feja juaj» (1 Kor 15,17).

125. Nëse Ai jeton, atëherë me të vërtetë mund të jetë i pranishëm në jetën tënde, në çdo çast, për ta mbushur atë me dritë. Kështu nuk do të ketë më vetmi dhe braktisje. Edhe nëse të gjithë do të largoheshin, Ai do të qëndrojë aty, sikurse ka premtuar: «Unë jam me ju gjithmonë – deri në të sosur të botës» (Mt 28,20). Ai mbush gjithçka me praninë e tij të padukshme dhe kudo që të shkosh Ai do të jetë duke të të pritur. Sepse jo vetëm ka ardhur, por vjen e do të vazhdojë të vijë çdo ditë për të të ftuar të ecësh drejt horizontesh gjithmonë të reja.

126. Sodite Jezusin e lumtur, plot me gëzim. Gëzohu me Mikun tënd që ka ngadhënjyer. Kanë vrarë shenjtin, të drejtin, të pafajshmin, por Ai ka fituar. E keqja nuk e ka fjalën e fundit. As në jetën tënde e keqja nuk do ta ketë fjalën e fundit, sepse Miku yt që të do dëshiron të ngadhënjë në ty. Shpëtimtari yt jeton.

127. Nëse Ai jeton, kjo është një garanci se e mira mund të hyjë në jetën tonë dhe se mundimet tona do të shërbejnë për diçka. Atëherë mund të reshtim së ankuari dhe të shikojmë përpara, sepse me Të njeriu mund të shikojë gjithmonë përpara. Kjo është siguria që kemi. Jezusi është i gjalli i amshuar. Kapu për Të, do të jetojmë dhe do t'i kalojmë të pacenuar të gjitha format e vdekjes dhe të dhunës që fshihen gjatë rrugës.

128. Çfarëdo zgjidhjeje tjetër do të ishte e dobët dhe e përkohshme. Ndoshta do të jetë e dobishme për pak kohë, pastaj do të gjendeshim përsëri të pambrojtur, të braktisur, të rrezikuar prej stuhive. Ndërsa me Të zemra është e rrënjësuar në një siguri bazë, që qëndron përtej gjithçkaje. Shën Pali thotë se dëshiron të jetë i bashkuar me Krishtin «që ta njoh atë dhe fuqinë e ngjalljes së tij» (Fil 3,10). Është fuqia që do të dëftohet shumë herë edhe në ekzistencën tënde, sepse Ai ka ardhur për të ta dhënë jetën, «në plotësi» (Gjn 10,10).

129. Nëse arrin ta çmosh me zemër bukurinë e këtij lajmi dhe të lejosh që Zoti të të takojë; nëse lejon që Ai të të dojë e të të shpëtojë; nëse hyn në miqësi me Të e fillon të bisedosh me Krishtin e gjallë në lidhje me gjërat konkrete të jetës tënde, kjo do të jetë përvoja më e madhe, do të jetë përvoja themelore ku do ta mbështetësh jetën tënde të krishterë. Kjo është përvoja që mund t'ua komunikosh edhe të rinjve të tjerë. Sepse «të jesh i krishterë nuk është një vendim etik apo një ide e madhe, por është takimi me një ngjarje, me një Person, që i jep jetës një horizont të ri dhe me këtë gjë i jep asaj edhe një drejtim vendimtar».<sup>[69]</sup>

SHPIRTI JEP JETË

130. Në këto tri të vërteta – Hyji të do, Krishti është shpëtimtari yt, Ai jeton – shfaqet Hyji Atë dhe shfaqet edhe Jezusi. Aty ku janë Ati dhe Jezusi, aty është edhe Shpirti Shenjt. Është Ai që i përgatit dhe i hap zemrat që ta pranojnë këtë lajm, është Ai që e mban të gjallë përvojën e shpëtimit, është Ai që do të të ndihmojë të rritesh në këtë gëzim nëse ti e lë të veprojë. Shpirti Shenjt e mbush zemrën e Krishtit të ngjallur dhe prej aty derdhet në jetën tënde si burim. Dhe kur ti e pranon, Shpirti Shenjt të bën të hysh gjithnjë e më shumë në zemrën e Krishtit, që ti të jesh gjithnjë e më i mbushur me dashurinë e tij, me dritën e tij dhe me forcën e tij.

131. Thirrë çdo ditë Shpirtin Shenjt që të përtërijë vazhdimisht në ty përvojën e lajmit të madh. Pse jo? Nuk humb asgjë dhe Ai mund ta ndryshojë jetën tënde, mund ta ndriçojë dhe t'i japë asaj një drejtim më të mirë. Nuk të cungon, nuk të heq asgjë, madje, të ndihmon të gjesh atë për të cilën ke nevojë në mënyrën më të mirë. A ke nevojë për dashuri? Nuk do ta gjesh atë në shfrenim, duke përdorur të tjerët, duke i zotëruar apo duke i sunduar ata. Do ta gjesh në një mënyrë që do të të bëjë me të vërtetë të lumtur. Kërkon intensitetin? Nuk do ta jetosh atë duke grumbulluar objekte, duke shpenzuar para, duke vrapuar me dëshpërim pas gjërave të kësaj bote. Do të vijë në një mënyrë shumë më të bukur dhe më të kënaqshme nëse do të lejosh të të udhëheqë Shpirti Shenjt.

132. Kërkon pasion? Siç thotë një poezi e bukur: dashurohu! (ose lëre veten të dashurohesh), sepse «asgjë nuk mund të jetë më e rëndësishme sesa ta takosh Hyjin. Domethënë, të dashurohesh me Të në një mënyrë përfundimtare dhe absolute. Ajo me të cilën ti dashurohesh e robëron përfytyrimin tënd dhe arrin të lërë gjurmën e vet në gjithçka. Ajo do të vendosë se çfarë do të të bëjë të ngrihesh prej shtratit në mëngjes, çfarë do të bësh në fund të ditës, si do t'i kalosh fundjavat e tua, se çfarë lexon, çfarë di, çfarë ta thyen zemrën dhe çfarë të mbush me gëzim e mirënjohje. Dashurohu! Rri në dashuri! Gjithçka do të jetë ndryshe».<sup>[70]</sup> Kjo dashuri e Hyjit, që e merr me pasion gjithë jetën, është e mundshme falë Shpirtit Shenjt, sepse «dashuria e Hyjit u ndikua në zemrat tona me anë të Shpirtit Shenjt që na u dhurua» (Rom 5,5).

133. Ai është burimi i rinisë më të mirë. Sepse ai që ka besim në Zotin «do të jetë pors i druri i mbëltuar në breg të ujit, që kah përroi i lëshon rrënjët e s'do të trembet kur të vijë zhegu: gjethi i tij do të jetë i blertë» (Jer 17,8). Ndërsa «lodhen të rinjtë edhe meken» (Is 40,30), ata që e vënë besimin e tyre në Zotin «përtëriten në fuqi, marrin krahë pors i shqiponja, vrapojnë e nuk lodhen kurrë, ecin edhe kurrë nuk meken» (Is 40,31).

## KAPITULLI I PESTË

### RRUGËTIME RINORE

134. Si e jetojmë rininë kur lejojmë të na ndriçojë dhe të na shndërrojë lajmi i madh i Ungjillit? Është e rëndësishme t'ia bëjmë vetes këtë pyetje, sepse rinia, më shumë sesa një mburrje, është një dhuratë e Hyjit: «Të jesh i ri është një hir, një fat».<sup>[71]</sup> Është një dhuratë që mund ta shkapërderdhim kot, ose që mund ta marrim me mirënjohje dhe ta jetojmë në plotësi atë.

135. Hyji është autori i rinisë dhe vepron te çdo i ri. Rinia është një kohë e bekuar për të riun dhe një bekim për Kishën e për botën. Është një gëzim, një këngë shprese e një lumturi. Ta çmosh rininë do të thotë ta shohësh këtë periudhë të jetës si një moment të çmueshëm dhe jo si një fazë kalimtare në të cilën të rinjtë ndihen të shtyrë drejt moshës së rritur.

### KOHË ËNDRRASH DHE ZGJEDHJESH

136. Në kohën e Jezusit dalja prej fëmijërisë ishte një pjesë e jetës shumë e pritur, shumë e kremtuar dhe tejet e festuar. Prandaj, kur Jezusi i ktheu jetën një «fëmije» (Mk 5,39), e shtyu atë që të bënte



një hap më shumë, e bëri të rritej e të bëhej «vajzë» (Mk 5,41). Kur i tha: «Vajzë, çohu!» (talitá kum), në të njëjtën kohë e bëri më përgjegjëse për jetën e vet, duke i hapur asaj dyert e rinisë.

137. «Rinia, fazë e zhvillimit të personalitetit, karakterizohet nga ëndrra që shkojnë duke u konkretizuar, nga marrëdhënie që fitojnë gjithnjë e më shumë qëndrueshmëri dhe ekuilibër, nga përpjekje dhe eksperimentime, nga zgjedhje që ndërtojnë gradualisht një projekt jete. Në këtë stinë të jetës të rinjtë janë të thirrur të projektohen përpara pa i prerë rrënjët, të ndërtojnë autonominë, por jo në vetmi».<sup>[72]</sup>

138. Dashuria e Hyjit dhe marrëdhënia jonë me Krishtin e gjallë nuk na pengojnë të ëndërrojmë, nuk na kërkojnë t'i ngushtojmë horizontet tona. Përkundrazi, kjo dashuri na nxit, na shtyn, na projekton drejt një jete më të mirë dhe më të bukur. Fjala «shqetësim» përmbledh shumë prej aspiratave të zemrave të të rinjve. Sikurse thoshte Shën Pali VI, «pikërisht në pakënaqësinë që ju mundon [...] ka një element drite».<sup>[73]</sup> Shqetësimi i pakënaqur, së bashku me mahnitjen për risitë që paraqiten në horizont, i hap udhën guximit që i nxit ta marrin jetën e tyre në dorë dhe të bëhen përgjegjës të një misioni. Ky shqetësim i shëndetshëm, që zgjohet sidomos në rini, është karakteristika e çdo zemre që mbetet e re, e gatshme, e hapur. Paqja e vërtetë e brendshme bashkëjeton me këtë pakënaqësi të thellë. Shën Agustini thoshte: «O Zot, na ke bërë për vete dhe zemra jonë është e shqetësuar derisa të mos pushojë në ty».<sup>[74]</sup>

139. Disa kohë më parë një mik më pyeti se çfarë shoh unë kur mendoj për një të ri. Përgjigjja ime qe: «Shoh një djalë apo një vajzë që kërkon rrugën e vet, që dëshiron të fluturojë me këmbë në tokë, që del para botës dhe e shikon horizontin me sytë plot shpresë, plot të ardhme, si edhe plot me iluzione. I riu ecën me dy këmbë sikurse të rriturit, por në ndryshim prej tyre që i mbajnë ato paralel, njërin këmbë i riu e ka gjithmonë para tjetrës, i gatshëm për t'u nisur, për të shpërthyer. Gjithmonë i hedhur përpara. Të flasësh për të rinjtë do të thotë të flasësh për premtime, për gëzime. Kanë shumë forcë të rinjtë, janë të aftë të shikojnë me shpresë. Një i ri është një premtim jete, që ka brenda vetes njëfarë shkalle këmbënguljeje; ka aq marrëzi sa ta gënjejë veten dhe aq aftësi sa të shërohet prej zhgënjimit të mundshëm».<sup>[75]</sup>

140. Disa të rinj ndoshta e refuzojnë këtë etapë të jetës, sepse do të donin të mbeteshin fëmijë, ose dëshirojnë «një zgjatje të papërcaktuar të adoleshencës dhe shtyrjen e vendimeve; frika nga përfundimtarja krijon kështu njëfarë paralize vendimmarrëse. Por rinia nuk mund të mbetet një kohë e pezulluar: ajo është mosha e zgjedhjeve dhe pikërisht këtu qëndron bukuria dhe detyra e saj më e madhe. Të rinjtë marrin vendime në fushën profesionale, shoqërore, politike, si edhe në fusha të tjera më rrënjësore që do t'i japin ekzistencës së tyre një strukturë përcaktuese».<sup>[76]</sup> Marrin vendime edhe për sa i përket dashurisë, zgjedhjes së partnerit apo bërjes prind. Do t'i thellojmë këto tema në kapitujt e fundit, kushtuar thirrjes dhe shoshitjes së saj.

141. Por kundër ëndrrave që frymëzojnë vendimet, gjithmonë «ekziston rreziku i ankimit, i dorëzimit. Këta le t'ua lëmë atyre që ndjekin «hyjninë ankesë»! [...] është një mashtrim: të bën të marrësh rrugën e gabuar. Kur gjithçka duket e ndalur dhe e ndenjmur, kur problemet personale na shqetësojnë dhe problemet shoqërore nuk gjejnë përgjigjet e duhura, nuk është mirë të dorëzohemi. Rruga është Jezusi: ta lëmë të ngjitet në «barkën» tonë dhe të dalim në det të hapur me Të! Ai është Zoti! Ai e ndryshon perspektivën e jetës sonë. Feja në Jezusin na jep një shpresë që shkon përtej, në një siguri të mbështetur jo vetëm në cilësitë dhe aftësitë tona, por në Fjalën e Hyjit, në ftesën që vjen prej Tij. Pa bërë tepër llogari njerëzore dhe pa u shqetësuar për të verifikuar nëse realiteti që ju rrethon përputhet me siguritë tuaja. Dilni në det të hapur, dilni prej vetvetes».<sup>[77]</sup>

142. Duhet të qëndrojmë në rrugën e ëndrrave. Duhet të kemi kujdes nga një tundim që shpesh na bën shaka të hidhura: ankthi. Ai mund të kthehet në një armik të madh kur na bën të dorëzohemi, sepse zbulojmë se rezultatet nuk janë të menjëhershme. Ëndrrat më të bukura arrihen me shpresë, durim dhe angazhim, duke hequr dorë prej nxitimit. Në të njëjtën kohë, nuk duhet të bllokohemi

prej pasigurisë, nuk duhet të kemi frikë që të rrezikojmë dhe të bëjmë gabime. Në fakt, duhet të kemi frikë që të jetojmë si të paralizuar, si të vdekur të gjallë, të kthyer në subjekte që nuk jetojnë, sepse nuk duan të rrezikojnë, duke mos u angazhuar prej frikës se mos gabojnë. Edhe nëse gabon, gjithmonë mund ta ngresh kokën dhe t'ia rifillosh, pasi askush nuk ka të drejtë që të ta vjedhë shpresën.

143. Të rinj, mos hiqni dorë nga më e mira e rinisë suaj, mos e shikoni jetën nga ballkoni. Mos e ngatërroni lumturinë me një divan dhe mos e kaloni gjithë jetën tuaj para një ekrani. Mos u ktheni as në spektaklin e trishtueshëm të një mjeti të braktisur. Mos jini makina të parkuara, lejoni që ëndrrat të çelin dhe merrni vendime. Rrezikoni, edhe nëse do të gaboni. Mos mbijetoni me shpirt të anestetizuar dhe mos e shikoni botën si të ishit turistë. Ngrijeni zërin! Mposhtini frikat që ju paralizojnë, për të mos u bërë të rinj mumje. Jetoni! Kushtojuni më të mirës së jetës! Hapini dyert e kafazit dhe fluturoni larg! Ju lutem, mos dilni në pension para kohe.

#### DËSHIRA PËR TË JETUAR DHE PËR TË EKSPERIMENTUAR

144. Ky projektim drejt së ardhmes që ëndërrohet, nuk do të thotë se të rinjtë janë krejtësisht të projektuar përpara, sepse në të njëjtën kohë në ta ka një dëshirë të fortë për të jetuar të tashmen, për të shfrytëzuar në maksimum mundësitë që kjo jetë u dhuron. Kjo botë është plot me bukuri! Si mund t'i përbuzim dhuratat e Hyjit?

145. Ndryshe nga sa shumë vetë mendojnë, Zoti nuk dëshiron ta zhdukë këtë dëshirë për të jetuar. Është mirë të kujtojmë atë që mësonte një i urtë i Besëlidhjes së Vjetër: «Bir, nëse ke, mos e lër veten keq [...]. Mos ia moho vetes një ditë të lume» (Sir 14,11.14). Hyji i vërtetë, ai që të do, të do të lumtur. Ja përse në Bibël gjejmë edhe këtë këshillë drejtuar të rinjve: «Gëzo, pra, o djalosh, në rininë tënde dhe galdo në ditët e djalërisë sate. [...] Flake dhimbjen nga trupi yt» (Kish 11,9-10). Sepse është Hyji ai që «na jep gjithçka me begati për ta gëzuar» (1 Tim 6,17).

146. Si mund t'i jetë mirënjohës Hyjit ai që nuk është i zoti t'i gëzojë dhuratat e veta të vogla çdo ditë, ai që nuk di të ndalet para gjërave të thjeshta e të këndshme që ndesh në çdo hap? Sepse «s'ka gjë më të keqe se ai që ia ka smirë vetvetes» (Sir 14,6). Nuk do të thotë të jesh i pangishëm, gjithmonë i obsesionuar nga kënaqësi pa fund, pasi kjo do të të pengojë ta jetosh të tashmen. Por do të thotë të dish t'i hapësh sytë dhe të ndalesh për ta jetuar plotësisht dhe me mirënjohje çdo dhuratë të vogël të jetës.

147. Është e qartë se Fjala e Hyjit të fton ta jetosh të tashmen, jo vetëm të përgatisësh të nesërmen: «Mos u brengosni për të nesërmen, sepse e nesërmja do të kujdeset vetë për vete. Secilës ditë i del mjaft mundimi i vet» (Mt 6,34). Por kjo nuk do të thotë të hidhemi në një shfrenim të papërgjegjshëm që na lë të zbrazët dhe gjithmonë të pakënaqur, por ta jetojmë plotësisht të tashmen, duke i përdorur energjitë për gjëra të mira, duke kultivuar vëllazërinë, duke ndjekur Jezusin dhe duke e çmuar çdo gëzim të vogël të jetës si një dhuratë të dashurisë së Hyjit.

148. Në lidhje me këtë, do të doja të kujtoja se Kardinali Francesco Saverio Nguyễn Van Thuân, kur e burgosën në një kamp përqendrimi nuk deshë që ditët e tij të kalonin vetëm duke pritur e shpresuar për një të ardhme më të mirë. Zgjodhi «të jetonte momentin e tashëm duke e mbushur atë me dashuri»; dhe mënyra me të cilën e realizonte atë ishte kjo: «Shfrytëzoj rastet që paraqiten çdo ditë, për të kryer vepra të zakonshme në mënyrë të jashtëzakonshme».[78] Ndërsa lufton për t'i realizuar ëndrrat e tua, jetoje plotësisht të sotmen, dhuroje atë krejtësisht dhe mbushe me dashuri çdo çast. Sepse është e vërtetë se kjo ditë e rinisë sate mund të jetë e fundit, e atëherë ia vlen ta jetosh me gjithë dëshirën dhe me gjithë thellësinë e mundshme.

149. Kjo vlen edhe për çastet e vështira, që duhet të jetohen thellësisht, me qëllim që ta kuptojmë mesazhin e tyre. Siç mësojnë Ipeshkvijtë zviceranë: «Ai është aty ku ne mendonim se na kishte braktisur dhe se nuk kishte më asnjë mundësi shpëtimi. Është një paradoks, por vuajtja dhe errësitat janë bërë për shumë të krishterë [...] vendi ku ata kanë takuar Hyjin».<sup>[79]</sup> Gjithashtu, dëshira për të jetuar e për të bërë përvoja të reja ka lidhje veçanërisht me shumë të rinj në gjendje paaftësie fizike, psikike e ndjesore. Ata, edhe pse nuk mund t'i bëjnë përvojat e bashkëmoshatarëve të tyre, kanë burime befasuese, të paimagjinueshme, që nganjëherë kapërcejnë ato të zakonshmet. Zoti Jezus i mbush ata me dhurata të tjera, të cilat bashkësia është e thirrur t'i vlerësojë, me qëllim që të zbulojnë planin e tij të dashurisë për secilin prej tyre.

#### NË MIQËSI ME KRISHTIN

150. Sado të jetosh e të bësh përvoja, nuk do të arrish në thellësinë e rinisë, nuk do ta njohësh plotësinë e vërtetë të të qenit i ri, nëse nuk takon çdo ditë Mikun e madh, nëse nuk jeton në miqësi me Jezusin.

151. Miqësia është një dhuratë e jetës dhe një dhuratë e Hyjit. Nëpërmjet miqve, Zoti na pastron dhe na bën të piqemi. Në të njëjtën kohë, miqtë besnikë, që janë përkrah nesh në momentet e vështira, janë një pasqyrim i dashurisë së Zotit, i ngushëllimit dhe i pranisë së tij plot dashuri. Fakti që kemi miq na mëson të hapemi, të kuptojmë, të kujdesemi për të tjerët, të dalim prej rehative dhe izolimit tonë, të bashkëndajmë jetën tonë me ta dhe me të tjerët. Ja përse «miku besnik s'mund të çmohet» (Sir 6,15).

152. Miqësia nuk është një marrëdhënie e shkurtër dhe kalimtare, por e qëndrueshme, e fortë, besnike, që piqet me kalimin e kohës. Është një marrëdhënie dashamirësie që na bën të ndihemi të bashkuar, dhe në të njëjtën kohë është një dashuri bujare që na bën të kërkojmë të mirën e mikut. Edhe pse miqtë mund të jenë shumë të ndryshëm prej njëri-tjetrit, ka gjithmonë disa gjëra të përbashkëta që i bëjnë të ndihen afër, ka një intimitet që bashkëndajnë me sinqeritet dhe besim.

153. Miqësia është aq e rëndësishme sa vetë Jezusi e paraqet veten si mik: «Nuk ju thërras më shërbëtorë, unë ju quajta miq» (Gjn 15,15). Prej hirit që Ai na jep, jemi të lartësuar në mënyrë të tillë sa jemi me të vërtetë miqtë e tij. Me të njëjtën dashuri që Ai derdh në ne, mund ta duam, duke e shtrirë dashurinë e tij mbi të tjerët, me shpresën se edhe ata do ta gjejnë vendin e tyre në bashkësinë e miqësisë të themeluar prej Jezu Krishtit.<sup>[80]</sup> E megjithëse Ai tashmë është plotësisht i lumtur si i ngjallur, është e mundur të jemi bujarë me Të, duke e ndihmuar që të ndërtojë Mbretërinë e tij në këtë botë, duke qenë mjetet e tij për t'ua çuar mesazhin, dritën dhe sidomos dashurinë e tij të tjerëve (krh. Gjn 15,16). Nxënësit e kanë dëgjuar thirrjen e Jezusit në miqësinë me Të. Ishte një ftesë që nuk i detyroi, por që i propozojë me delikatesë lirisë së tyre: «Ejani e shihni», u tha atyre, dhe ata «shkuan e panë ku banonte dhe atë ditë ndenjën tek ai» (Gjn 1,39). Pas atij takimi, intim dhe të papritur, lanë gjithçka dhe shkuan me Të.

154. Miqësia me Jezusin është e pazgjidhshme. Ai nuk na braktis kurrë, edhe pse nganjëherë duket se rri në heshtje. Kur kemi nevojë për Të, bën të mundur që ta gjejmë (krh. Jer 29,14) dhe rri përkrah nesh kudo që shkojmë (krh. Joz 1,9). Sepse Ai nuk e prish kurrë besëlidhjen e vet. Neve na kërkon që të mos e braktisim: «Banoni në mua sikurse edhe unë në ju» (Gjn 15,4). Por nëse largohemi, «Ai mbetet besnik! Sepse Ai kurrsesi nuk mund ta mohojë vetveten» (2 Tim 2,13).

155. Me mikun flasim, bashkëndajmë gjërat më sekrete. Edhe me Jezusin bisedojmë. Lutja është një sfidë dhe një aventurë. E çfarë aventure se! Na bën të mundur që ta njohim gjithnjë e më mirë, të hyjmë në thellësinë e tij dhe të rritemi në një bashkim gjithnjë e më të fortë me të. Lutja na lejon t'i tregojmë gjithçka që na ndodh dhe të rrimë me besim në krahët e tij, dhe në të njëjtën kohë na dhuron momente të çmueshme intimiteti e dashurie, gjatë të cilëve Jezusi derdh në ne jetën e vet.

Duke u lutur «bëjmë lojën e tij», i bëjmë vend «në mënyrë që Ai të veprojë dhe të hyjë për të fituar».<sup>[81]</sup>

156. Kështu arrijmë të përjetojmë një njësi të vazhdueshme me Të, që kapërcen gjithçka që mund të jetojmë me persona të tjerë: «Jetoj, por jo më unë, në mua jeton Krishti» (Gal 2,20). Mos e privo rininë tënde nga kjo miqësi. Do ta ndiesh përkrah teje jo vetëm kur lutesh. Do të kuptosh se Ai ecën me ty çdo çast. Përpiqu ta zbulosh dhe do të jetosh përvojën e bukur të të ndierit gjithmonë i shoqëruar. Është ajo që kanë përjetuar nxënësit e Emausit kur, ndërsa po ecnin e po bisedonin të çorientuar, Jezusi u bë i pranishëm dhe «po ecte me ta» (Lk 24,15). Një Shenjt thoshte se «krishterimi nuk është një tërësi të vërtetash në të cilat duhet të besojmë, një seri ligjesh që duhet t'i zbatojmë apo ndalimesh që duhet t'i kemi parasysh. Kështu duket e neveritshme. Krishterimi është një Person që më ka dashur aq shumë sa kërkon që edhe unë ta dua atë. Krishterimi është Krishti».<sup>[82]</sup>

157. Jezusi mund t'i bashkojë të gjithë të rinjtë e Kishës në një ëndërr të vetme, «një ëndërr e madhe dhe një ëndërr e aftë t'i përfshijë të gjithë. Ëndërrën për të cilën Jezusi ka dhënë jetën e vet në kryq dhe për të cilën Shpirti Shenjt ka zbritur dhe e ka vulosur me zjarr, ditën e Rrëshajëve, në zemrën e çdo burri e të çdo gruaje, në zemrën e secilit prej nesh, [...] e ka ngulitur atë me shpresën se do të gjejë hapësirë për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar. Një ëndërr, një ëndërr e quajtur Jezus, e mbjellur nga Ati: Hyj sikurse Ai, sikurse Ati, i dërguar prej Atit me besimin se do të rritet e do të jetojë në çdo zemër. Një ëndërr konkrete, që është një Person, që rrjedh në venat tona dhe që e bën zemrën tonë të rrahë fort».<sup>[83]</sup>

#### RRITJA DHE PJEKURIMI

158. Shumë të rinj shqetësohen për trupin e tyre, duke u përpjekur që të zhvillojnë forcën fizike apo dukjen e jashtme. Të tjerë punojnë për të fuqizuar aftësitë e njohuritë e tyre, dhe në këtë mënyrë ndihen më të sigurt. Disa synojnë më lart, ata përpiqen të angazhohen më shumë dhe kërkojnë një zhvillim shpirtëror. Shën Gjoni apostull thoshte: «Ju shkrova, o të rinj: jini të fortë e fjala e Hyjit është në ju» (1 Gjn 2,14). Kërkimi i Zotit, ruajtja e Fjalës së tij, përpjekja për t'u përgjigjur me jetën personale, rritja në virtyte, kjo i bën të forta zemrat e të rinjve. Prandaj duhet ta ruajmë “lidhjen” me Jezusin, të jemi “në linjë” me Të, sepse nuk do të rritesh në lumturi e në shenjtëri vetëm me forcat e tua dhe me mendjen tënde. Ashtu siç kujdesesh që të mos e humbasësh lidhjen me Internetin, sigurohu që të jetë aktive edhe lidhja jote me Zotin: mos e ndërprit dialogun me të, dëgjoje, tregoja hallet e tua dhe kur nuk i ke idetë e qarta në lidhje me atë se çfarë duhet të bësh, pyete: «O Jezus, çfarë do të bëje Ti po të ishe në vendin tim?».<sup>[84]</sup>

159. Uroj që ta vlerësosh aq shumë veten tënde dhe ta marrësh aq seriozisht atë, sa të kërkosh rritjen tënde shpirtërore. Përveç entuziazmit tipik të rinisë, ekziston edhe bukuria e kërkimit «të drejtësisë, fesë, dashurisë, paqes» (2 Tim 2,22). Kjo nuk do të thotë të humbasësh spontanitetin, freskinë, entuziazmin, ëmbëlsinë. Sepse të bëhesh i rritur nuk do të thotë t'i braktisësh vlerat më të mira të kësaj faze të jetës. Përndryshe, Zoti mund të të qortojë një ditë: «Me mall të kujtoj, e kujtoj afshin e rinisë sate, dashurinë e fejesës sate, kur më ndoqe në shkretëtirë» (Jer 2,2).

160. Nga ana tjetër, edhe një i rritur duhet të piqet pa i humbur vlerat e rinisë. Sepse në realitet çdo fazë e jetës është një hir i përhershëm, përmban një vlerë që nuk duhet të kalojë. Një rini e kaluar mirë mbetet si përvojë e brendshme dhe në jetën e rritur ajo përvetësohet, thellohet dhe vazhdon të japë frytet e veta. Nëse është tipike e të riut që të ndihet i tërhequr prej pafundësisë që hapet dhe që fillon,<sup>[85]</sup> njëri prej rreziqeve të jetës së rritur, me siguritë e rehatitë e veta, është edhe lënia pas dore gjithnjë e më shumë e këtij horizonti dhe humbja e vlerës së viteve të rinisë. Ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta: të piqet, të rritet dhe ta organizojë jetën e vet pa e humbur atë tërheqje, atë hapje të madhe, atë mahnitje për një realitet që është gjithmonë diçka më shumë. Në çdo moment të

jetës mund ta përtërijmë dhe ta shtojmë rininë tonë. Kur kam filluar shërbesën time si Papë, Zoti i ka zgjeruar horizontet e mia dhe më ka dhënë një rini të përtërirë. E njëjta gjë mund t'i ndodhë një çifti të martuar prej shumë vitesh, ose një murgu në manastirin e vet. Ka gjëra që kanë nevojë të depozitohen në vite, por ky pjekurim mund të bashkëjetojë me një zjarr që përtërihet, me një zemër gjithmonë të re.

161. Të rritesh do të thotë të ruash e të ushqesh gjërat më të çmueshme që të dhuron rinia, por në të njëjtën kohë do të thotë të jesh i hapur për ta pastruar atë që nuk është e mirë dhe për të marrë dhurata të reja prej Hyjit që të thërret ta zhvillosh atë që vlen. Nganjëherë, komplekset e inferioritetit mund të të shtyjnë që të mos duash t'i shohësh të metat e dobësitë e tua dhe në këtë mënyrë mund t'i mbyllesh rritjes e pjekurimit. Por lejo që Hyji të të dojë, sepse Ai të do ashtu siç je, të çmon dhe të respekton, por edhe të ofron gjithnjë e më shumë: më shumë miqësi me Të, më shumë zell në lutje, më shumë etje për Fjalën e tij, më shumë dëshirë për ta marrë Krishtin në Eukaristi, më shumë dëshirë për ta jetuar Ungjillin e tij, më shumë forcë të brendshme, më shumë paqe e gëzim shpirtëror.

162. Por të kujtoj se nuk do të jesh i shenjtë dhe i realizuar duke kopjuar të tjerët. Dhe as të imitosh shenjtërit nuk do të thotë të kopjosh mënyrën e tyre të të qenit dhe të të jetuarit të shenjtërisë: «Ka dëshmi që janë të dobishme për të na nxitur e për të na motivuar, por jo se përipiqemi t'i kopjojmë, pasi kjo madje mund të na largojë prej rrugës unike dhe specifike që Zoti ka menduar për ne».<sup>[86]</sup> Ti duhet të zbulosh se kush je dhe të zhvillosh mënyrën tënde personale të të qenit i shenjtë, pavarësisht asaj që thonë dhe mendojnë të tjerët. Të bëhesh i shenjtë do të thotë të bëhesh më plotësisht vetvetja, do të thotë të bëhesh ai që Hyji ka ëndërruar dhe ka krijuar, jo një fotokopje. Jeta jote duhet të jetë një nxitje profetike, që të jetë frymëzim për të tjerët, që të lërë gjurmë në këtë botë, atë gjurmë unike që vetëm ti mund ta lësh. Ndërsa, nëse kopjon, do ta privosh këtë tokë, si edhe qiellin, nga gjithçka që askush tjetër nuk mund ta japë në vendin tënd. Më kujtohet që Shën Gjoni i Kryqit, në Këngën e tij Shpirtërore, shkruante se secili duhej të përfitonte prej këshillave të tij shpirtërore «në mënyrën e vet»,<sup>[87]</sup> sepse Hyji ka dashur t'ua dëftojë hirin e vet «disave në një mënyrë dhe të tjerëve në një mënyrë tjetër».<sup>[88]</sup>

#### RRUGËTIME VËLLAZËRIE

163. Rritja jote shpirtërore shprehet sidomos në dashurinë vëllazërore, bujare, të mëshirshme. Shën Pali thoshte: «Bëftë Zoti që të rritet e të shtohet përherë e më tepër dashuria juaj ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj të gjithë njerëzve siç është dashuria jonë ndaj jush» (1 Sel 3,12). Jetofsh gjithnjë e më shumë atë “ekstazë”, që të bën të dalësh prej vetvetes për të kërkuar të mirën e të tjerëve, deri në dhurimin e jetës.

164. Takimi me Hyjin quhet “ekstazë” kur na nxjerr prej vetvetes dhe na lartëson, të mahnitur prej dashurisë dhe bukurisë së Hyjit. Por mund të dalim prej vetvetes edhe për të parë bukurinë e fshehur në çdo qenie njerëzore, për të parë dinjitetin dhe madhësinë e tij si shëmbëlltyrë e Hyjit dhe si bir i Atit. Shpirti Shenjt dëshiron të na shtyjë të dalim prej vetvetes, të përqafojmë të tjerët me dashuri dhe të kërkojmë të mirën e tyre. Prandaj është më mirë që ta jetojmë fenë së bashku dhe ta shprehim dashurinë tonë në jetën e bashkësisë, duke bashkëndarë me të rinj të tjerë dashurinë, kohën, fenë dhe shqetësimet tona. Kisha ofron hapësira të shumta e të ndryshme për ta jetuar fenë në bashkësi, sepse së bashku gjithçka është më e lehtë.

165. Plagët që ke marrë mund të të shtyjnë drejt izolimit, mbylljes në vetvete, mbajtjes inat, por mos resht kurrë së dëgjuari thirrjen e Hyjit për të falur. Sikurse kanë mësuar mirë Ipeshkvijtë e Ruandës, «pajtimi me tjetrin kërkon para së gjithash që të zbulojmë në të shkëlqimin e shëmbëlltyrës së Hyjit. [...] Në këtë këndvështrim, është jetësore ta dallojmë mëkatarin prej mëkatit të tij dhe prej fyerjes së tij, për të arritur në pajtimin e vërtetë. Kjo do të thotë ta urresh të keqen që

tjetri ta bën, por të vazhdojë ta duash atë [tjetrin], sepse e pranon dobësinë e tij dhe sheh shëmbëlltyrën e Hyjit në të».<sup>[89]</sup>

166. Nganjëherë të gjitha energjitë, ëndrrat dhe entuziazmi i rinisë dobësohen prej tundimit për t'u mbyllur në vetvete, në problemet tona, në ndjenjat e plagosura, në ankesat e në rehatitë tona. Por ti mos lejo që të të ndodhë kjo gjë, sepse do të bëhesh plak përbrenda dhe përpara kohe. Çdo moshë ka bukurinë e vet dhe rinisë nuk mund t'i mungojnë utopia e bashkësisë, aftësia për të ëndërruar së bashku, horizontet e shikuara bashkë me të tjerët.

167. Hyji e do gëzimin e të rinjve dhe i fton ata sidomos në harenë që jetohet në bashkimin vëllazëror, në kënaqësinë e epërme të atij që di të bashkëndajë, sepse «më i lum është ai që jep se ai që merr» (Vap 20,35) dhe «Hyji e do atë që jep me gëzim» (2 Kor 9,7). Dashuria vëllazërore e shumëzon aftësinë tonë për të gëzuar, sepse na bën të aftë të gëzohemi për të mirën e të tjerëve: «Gëzohuni me ata që gëzojnë» (Rom 12,15). Spontaniteti dhe shtytja e rinisë sate u shndërrofshin gjithnjë e më shumë në spontanitetin e dashurisë vëllazërore, në freskinë që na bën të reagojmë gjithmonë me falje, me bujari, me dëshirën për të bërë bashkësi. Një fjalë e urtë afrikane thotë: «Nëse dëshiron të ecësh shpejt, ec vetëm. Nëse dëshiron të arrish larg, ec me të tjerët». Mos ta lejojmë që të na e vjedhin vëllazërinë.

#### TË RINJ TË ANGAZHUAR

168. Në fakt, përballë një realiteti kaq të mbushur me dhunë dhe egoizëm, të rinjtë mund të rrezikojnë të mbyllën në grupe të vogla, duke u privuar prej sfidave të jetës në shoqëri, të një bote të gjerë, nxitëse dhe me shumë nevoja. Mund ta ndiejmë se e jetojmë dashurinë vëllazërore, por ndoshta grupi i tyre është bërë thjesht një zgjatje e unit të tyre. Kjo bëhet më e rëndë nëse thirrja e laikut konceptohet vetëm si një shërbim brenda Kishës (lektorë, akolitë, katekistë, etj.), duke harruar se thirrja laikale para së gjithash është dashuria në familje dhe dashuria sociale apo politike: është një angazhim konkret duke nisur prej fesë për ndërtimin e një shoqërie të re, do të thotë të jetosh në mes të botës dhe të shoqërisë për të ungjillëzuar instancat e ndryshme të saj, për të bërë që të rritet paqja, bashkëjetesa, drejtësia, të drejtat e njeriut, mëshira dhe kështu të përhapet Mbretëria e Hyjit në botë.

169. U propozoj të rinjve që të shkojnë përtej grupeve të miqve dhe të ndërtojnë «miqësinë sociale, të kërkojnë të mirën e përbashkët. Armiqësia sociale shkatërron. Dhe një familje shkatërrohet prej armiqësisë. Një vend shkatërrohet prej armiqësisë. Bota shkatërrohet prej armiqësisë. Dhe armiqësia më e madhe është lufta. Në ditët e sotme shohim se bota është duke u shkatërruar prej luftës, sepse njerëzit janë të paafte të ulen e të flasin. [...] Jini të aftë të krijoni miqësinë sociale».<sup>[90]</sup> Nuk është e lehtë, duhet gjithmonë të heqim dorë nga diçka, duhet të negociojmë, por nëse e bëjmë këtë duke menduar për të mirën e të gjithëve mund të bëjmë përvojën e mrekullueshme të lënies mënjane të ndryshimeve, me qëllim që të luftojmë së bashku për një qëllim të përbashkët. Nëse arrijmë të gjejmë disa pika të përbashkëta në mes shumë kundërshtive, në këtë angazhim artizanal dhe nganjëherë të mundimshëm të hedhjes së urave, të ndërtimit të një paqeje të mirë për të gjithë, kjo është mrekullia e kulturës së takimit që të rinjtë mund të kenë guximin ta jetojnë me pasion.

170. Sinodi ka pranuar se «edhe pse ndryshe prej brezave të kaluar, angazhimi social është një karakteristikë specifike e të rinjve të sotëm. Përkrah disa mospërfillësve, ka shumë të tjerë të gatshëm që të angazhohen në nisma vullnetariati, qytetarie aktive e solidariteti social, që duhen shoqëruar e nxitur për të nxjerrë në pah talentet, kompetencat dhe krijimtarinë e të rinjve, si edhe për të nxitur marrjen përsipër të përgjegjësisë nga ana e tyre. Angazhimi social dhe kontakti i drejtpërdrejtë me të varfrit përbën një rast themelor për të zbuluar e për të thelluar fenë dhe për të shoshitur thirrjen personale. [...] Është theksuar edhe gatishmëria për t'u angazhuar në fushën politike për ndërtimin e të mirës së përbashkët».<sup>[91]</sup>

171. Sot, faleminderit Hyjit, grupet e të rinjve të famullive, të shkollave, të lëvizjeve apo të grupeve universitare shkojnë për t'u bërë shoqëri të moshuarve e të sëmurëve, ose vizitojnë lagje të varfra, ose shkojnë së bashku për të ndihmuar të mjerët në të ashtuquajturat “netë të dashurisë së krishterë”. Shpesh pranojnë se në këto veprimtari ajo që marrin është më shumë sesa ajo që japin, sepse njeriu mëson dhe piqet shumë kur ka guximin të hyjë në kontakt me vuajtjen e të tjerëve. Gjithashtu, të varfrit kanë një urti të fshehur, dhe ata, me fjalët e tyre të thjeshta, mund të na ndihmojnë të zbulojmë ato vlera që ende nuk i shohim.

172. Të rinj të tjerë marrin pjesë në programe sociale për ndërtimin e shtëpive për të pastrehët, bonifikojnë zona të ndotura apo mbledhin ndihma për më nevojtarët. Do të ishte mirë që kjo energji bashkësiore të përdorej jo vetëm në veprime sporadike, por në mënyrë të qëndrueshme, me objektiva të qarta dhe me një organizim të mirë për të realizuar një veprimtari më të qëndrueshme dhe më efikase. Universitarët e disiplinave të ndryshme mund të bashkohen për t'i përdorur njohuritë e tyre për zgjidhjen e problemeve sociale dhe në këtë detyrë mund të punojnë krahas për krahas me të rinjtë e Kishave apo të besimeve të tjera.

173. Sikurse te mrekullia e Jezusit, bukët dhe peshqit e të rinjve mund të shumëzohen (krh. Gjn 6,4-13). Sikurse ndodh në shëmbëlltyrë, farat e vogla të të rinjve bëhen pemë dhe fruta që duhen mbledhur (krh. Mt 13,23.31-32). E gjithë kjo duke nisur prej burimit të gjallë të Eukaristisë, ku buka dhe vera janë shndërruar për të na dhënë Jetën e pasosur. Të rinjve u është besuar një detyrë e madhe dhe e vështirë. Me fenë të Ngjalluri, do ta përballojnë me krijimtari e shpresë, duke u vënë gjithmonë në pozicion shërbimi, sikurse shërbëtorët e dasmës, bashkëpunëtorë të mahnitur të shenjës së parë të Jezusit, ndërsa ndjekin urdhrin e Nënës së tij: «Bëni gjithçka t'ju thotë» (Gjn 2,5). Mëshira, krijimtaria dhe shpresa bëjnë që jeta të rritet e të shumohet.

174. Dua të të nxis që ta marrësh përsipër këtë angazhim, sepse e di se «zemra jote, zemër e re, dëshiron të ndërtojë një botë më të mirë. Ndjek lajmet botërore dhe shoh se shumë të rinj në shumë anë të botës kanë dalë rrugëve për të shprehur dëshirën për një qytetërim më të drejtë e më vëllazëror. Të rinjtë në rrugë janë të rinj që duan të jenë protagonistë të ndryshimit. Ju lutem, mos lejoni që të tjerë të jenë protagonistë të ndryshimit! Ju e zotëroni të ardhmen! Nëpërmjet jush kjo e ardhme hyn në botë. Juve ju kërkohet që të jeni protagonistë të këtij ndryshimi. Vazhdoni ta kapërceni apatinë, duke u dhënë një përgjigje të krishterë shqetësimeve shoqërore e politike, që ndihen në vende të ndryshme të botës. Ju kërkohet që të jeni ndërtues të botës dhe që t'i hyni punës për një botë më të mirë. Të dashur të rinj, ju lutem, mos e shikoni jetën “nga ballkoni”, por hyni brenda tij. Jezusi nuk ka mbetur në ballkon, por ka hyrë brenda; mos e shikoni jetën “nga ballkoni”, hyni në të siç ka bërë Jezusi».<sup>[92]</sup> Por, sidomos, në një mënyrë apo në një tjetër, luftoni për të mirën e përbashkët, jini shërbëtorë të të varfërve, jini protagonistë të revolucionit të dashurisë e të shërbimit, të aftë që t'u bëni ballë patologjive të individualizmit konsumist e sipërfaqësor.

#### MISIONARË TË GUXIMSHËM

175. Të dashuruar me Krishtin, të rinjtë janë të thirrur ta dëshmojnë Ungjillin me jetën e tyre kudo. Shën Albert Hurtado thoshte se «të jesh apostull nuk do të thotë të mbash një shenjë dalluese në xhakëtë; nuk do të thotë të flasësh për të vërtetën, por ta jetosh atë, të mishërohesh në të, të bëhesh Krisht. Të jesh apostull nuk do të thotë të mbash një pishtar në dorë, ta kesh dritën, por të jesh drita [...]. Ungjilli, [...] më shumë se një mësim është një shembull. Mesazh i kthyer në jetë të jetuar».<sup>[93]</sup>

176. Vlera e dëshmisë nuk qëndron te zhvlerësimi i fjalës. Pse të mos flasim për Jezusin, pse të mos u tregojmë të tjerëve se Ai na jep forcën për të jetuar, se është bukur të bisedojmë me Të, se na bën mirë t'i meditojmë fjalët e tij? Të rinj, mos lejoni që bota t'ju detyrojë të bashkëndani vetëm gjërat negative apo sipërfaqësore. Jini të aftë të shkoni kundër rrymës dhe të dini ta bashkëndani Jezusin,

të përçoni fenë që Ai ju ka dhuruar. Uroj që ta ndieni në zemër po atë shtytje të parezistueshme që e nxiste Shën Palin kur pohonte: «I mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin!» (1 Kor 9,16).

177. «Ku na dërgon Jezusi? Nuk ka kufij, nuk ka kufizime: na dërgon tek të gjithë. Ungjilli është për të gjithë dhe jo për disa. Nuk është vetëm për ata që na duken më të afërt, më të ndjeshëm, më mikpritës. Është për të gjithë. Mos kini frikë të shkoni e ta çoni Krishtin në çdo mjedis, deri në periferitë ekzistenciale, edhe te ata që duken më lart, më mospërfillës. Zoti i kërkon të gjithë, dëshiron që të gjithë ta ndiejnë ngrohtësinë e mëshirës dhe të dashurisë së tij».<sup>[94]</sup> Dhe na fton që të shkojmë pa frikë me lajmin misionar, kudo që gjendemi dhe me këdo që jemi, në lagje, në studim, në sport, kur dalim me miqtë, duke bërë vullnetariat apo në punë, është gjë e mirë dhe e vlefshme ta bashkëndajmë gëzimin e Ungjillit me të tjerët. Kjo është mënyra me të cilën Zoti u afrohet të gjithëve. Dhe ju do juve, të rinj, si mjete të tij për të rrezatuar dritë e shpresë, sepse dëshiron të mbështetet në guximin tuaj, në freskinë tuaj dhe në entuziazmin tuaj.

178. Nuk mund të pritet që misioni të jetë i lehtë apo i rehatshëm. Disa të rinj e kanë dhënë jetën e tyre vetëm e vetëm që të mos e frenojë shtytjen e tyre misionare. Ipeshkvijtë e Koresë janë shprehur kështu: «Shpresojmë që të jemi kokrra gruri dhe mjete për shpëtimin e njerëzimit, duke ndjekur shembullin e martirëve. Edhe pse feja jonë është e vogël sa një kokërr sinapi, Hyji do ta rrisë dhe do ta përdorë si mjet për veprën e vet të shpëtimit».<sup>[95]</sup> Miq, mos prisni deri nesër për të bashkëpunuar në shndërrimin e botës me energjinë, guximin dhe krijimtarinë tuaj. Jeta juaj nuk është një “ndërkohë”. Ju jeni e tashmja e Hyjit dhe Ai do që ju të jepni fryt,<sup>[96]</sup> sepse «duke dhënë merret»<sup>[97]</sup> dhe mënyra më e mirë për të përgatitur një të ardhme të mirë është ta jetoni mirë, me përkushtim dhe bujari, të tashmen.

## KAPITULLI I GJASHTË

### TË RINJ ME RRËNJË

179. Shpesh kam parë pemë të reja, të bukura, që i drejtonin degët e tyre kah qielli, duke shkuar gjithnjë e më lart: ngjanin si një këngë shprese. Por, pas stuhisë, i kam parë të rrëzuara, të pajeta. I kishin shtrirë degët e tyre pa lëshuar rrënjë të thella në tokë dhe kështu kanë rënë pre e sulmeve të natyrës. Prandaj më vjen keq kur shoh se disa u propozojnë të rinjve të ndërtojnë një të ardhme pa rrënjë, a thua se bota fillon tani. Sepse «është e pamundur që dikush të rritet nëse nuk ka rrënjë të forta që e ndihmojnë të rrijë mirë në këmbë dhe i lidhur me tokën. Është e lehtë “të fluturosh tutje” kur nuk ke ku të kapesh, ku të ngulesh».<sup>[98]</sup>

### QË TË MOS TË TË SHKULIN NGA TOKA

180. Kjo çështje nuk është dytësore dhe më duket e përshtatshme që t'i kushtoj një kapitull të shkurtër. Kuptimi i saj na ndihmon që të dallojmë gëzimin e rinisë prej një kulturi të rremë të saj, që disa e përdorin për t'i joshur të rinjtë dhe për t'i përdorur ata për qëllimet e tyre.

181. Mendoni për këtë: nëse një person ju bën një propozim dhe ju thotë që ta shpërfillni historinë, që të mos e merrni parasysh përvojën e të moshuarve, që të përbuzni gjithçka që ka kaluar dhe të shikoni vetëm drejt së ardhmes që ai ju ofron, a nuk është kjo një mënyrë e lehtë për t'ju tërhequr me propozimin e tij, që ju të bëni vetëm atë që ai ju thotë? Ai person ka nevojë që të jeni të zbrazët, të çrrënjësuar, mosbesues ndaj gjithçkaje, me qëllim që t'u zini besë vetëm premtimeve të tij dhe t'u nënshtrohni planeve të tij. Kështu funksionojnë ideologjitë e ngjyrave të ndryshme, që shkatërrojnë (ose ç-ndërtojnë) gjithçka që është e ndryshme dhe në këtë mënyrë mund të sundojnë pa kundërshtime. Për ta arritur këtë qëllim ata kanë nevojë për të rinj që e përbuzin historinë, që e



refuzojnë atë pasuri shpirtërore dhe njerëzore që na kanë përçarur brezat e mëparshëm, që shpërfillin gjithçka që ka ekzistuar përpara tyre.

182. Manipuluesit përdorin edhe një tjetër burim: një adhurim të rinisë, a thua se gjithçka që nuk është e re është e urryeshme dhe e brishtë. Trupi i ri bëhet simboli i këtij kulti të ri, prandaj gjithçka që ka të bëjë me atë trup adhurohet si idhull dhe dëshirohet pa kufizime dhe ajo që nuk është e re shikohet me përçmim. Por kjo është një armë që arrin të degradojë para së gjithash të rinjtë, duke i zbrazur ata nga vlerat reale, duke i përdorur për të arritur dobi personale, ekonomike apo politike.

183. Të dashur të rinj, mos lejoni që ta përdorin rininë tuaj për të nxitur një jetë sipërfaqësore, që e ngatërron bukurinë me dukjen. Uroj ta zbuloni bukurinë që qëndron te punëtori i cili kthehet në shtëpi i ndytë dhe i çrregullt, por me gëzimin se ka fituar bukën e fëmijëve. Ka një bukuri të jashtëzakonshme te bashkësia familjare e mbledhur rreth tryezës dhe te buka e bashkëndarë me bujari, edhe pse sofrat mund të jetë shumë e varfër. Ka një bukuri te gruaja e pakrehur dhe pak e moshuar, që vazhdon të kujdeset për burrin e sëmurë, përtej forcave dhe shëndetit të vet. Pavarësisht se pranvera e joshjes është larg, ka një bukuri te besnikëria e çifteve që e duan njëri-tjetrin edhe në pleqëri dhe te ata të moshuar që ecin duke u mbajtur për dore. Ka një bukuri që shkon përtej dukjes së jashtme apo estetikës së modës në çdo burrë e në çdo grua që e jetojnë me dashuri thirrjen e tyre personale, në shërbimin e painteres për bashkësinë, për atdheun, në punën zemërgjerë për lumturinë e familjes, të angazhuar në punën e guximshme anonime e falas të rikthimit të miqësisë sociale. Ta zbulojmë, ta dëftojmë dhe ta vëmë në dukje këtë bukuri, që na kujton atë të Krishtit në kryq, do të thotë të hedhim themelet e solidaritetit të vërtetë shoqëror dhe të kulturës së takimit.

184. Së bashku me strategjitë e kultit të rremë të rinisë dhe të dukjes, sot nxitet një përshpirtëri pa Hyjin, një afektivitet pa bashkësi dhe pa angazhim ndaj atyre që vuajnë, një frikë nga të varfrit që shihen si subjekte të rrezikshme dhe një seri ofertash që pretendojnë t'ju shtyjnë të besoni në një të ardhme parajse, që do të zgjasë pafundësisht. Nuk dua t'ju propozoj këtë dhe me gjithë dashurinë time dua t'ju paralajmëroj që të mos lejoni t'u zotërojë kjo ideologji që nuk do t'ju bëjë më të rinj, por do t'ju shndërrojë në skllevër. Ju propozoj një tjetër rrugë, të përbërë prej lirisë, prej entuziazmit, prej krijimtarisë, prej horizonteve të reja, por duke kultivuar në të njëjtën kohë rrënjët, që ju ushqejnë dhe ju mbajnë.

185. Në këtë perspektivë, dua të theksoj se «shumë Etër sinodalë të ardhur nga kontekste jo perëndimore tregojnë se si në vendet e tyre globalizimi sjell me vete forma të njëmendta kolonializimi kulturor, që i çrrënjësin të rinjtë prej përkatësive kulturore e fetare nga të cilat vijnë. Është i nevojshëm një angazhim i Kishës për t'i shoqëruar ata në këtë kalim, pa lejuar që të humbasin veçoritë më të çmueshme të identitetit të tyre».<sup>[99]</sup>

186. Sot ekziston prirja “për t'i homogjenizuar” të rinjtë, për t'i zhdukur ndryshimet e tyre natyrore e shoqërore, për t'i shndërruar në subjekte të manipulueshme të bëra në seri. Duke vepruar kështu arrihet në një shkatërrim kulturor, që është po aq i rëndë sa edhe zhdukja e specieve të kafshëve e të bimëve.<sup>[100]</sup> Prandaj, në një mesazh drejtuar të rinjve vendas të mbledhur në Panama, i kam nxitur duke u thënë: «Pranojini rrënjët tuaja, sepse prej këtyre rrënjëve merrni forcën për t'u rritur, për të lulëzuar dhe për të dhënë fryte».<sup>[101]</sup>

#### MARRËDHËNIA JOTE ME TË MOSHUARIT

187. Në Sinod është pohuar se «të rinjtë janë të projektuar drejt të ardhmes dhe se e përballojnë jetën me energji e entuziazëm. Por [...] nganjëherë prirjen t'i kushtojnë pak vëmendje kujtesës së të kaluarës nga vijnë, veçanërisht dhuratave të shumta që kanë marrë nga prindërit, nga gjyshërit apo nga trashëgimia kulturore e shoqërisë në të cilën jetojnë. T'i ndihmojmë të rinjtë që ta zbulojnë pasurinë e gjallë të së kaluarës, duke e përkujtuar atë dhe duke e përdorur për zgjedhjet e mundësitë

vetjake, është një akt i vërtetë dashurie ndaj tyre për rritjen dhe zgjedhjet që ata janë të thirrur të bëjnë».[102]

188. Fjala e Hyjit porositi që të rinjtë të mos e humbasin kontaktin e tyre me të moshuarit, me qëllim që të marrin përvojën e tyre: «Qëndro në mbledhje të pleqve, bashkohu me gjithë zemër me urtinë e tyre. [...] Nëse e sheh ndonjë të urtë, shko që në agim tek ai dhe shkallët e derës së tij le t'i lëmojë këmba jote» (Sir 6,34.36). Sidoqoftë, vitet e gjata që ata kanë jetuar dhe gjithçka që atyre u ka ndodhur në jetë duhet të na bëjnë t'i shikojmë me respekt: «Ngrehu në këmbë para flokthinjurit» (Lev 19,32), sepse «stolia e të rinjve është fuqia e tyre, kurse flokët e thinjur janë stolia e pleqve» (Fu 20,29).

189. Bibla na kërkon: «Dëgjo t'atë – prindin tënd, e mos e përbuz tët ëmë kur të plakët» (Fu 23,22). Urdhri për të nderuar babain dhe nënën «është urdhri i parë me premtim» (Ef 6,2; krh. Dal 20,12; Lp 5,16; Lev 19,3), dhe premtimi është: «që të jesh mirë e të jetosh gjatë mbi dhë» (Ef 6,3).

190. Kjo nuk do të thotë se ti duhet të jesh dakort me gjithçka që ata thonë, as se ti duhet t'i miratosh të gjitha veprimet e tyre. Një i ri duhet të ketë gjithmonë një shpirt kritik. Shën Bazili i Madh, duke iu referuar autorëve të lashtë grekë, i porosiste të rinjtë që t'i vlerësonin dhe të merrnin prej tyre vetëm gjërat e mira.<sup>[103]</sup> Bëhet fjalë thjesht që të jesh i hapur për të pranuar një urti që kalon nga brezi në brez, që mund të bashkëjetojë me disa mjerime njerëzore dhe që nuk ka arsye të zhduket para risive të konsumit dhe të tregut.

191. Botës nuk i ka shërbyer dhe nuk do t'i shërbejë kurrë ndarja mes brezave. Janë këngët e sirenës së një të ardhmeje pa rrënjë. Është gënjeshtër që dëshiron të të bëjë të besosh se vetëm ajo që është e re është e mirë dhe e bukur. Ekzistenca e marrëdhënieve ndërbreznore është shenja se në bashkësi ka një kujtesë kolektive, pasi çdo brez merr mësimet e paraardhësve të vet, duke u lënë kështu edhe ai vetë një trashëgimi pasardhësve të tij. Kjo përbën një pikë referimi për të forcuar një shoqëri të re, sikurse thotë fjala e urtë: “Sikur i riu të dinte dhe plaku të mundte, nuk do të kishte gjë që nuk do të bëhej”.

#### ËNDRRA E VEGIME

192. Në profecinë e Joelit gjejmë një shpallje që na ndihmon ta kuptojmë këtë gjë në një mënyrë shumë të bukur. Thotë kështu: «E pas këtyre: Do ta ndikoj Shpirtin tim mbi çdo njeri e do të bëhen profetë bijtë e bijat tuaja, pleqtë tuaj ëndrra do të shohin, djelmoshat tuaj do të kenë vegime» (Jl 3,1; krh. Vap 2,17). Nëse të rinjtë dhe pleqtë i hapen Shpirtit Shenjt, së bashku krijojnë një kombinim të mrekullueshëm. Pleqtë ëndërrojnë dhe të rinjtë kanë vegime. Po në çfarë mënyre këto dy gjëra plotësojnë njëra-tjetrën?

193. Pleqtë kanë ëndrra të endura me kujtime, me imazhet e shumë gjërave të jetuara, të shënuara prej përvojës dhe prej viteve. Nëse të rinjtë rrënjosen në ëndrrat e pleqve, ata arrijnë ta shohin të ardhmen, mund të kenë vegime që u hapin horizontin dhe u tregojnë rrugë të reja. Por nëse pleqtë nuk ëndërrojnë, të rinjtë nuk mund ta shohin me qartësi horizontin e jetës.

194. Është bukur të gjejmë, mes gjërave që prindërit tanë kanë ruajtur, ndonjë kujtim që na bën të kuptojmë atë që gjyshërit tanë kanë ëndërruar për ne. Çdo qenie njerëzore, ende para se të lindë, ka marrë prej gjyshërve të vet, si dhuratë, bekimin e një ëndrre plot dashuri dhe shpresë: atë për një jetë më të mirë. Edhe po të mos e ketë bërë asnjëri prej gjyshërve të vet, me siguri një stërgjysh e ka ëndërruar dhe është gëzuar për të, duke soditur në djep fëmijët e vet dhe pastaj edhe nipërit e vet. Ëndrra e parë, ëndrra krijuese e Hyjit Atit tonë, i paraprin dhe e shoqëron jetën e bijve të vet. Ta përkujtojmë këtë bekim, që shtrihet nga breznia në brezni, është një trashëgimi e çmueshme që duhet të dimë ta mbajmë gjallë, me qëllim që t'ua përçojmë atyre që do të vijnë pas nesh.

195. Prandaj le t'i lejojmë të moshuarit që të bëjnë tregime të gjata, të cilat nganjëherë duken mitologjike – ëndrra pleqsh – por shumë herë janë plot me përvojë të çmueshme, me simbole shprehëse, me porosi të fshehura. Këto tregime kërkojnë kohë dhe neve na kërkohet që të jemi të gatshëm t'i dëgjojmë dhe t'i interpretojmë me durim, pasi janë shumë të ndryshme prej mesazheve të rrjeteve sociale. Duhet ta pranojmë se urtia për të cilën kemi nevojë nuk mund të përfshihet brenda kufijve të imponuar prej burimeve aktuale të komunikimit.

196. Në librin “Urtia e kohës”<sup>[104]</sup> kam shprehur disa dëshira në formë kërkesash. «Çfarë u kërkoj të moshuarve, mes të cilëve rendis edhe veten time? U kërkoj që të jemi rojtarë të kujtesës. Ne gjyshërit e gjyshet kemi nevojë të formojmë një kor. I përfytyroj të moshuarit si korin e përhershëm të një shenjtëroreje të rëndësishme shpirtërore, ku lutjet e kërkesës dhe këngët e lavdit mbështesin gjithë bashkësinë, që punon e lufton në fushën e jetës».<sup>[105]</sup> Është bukur që «djelmosha e vajza, pleq e foshja: le ta lavdërojnë Emrin e Zotit» (Ps 148,12-13).

197. Çfarë mund t'u japim të rinjve ne të moshuarit? «Të rinjve të sotëm që përjetojnë përzierjen e ambicjeve heroike dhe të pasigurive, mund t'u kujtojmë se një jetë pa dashuri është një jetë shterpë».<sup>[106]</sup> Çfarë mund t'u themi atyre? «Të rinjve që kanë frikë mund t'u themi se ankthi për të ardhmen mund të kapërcehet».<sup>[107]</sup> Çfarë mund t'u mësojmë atyre? «Të rinjve tepër të shqetësuar për vetveten mund t'u mësojmë se përjetohet një gëzim më i madh duke dhënë, sesa duke marrë dhe se dashuria nuk dëftohet vetëm me fjalë, por edhe me vepra».<sup>[108]</sup>

#### TË RREZIKOJMË SË BASHKU

198. Dashuria që jepet dhe që vepron, shumë herë gabon. Ai që vepron, që rrezikon, shpeshherë bën edhe gabime. Në lidhje me këtë, mund të jetë interesante dëshmia e Maria Gabriela Perinit, jetime nga babai që prej lindjes, e cila reflekton në lidhje me mënyrën se si kjo ka ndikuar në jetën e saj, në një marrëdhënie që nuk ka zgjatur, por që e ka bërë atë nënë dhe tani gjyshe: «Ajo që di është se Hyji krijon histori. Në gjenialitetin e tij dhe mëshirën e tij, Ai i merr ngadhënjimet e dështimet tona dhe end sixhade plot humor. Pjesa e prapme e saj mund të duket e çrregullt prej fijeve të ngatërruara – ngjarjet e historisë sonë – dhe ndoshta është ajo anë që nuk na lë rehat kur kemi dyshime. Megjithatë, ana e mirë e sixhades tregon një histori të mrekullueshme dhe kjo është ana që sheh Hyji».<sup>[109]</sup> Kur personat e moshuar e shikojnë me kujdes jetën e tyre, shpesh kuptojnë instinktivisht se çfarë gjendet pas fijeve të ngatërruara dhe shohin atë që Hyji bën në mënyrë krijuese, edhe me gabimet tona.

199. Nëse ecim së bashku, të rinj dhe të moshuar, mund të jemi të rrënjësor mirë në të tashmen dhe, nga ky pozicion, të vizitojmë të kaluarën dhe të ardhmen: të vizitojmë të kaluarën për të mësuar nga historia dhe për të shëruar plagët që nganjëherë na kushtëzojnë; të vizitojmë të ardhmen për të ushqyer entuziazmin, për të realizuar ëndrrat, për të nxitur profeci, për të lulëzuar shpresat. Në këtë mënyrë, të bashkuar, do të mësojmë t'ia ngrohim zemrat njëri-tjetrit, t'i frymëzojmë mendjet tona me dritën e Ungjillit dhe t'u japim forcë të re duarve tona.

200. Rrënjët nuk janë spiranca që na lidhin me epoka të tjera dhe na pengojnë të mishërohemi në botën aktuale për të bërë që të lindë diçka e re. Përkundrazi, janë një pikërrënjësjeje, që na mundëson të rritemi dhe t'u përgjigjemi sfidave të reja. Pra, nuk është nevoja as «që të ulemi për të kujtuar me mall kohët e shkuara; duhet ta kemi për zemër kulturën tonë me realizëm e dashuri dhe ta mbushim atë me Ungjillin e Krishtit. Sot jemi të dërguar që t'ua shpallim Lajmin e Gëzueshëm të Jezusit kohëve të reja. Duhet ta duam kohën tonë me mundësitë dhe rreziqet e saj, me gëzimet dhe dhimbjet e saj, me pasuritë dhe kufizimet e saj, me sukseset dhe gabimet e saj».<sup>[110]</sup>

201. Në Sinod njëri prej dëgjuesve, një i ri nga Ishujt Samoa, tha se Kisha është një kanoa, në të cilën të moshuarit ndihmojnë për të mbajtur drejtimin, duke interpretuar pozicionin e yjeve, dhe të

rinjtë u japin remave me forcë, duke përfytyruar atë që i pret më tej. Të mos lejojmë që të na nxjerrin nga rruga as të rinjtë që mendojnë se të rriturit janë një e kaluar që nuk ka më peshë, që tashmë ka kaluar dhe as të rriturit që besojnë se dinë gjithmonë se si duhet të sillen të rinjtë. Por, le të hipim të gjithë në të njëjtën kanoa dhe së bashku të kërkojmë një botë më të mirë, nën nxitjen gjithmonë të re të Shpirtit Shenjt.

## KAPITULLI I SHTATË

### BARITORJA E TË RINJVE

202. Baritorja rinore, siç jemi mësuar ta zhvillojmë, ka pësuar sulmin e ndryshimeve shoqërore e kulturore. Të rinjtë, në strukturat e zakonshme, shpesh nuk gjejnë përgjigje për shqetësimet dhe kërkesat e tyre, për problematikat dhe plagët e tyre. Lulëzimi dhe rritja e shoqatave me karakteristika rinore mund të interpretohen si një veprim i Shpirtit Shenjt që hap rrugë të reja. Megjithatë, është e nevojshme që ta thellojmë pjesëmarrjen e tyre në baritoren e tërësishme të Kishës, ashtu si edhe një bashkim më të madh mes tyre brenda, një koordinimi më të mirë të veprimeve. Edhe pse nuk është gjithmonë e lehtë që t'u afrohem të rinjve, jemi duke u rritur në dy aspekte: vetëdija se është krejt bashkësia ajo që i ungjillëzon ata dhe urgjenca që të rinjtë të jenë më shumë protagonistë në propozimet baritore.

#### NJË BARITORE SINODALE

203. Dua të theksoj se të rinjtë janë aktorë të baritores rinore, të shoqëruar e të udhëhequr, por të lirë të gjejnë rrugë gjithnjë të reja me krijimtari dhe guxim. Si rrjedhojë, do të ishte e kotë që të ndalesha këtu për të propozuar ndonjë lloj manuali të baritores rinore apo një udhërrëfyes praktik të kësaj baritoreje. Më shumë që të përdorim inteligjencën, zgjuarsinë dhe njohurinë që vetë të rinjtë kanë për ndjeshmërinë, gjuhën dhe problematikat e të rinjve të tjerë.

204. Ata na tregojnë nevojën për të përdorur stile dhe strategji të reja. P. sh., ndërsa të rriturit përpiqen që ta kenë gjithçka të programuar, me mbledhje periodike dhe orare të përcaktuara, sot pjesa më e madhe e të rinjve ndihet jo fort e tërhequr nga këto skema baritore. Baritorja rinore ka nevojë që të fitojë një tjetër elasticitet dhe që t'i ftojë të rinjtë në ngjarje që herë pas here u ofrojnë atyre një vend ku jo vetëm marrin një formim, por që u mundëson atyre edhe që të bashkëndajnë jetën, të festojnë, të këndojnë, të dëgjojnë dëshmi konkrete dhe të përjetojnë takimin e bashkësisë me Hyjin e gjallë.

205. Nga ana tjetër, do të ishte shumë e dëshirueshme që të pranohen edhe më shumë praktikatat e mira: ato metodologji, gjuhë dhe motivime që janë rezultate efektivisht tërheqëse për t'i afruar të rinjtë me Krishtin dhe Kishën. Nuk ka rëndësi se çfarë ngjyre kanë, nëse janë “konservatorë apo progresistë”, nëse janë “të së djathtës apo të së majtës”. E rëndësishme është që të pranohet gjithçka që ka dhënë rezultate të mira dhe që është efikase për të komunikuar gëzimin e Ungjillit.

206. Baritorja rinore nuk mund të jetë tjetër veçse sinodale, domethënë e aftë që t'i japë formë një “ecjeje së bashku”, që kërkon një «vlerësim të karizmave që Shpirti dhuron sipas thirrjes dhe rolit të secilit prej anëtarëve [të Kishës], nëpërmjet një dinamizmi bashkëpërgjegjësie. [...] Të frymëzuar nga ky shpirt, mund të ecim drejt një Kise pjesëmarrëse dhe bashkëpërgjegjëse, të aftë të vlerësojë pasurinë e larmisë nga e cila përbëhet, duke pranuar me mirënjohje edhe ndihmesën e besimtarëve laikë, mes të cilëve të rinj e femra, atë të jetës së kushtuar femërore e mashkullore dhe atë të grupeve, shoqatave e lëvizjeve. Askush nuk duhet të lihet ose nuk mund të lihet mënjanë».<sup>[111]</sup>

207. Në këtë mënyrë, duke mësuar nga njëri-tjetri, mund ta pasqyrojmë më mirë atë poliedër të mrekullueshëm që duhet të jetë Kisha e Jezu Krishtit. Ajo mund t'i tërheqë të rinjtë pikërisht sepse

nuk është një njësi monolitike, por një rrjet dhuratash të ndryshme, që Shpirti derdh pareshtur në të, duke e bërë gjithmonë të re, pavarësisht mjerimeve të saj.

208. Në Sinod janë bërë shumë propozime konkrete për të përtërirë baritoren rinore dhe për ta liruar atë nga skema që nuk janë më efikase, sepse nuk hyjnë në dialog me kulturën aktuale të të rinjve. Është e qartë se nuk mund t'i paraqisja të gjitha këtu; disa prej tyre mund të gjenden në Dokumentin Përfundimtar të Sinodit.

#### LINJA TË MËDHA VEPRIMI

209. Do të doja vetëm të theksoja shkurtimisht se baritorja rinore përfshin dy linja të mëdha veprimi. Njëra është kërkimi, ftesa, thirrja që tërheq të rinj të tjerë drejt përjetimit të Zotit. Tjetra është rritja, zhvillimi i një rrugëtimi të pjekurisë së atyre që tashmë e kanë bërë atë përjetim.

210. Për sa i përket pikës së parë, d.m.th. kërkimit, unë kam besim te aftësitë e të rinjve, që dinë të gjejnë rrugë tërheqëse për të ftuar. Dinë të organizojnë festivale e gara sportive, dhe dinë të ungjillëzojnë në rrjetet sociale me mesazhe, këngë, video dhe ndërhyrje të tjera. Duhet vetëm t'i nxisim të rinjtë dhe t'u japim atyre lirinë e veprimt, që të entuziazmohen me misionin në mjediset rinore. Shpallja e parë mund të zgjojë një përvojë të thellë feje gjatë një bisede në bar, gjatë një momenti pushimi në fakultet, ose përmes rrugëve të pashqyrtueshme të Hyjit. Por gjëja më e rëndësishme është që çdo i ri të gjejë guximin që të mbjellë shpalljen e parë në atë tokë pjellore që është zemra e një të riu tjetër.

211. Në këtë kërkim duhet privilegjuar gjuha e afërsisë, gjuha e dashurisë së painteres, marrëdhënore dhe ekzistenciale që prek zemrën, arrin jetën, zgjon shpresën e dëshirat. Duhet t'u afrohem të rinjve me gramatikën e dashurisë, jo me prozelitizëm. Gjuha që të rinjtë kuptojnë është ajo e atyre që japin jetën, që janë aty për shkak të tyre dhe për ta, dhe e atyre që, pavarësisht kufizimeve dhe dobësive, përpiqen ta jetojnë fenë në mënyrë koherente. Në të njëjtën kohë, duhet të kërkojmë me ndjeshmëri më të madhe se si ta mishërojmë kërygma-n në gjuhën e të rinjve të sotëm.

212. Për sa i përket rritjes, do të doja të bëja një paralajmërim të rëndësishëm. Në disa vende ndodh që, pasi të rinjtë kanë bërë një përjetim të fortë të Hyjit, një takim me Jezusin që ka prekur zemrën e tyre, atyre u propozohen takime “formimi”, ku trajtohen vetëm çështje doktrinale e morale: në lidhje me të këqijat e botës së sotme, me Kishën, me doktrinën shoqërore, me pastërtinë, me martesën, me kontrollin e lindjeve dhe me tema të tjera. Rezultati është se shumë të rinj mërzhiten dhe e humbin zjarrin e takimit me Krishtin dhe gëzimin për ta ndjekur atë, shumë vetë e braktisin ecjen dhe të tjerë bëhen të trishtuar e negativë. Le ta qetësojmë ankthin tonë për të përçarur një sasi të madhe përmbajtjesh doktrinale, sidomos kur kërkojmë të nxisim e të rrënjosisim përvoja të mëdha që mbështesin jetën e krishterë. Siç thoshte Romano Guardini: «Në përvojën e një dashurie të madhe [...] gjithçka që ndodh bëhet një ngjarje në fushën e vet».<sup>[112]</sup>

213. Çfarëdo projekti formues, çfarëdo rrugëtimi rritës për të rinjtë, me siguri duhet të përfshijë një formim doktrinor e moral. Është po ashtu e rëndësishme që ky formim të jetë i përqendruar në dy aspekte kryesore: njëri është thellimi i kërygma-s, përjetimit themelor të takimit me Hyjin nëpërmjet Krishtit të vdekur e të ngjallur. Tjetri është rritja në dashurinë vëllazërore, në jetën e bashkësisë, në shërbim.

214. Kam këmbëngulur shumë në këtë te *Evangelii gaudium* dhe mendoj se është mirë ta kujtoj atë. Nga njëra anë, do të ishte një gabim i madh të mendojmë se në baritoren rinore «kërygma braktiset në dobi të një formimi që mendohet se është “më i qëndrueshëm”. Nuk ka gjë më të qëndrueshme, më të thellë, më të sigurt, më të vlefshme dhe më të urtë se kjo shpallje. Krejt formimi i krishterë është para së gjithash thellimi i kërygma-s, që mishërohet gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më

mirë».<sup>[113]</sup> Prandaj, baritorja rinore duhet të përfshijë gjithmonë momente që ndihmojnë në përtëritjen dhe në thellimin e përvojës personale të dashurisë së Hyjit e të Jezu Krishtit të gjallë. Mund ta bëjë këtë duke përdorur burime të ndryshme: dëshmi, këngë, momente adhurimi, hapësira reflektimi shpirtëror me Shkrimin e shenjtë, si edhe me nxitje të ndryshme nëpërmjet rrjeteve sociale. Por kjo përvojë e gëzueshme takimi me Zotin nuk duhet të zëvendësohet kurrë nga njëfarë “indoktrinimi”.

215. Nga ana tjetër, çfarëdo plani baritor rinor duhet të përfshijë qartësisht mjete e burime të ndryshme për t’i ndihmuar të rinjtë që të rriten në vëllazëri, që ta ndihmojnë njëri-tjetrin, që të krijojnë bashkësi, që t’u shërbejnë të tjerëve, që të jenë afër të varfërve. Nëse dashuria vëllazërore është «urdhri i ri» (Gjn 13,34), nëse është «plotësia e Ligjit» (Rom 13,10), nëse është ajo gjë që e shfaq më mirë dashurinë tonë për Hyjin, atëherë duhet të zërë një vend të rëndësishëm në çdo plan formimi dhe rritjeje të të rinjve.

#### MJEDISE TË PËRSHTATSHME

216. Në të gjitha institucionet tona duhet ta zhvillojmë e ta fuqizojmë shumë më tepër aftësinë tonë për një mikpritje të përzemërt, sepse shumë të rinj që vijnë gjenden në një situatë të thellë bonjakërie. Dhe nuk e kam fjalën për konflikte të caktuara familjare, por për një përvojë që ka lidhje në të njëjtën mënyrë me fëmijët, të rinjtë e të rriturit, me nënat, baballarët e bijtë. Për shumë jetimë e jetime bashkëkohëse me ne – ndoshta për ne vetë – bashkësitë si famullia dhe shkolla duhet të ofrojnë rrugëtime dashurie falas dhe nxitjeje, afirmimi dhe rritjeje. Shumë të rinj sot ndihen bij të dështimit, sepse ëndrrat e prindërve dhe të gjyshërve të tyre janë djegur në turrën e druve të padrejtësisë, të dhunës sociale, të “të shpëtojë kush të mundet”. Sa çrrënjosje! Nëse të rinjtë janë rritur në një botë hiri, s’është e lehtë për ta që ta mbajnë ndezur zjarrin e dëshirave e të projekteve të mëdha. Nëse janë rritur në një shkretëtirë pa kuptim, si mund të duan të sakrifikohen për të mbjellë? Përvoja e mungesës së vazhdimësisë, e çrrënjosjes dhe rrëzimi i sigurive bazë, të favorizuara nga kultura e sotme mediatike, shkaktojnë atë ndjesi të bonjakërisë së thellë, të cilës duhet t’i përgjigjemi duke krijuar hapësira vëllazërore e tërheqëse ku të jetohet me kuptim.

217. Të hapësh “shtëpi” si përfundim «do të thotë të krijosh familje; do të thotë të mësosh të ndihesh i bashkuar me të tjerët përtej lidhjeve të dobisë apo atyre funksionale, të bashkuar në mënyrë që jeta të ndihet si pak më shumë njerëzore. Të hapësh shtëpi do të thotë të lejosh që profecia të realizohet dhe t’i bëjë orët e ditët tona më pak jomikpritëse, më pak mospërfillëse e anonime. Do të thotë të krijosh lidhje që ndërtohen me gjeste të thjeshta, të përditshme dhe që të gjithë mund t’i bëjnë. Një shtëpi, të gjithë e dimë shumë mirë, ka nevojë për bashkëpunimin e të gjithëve. Askush nuk mund të jetë mospërfillës apo i huaj, sepse secili është një gur i nevojshëm për ndërtimin e saj. Kjo do të thotë se duhet t’i kërkojmë Zotit që të na japë hirin për të pasur durim, për të mësuar ta falim njëri-tjetrin; për të mësuar çdo ditë që të rifillojmë sërish. Po sa herë të falim dhe t’ia rifillojmë? Shtatëdhjetë herë shtatë, sa herë që të jetë e nevojshme. Krijimi i marrëdhënieve të forta kërkon besim, që ushqehet çdo ditë me durim e me falje. Kështu realizohet mrekullia e përjetimit se këtu njeriu lind përsëri; këtu të gjithë lindim përsëri, sepse e ndiejmë efektshmërinë e përkëdheljes së Hyjit, që na bën të ëndërrojmë një botë më njerëzore dhe, prandaj, më hyjnore».<sup>[114]</sup>

218. Në këtë kuadër, në institucionet tona duhet t’u ofrojmë të rinjve vende të përshtatshme, që ata t’i administrojnë sipas dëshirës së tyre dhe ku të hyjnë e të dalin lirisht, vende që t’i mikpresin dhe ku mund të shkojnë në mënyrë spontane e me besim për të takuar të rinj të tjerë qoftë në momentet e vuajtjes apo të mërzisë, qoftë kur dëshirojnë të festojnë për gëzimet e tyre. Diçka të tillë kanë realizuar disa oratore dhe qendra të tjera rinore, që në shumë raste janë mjedise ku të rinjtë jetojnë përvoja të miqësisë dhe të dashurimit, ku takohen, bashkëndajnë muzikën, veprimtaritë argëtuese, sportin, si edhe reflektimin e lutjen, me ndihmës të vegjël dhe propozime të ndryshme. Në këtë mënyrë kjo shpallje e domosdoshme kalon nga njëri te tjetri dhe nuk mund të zëvendësohet nga asnjë burim apo strategji tjetër baritore.

219. «Miqësia dhe ballafaqimi, shpesh edhe në grupe pak a shumë të strukturuar, japin mundësinë e forcimit të kompetencave shoqërore dhe të marrëdhënieve në një kontekst ku personat nuk vlerësohen dhe vetëm gjykohen. Përvoja e grupit përbën edhe një burim të madh për bashkëndarjen e fesë dhe për ndihmën e ndërsjellë në dëshmi. Të rinjtë janë të aftë të udhëheqin të rinj të tjerë dhe të jetojnë një apostullim të vërtetë në mes të miqve të tyre».<sup>[115]</sup>

220. Kjo nuk do të thotë që të izoloohen dhe të humbasin çdo kontakt me bashkësitë famullitare, lëvizjet dhe institucionet e tjera kishtarë. Por ata do të përfshihen më mirë në bashkësi të hapura, të gjalla në fe, të mbushura me dëshirën për ta rrezatuar Jezu Krishtin, të gëzueshme, të lira, vëllazërore e të angazhuara. Këto bashkësi mund të jenë kanalet ku ata ndiejnë se është e mundur të kultivohen marrëdhënie të çmueshme.

#### BARITORJA E INSTITUCIONEVE EDUKATIVE

221. Shkolla është pa dyshim një platformë për t'iu afruar fëmijëve dhe të rinjve. Ajo është vend i privilegjuar i nxitjes së personit dhe prandaj bashkësia e krishterë i ka kushtuar gjithmonë një vëmendje të madhe atyre, qoftë duke formuar mësimdhënës e drejtues, qoftë duke themeluar shkolla të vetat, të çdo lloji dhe niveli. Në këtë fushë Shpirti Shenjt ka nxitur karizma e dëshmi të panumërta shenjtërie. Megjithatë, shkolla ka nevojë për një autokritikë urgjente, nëse merren parasysh rezultatet e baritores së shumë institucioneve edukative, një baritore e përqendruar te mësimi fetar që shpesh është e paaftë të nxisë përvoja feje që zgjasin në kohë. Gjithashtu, ka disa shkolla katolike që duket se janë organizuar vetëm për të ruajtur atë që ekziston. Fobia e ndryshimit i bën të pafta që të durojnë pasigurinë dhe i nxit të mbyllën përballë rreziqeve, reale apo imagjinare, që çdo ndryshim sjell me vete. Shkolla e shndërruar në një “bunker”, që mbron nga gabimet “e jashtme” është shprehje karikaturiale e kësaj prirjeje. Ky imazh reflekton në mënyrë provokuese atë që përjetojnë shumë të rinj në momentin e daljes së tyre nga disa institute edukative: një mospërputhje e pakapërcyeshme mes asaj që kanë mësuar dhe botës ku jetojnë. Edhe propozimet fetare e morale që kanë marrë nuk i kanë përgatitur që t'i bëjnë ballë një bote që i përqesh dhe nuk kanë mësuar mënyra për t'u lutur dhe për ta jetuar fenë, që mund të përdoren me lehtësi edhe jashtë. Në fakt, njëri prej gëzimeve më të mëdha të një edukatori është ta shohë një nxënës tek formohet si një person i fortë, i ndershëm, protagonist dhe i aftë për të dhënë.

222. Shkolla katolike vazhdon të jetë thelbësore si hapësirë e ungjillëzimit të të rinjve. Është e rëndësishme që të kemi parasysh disa kritere frymëzuese të treguara në Kushtetutën apostolike *Veritatis gaudium* për një përtëritje dhe rinisje të shkollave e të universiteteve “në dalje” misionare; sikurse: përvoja e kërygma-s, dialogu në të gjitha nivelet, bashkëpunimi ndërdisiplinor dhe transdisiplinor, nxitja e kulturës së takimit, nevoja urgjente “për të krijuar rrjet” dhe zgjedhja për të fundit e shoqërisë, për ata që shoqëria i skarton dhe i hedh tutje.<sup>[116]</sup> Si edhe aftësia për të integruar dijet e kokës, të zemrës dhe të duarve.

223. Nga ana tjetër, nuk mund ta ndajmë formimin shpirtëror prej formimit kulturor. Për të rinjtë Kisha gjithmonë ka dashur që të krijojë hapësira për kulturën më të mirë të mundshme. Nuk duhet të heqë dorë prej kësaj, sepse të rinjtë e kanë këtë të drejtë. «Sot, në mënyrë të veçantë, e drejta për kulturë do të thotë të tutelohet dija, pra një dije njerëzore e njerëzorizuese. Tepër shpesh jemi të kushtëzuar nga modele të rëndomta dhe kalimtare jete, që nxisin ndjekjen e suksesit me kosto të ulët, duke diskredituar flijimin, duke krijuar idenë se studimi nuk duhet gjë nëse nuk jep menjëherë rezultate konkrete. Jo, studimi shërben për t'i bërë pyetje vetvetes, për të mos lejuar që të anestezohemi nga banaliteti, për të kërkuar një kuptim në jetë. Duhet kërkuar e drejta, që të mos mbizotërojnë sirenat e shumta që sot na largojnë prej këtij kërkimi. Odisea, për të mos rënë pre e këngës së sirenave, që i joshnin marinarët dhe i bënë ata të copëtoheshin nëpër shkëmbinj, u lidh në traun e anijes dhe ua mbylli veshët me dyllë shokëve të udhëtimit. Ndërsa Orfeu, për t'i bërë

ballë këngës së sirenave, bëri diçka tjetër: i ra një melodie më të bukur, që i mahniti sirenat. Ja, kjo është detyra juaj e madhe: t'u përgjigjeni refreneve paralizuese të konsumizmit kulturor me zgjedhje dinamike e të forta, me kërkimin, njohurinë dhe bashkëndarjen».<sup>[117]</sup>

#### FUSHA TË NDRYSHME TË ZHVILLIMIT BARITOR

224. Shumë të rinj janë të aftë që të mësojnë ta shijojnë heshtjen dhe intimitetin me Hyjin. Janë shtuar grupet që mbliidhen për të adhuruar të Shenjtërueshmin Sakrament dhe për t'u lutur me Fjalën e Hyjit. Nuk duhet t'i nënvleftësojmë të rinjtë, a thua se ata janë të paaftë t'u hapen propozimeve soditëse. Duhet vetëm të gjejmë stilet dhe modalitetet e përshtatshme për t'i ndihmuar ata që ta bëjnë këtë përvojë me vlerë kaq të madhe. Për sa u përket fushave të kultit dhe të lutjes, «në kontekste të ndryshme të rinjtë katolikë kërkojnë propozime lutjeje dhe momente sakramentale të afta që ta përfshijnë jetën e tyre të përditshme në një liturgji të freskët, të njëmendtë dhe të gëzueshme».<sup>[118]</sup> Është e rëndësishme që t'i vlerësojmë momentet më të forta të vitit liturgjik, në veçanti Javën e Madhe, Rrëshajët dhe Krishtlindjen. Atyre u pëlqejnë shumë edhe takime të tjera feste, që e ndërpresin rutinën dhe ndihmojnë në përjetimin e gëzimit të fesë.

225. Një mundësi e privilegjuar për rritjen dhe hapjen ndaj dhuratës hyjnore të fesë e të dashurisë është shërbimi: shumë të rinj ndihen të tërhequr nga mundësia për t'i ndihmuar të tjerët, veçanërisht fëmijët e të varfrit. Shpesh ky shërbim përbën hapin e parë për ta zbuluar apo për ta rizbuluar jetën e krishterë dhe atë kishtarë. Shumë të rinj lodhen me programet tona të formimit doktrinor dhe shpirtëror, e nganjëherë kërkojnë mundësinë që të jenë më shumë protagonistë në veprimtari që i ndihmojnë direkt njerëzit.

226. Nuk mund t'i harrojmë shprehjet artistike, si p.sh.: teatri, piktura dhe të tjera si këto. «Krejt e veçantë është rëndësia e muzikës, që përfaqëson një fushë të vërtetë ku të rinjtë janë të zhytur vazhdimisht, ashtu si edhe një kulturë dhe një gjuhë e aftë për të ngjallur emocione e për të formuar identitetin e tyre. Gjuha muzikore përfaqëson një burim baritor, që i drejtohet veçanërisht liturgjisë e përtëritjes së saj».<sup>[119]</sup> Kënga mund të jetë një nxitje e madhe për rrugëtimin e të rinjve. Shën Agustini thoshte: «Këndo, por ec; lehtësoje me këngë punën tënde, mos e duaj dembelinë: këndo dhe ec. [...] Ti, nëse përparon, ec; por ec në të mirën, në fenë e drejtë, në veprat e mira: këndo dhe ec».<sup>[120]</sup>

227. «Gjithashtu domethënëse është rëndësia që ka për të rinjtë sporti, potencialitetet edukative e formuese të të cilit Kisha nuk duhet t'i nënvleftësojë, por duhet të kujdeset që të ketë një prani të qëndrueshme në të. Bota e sportit ka nevojë të ndihmohet që t'i kapërcejë paqartësitë që po përjeton, sikurse mitizimi i kampionëve, nënshtrimi ndaj logjikave tregtare dhe ideologjia e suksesit me çdo kusht».<sup>[121]</sup> Në bazë të përvojës sportive gjendet «gëzimi: gëzimi për të lëvizur, gëzimi për të ndenjtur së bashku, gëzimi për jetën dhe për dhuratat që Krijuesi na bën çdo ditë».<sup>[122]</sup> Nga ana tjetër, disa Etër të Kishës kanë përdorur shembullin e praktikave sportive për t'i ftuar të rinjtë që të rriten në drejtim të forcës dhe që të mposhtin përgjumjen apo rehatinë. Shën Bazili i Madh, duke iu drejtuar të rinjve, përdorte shembullin e përpjekjes së kërkuar nga sporti dhe kështu nxiste në ta aftësinë për t'u flijuar dhe për t'u rritur në virtyte: «Pasi i kanë imponuar vetes mijëra flijime për të rritur, me të gjitha mjetet, forcën e tyre fizike, duke djersitur në ushtrimet e mundimshme të palestrës, [...] dhe, për të mos e zgjatur, pasi kanë bërë që kjo periudhë të mos jetë veçse një përgatitje, [...] i harxhojnë të gjitha burimet e tyre fizike e psikike, vetëm për të fituar një kurorë [...]. Dhe ne që presim, në jetën tjetër, çmime kaq të jashtëzakonshme sa asnjë gjuhë nuk mund t'i përshkruajë denjësisht, a mos ndoshta mendojmë se mund t'i arrijmë ato duke e kaluar jetën në flashkësi dhe në plogështi?».<sup>[123]</sup>

228. Te shumë adoleshentë dhe të rinj ngjall tërheqje të veçantë kontakti me botën e krijuar dhe janë të ndjeshëm ndaj mbrojtjes së mjedisit, ashtu si në rastin e *scout*-ve dhe të grupeve të tjera, që



organizojnë ditë për t'i kaluar në natyrë, kampime, shëtitje, ekskursionë dhe fushata mjedisore. Në shpirtin e Shën Françeskut të Asizit, këto janë përvoja që mund të përvijojnë një ecje për të hyrë në shkollën e vëllazërisë universale dhe në lutjen soditëse.

229. Këto dhe të tjera mundësi ungjillëzimi të të rinjve, nuk duhet të na bëjnë të harrojmë se, përtej ndryshimeve të historisë dhe të ndjeshmërisë së të rinjve, ka dhurata të Hyjit të cilat janë gjithmonë aktuale, që kanë një forcë që i tejkalon të gjitha epokat dhe të gjitha rrethanat: Fjala e Zotit gjithmonë e gjallë dhe efikase, prania e Krishtit në Eukaristi që na ushqen, Sakramenti i faljes që na liron dhe na forcon. Mund të përmendim edhe pasurinë e pashtershme shpirtërore, që Kisha ruan në dëshminë e shenjtërve të vet dhe në mësimin e mësuesve të mëdhenj shpirtërorë. Edhe pse duhet t'i respektojmë fazat e ndryshme dhe nganjëherë duhet të presim me durim momentin e duhur, nuk mund të mos i ftojme të rinjtë në këto burime jete të re, nuk kemi të drejtën t'i privojmë ata nga një e mirë kaq e madhe.

#### NJË BARITORE RINORE POPULLORE

230. Përveç punës së zakonshme baritore që bëjnë famullitë dhe lëvizjet, sipas skemave të caktuara, është shumë e rëndësishme t'i jepet hapësirë një "baritoreje rinore popullore", që ka një stil tjetër, kohë të tjera, një ritëm tjetër, një metodologji tjetër. Është një baritore më e gjerë dhe më elastike që nxit, në vendet ku gjenden konkretisht të rinjtë, ata udhërrëfyes të natyrshëm dhe ato karizma që Shpirti Shenjt ka mbjellë mes nesh. Bëhet fjalë para së gjithash që të mos nxjerrim shumë pengesa, norma, kontrole dhe inkuadrime detyruese para atyre të rinjve besimtarë që janë udhëheqës të natyrshëm në lagje dhe mjedise të ndryshme. Duhet të kufizohemi vetëm duke i shoqëruar dhe duke i nxitur, duke pasur më shumë besim në fantazinë e Shpirtit Shenjt që vepron si do vetë.

231. Po flasim për udhëheqës realisht "popullorë", jo elitarë apo të mbyllur në grupe të vogla të zgjedhurish. Që të jenë të aftë t'i japin jetë një baritoreje popullore në botën e të rinjve, duhet që «të mësojnë t'i perceptojnë ndjenjat e njerëzve, të bëhen zëdhënës të tyre dhe të punojnë për promovimin e tyre».<sup>[124]</sup> Kur flasim për "popull" nuk duhet të nënkuptojmë strukturat e shoqërisë apo të Kishës, por tërësinë e personave që nuk ecin si individë, por si pjesë e një bashkësie të të gjithëve dhe për të gjithë, e cila nuk mund të lejojë që më të varfrit dhe më të dobët të mbeten prapa: «Populli do që të gjithë të marrin pjesë në të mirat e përbashkëta dhe për këtë arsye pranon t'i përshtatet hapit të të fundmëve për të arritur të gjithë së bashku».<sup>[125]</sup> Pra, udhëheqës popullorë janë ata që kanë aftësi t'i përfshijnë të gjithë, duke përfshirë në ecjen rinore më të varfrit, të dobët, të kufizuarit dhe të plagosurit. Nuk ndiejnë siklet dhe nuk janë të frikësuar prej të rinjve të plagosur e të kryqëzuar.

232. Në po këtë linjë, veçanërisht me të rinjtë që nuk janë rritur në familje apo në institucione të krishtera dhe janë në një ecje të ngadaltë pjekurimi, duhet të nxisim të mirën e mundshme.<sup>[126]</sup> Krishti na ka paralajmëruar që të mos pretendojmë që gjithçka të shkojë vaj (krh. Mt 13,24-30). Nganjëherë, për të pasur një baritore rinore asketike, të pastër, të karakterizuar nga ide abstrakte, larg botës dhe të panjollë, e kthejmë Ungjillin në një propozim pa shije, të pakuptueshëm, të largët, të ndarë prej kulturave rinore dhe të përshtatshme vetëm për një elitë rinore të krishterë, që ndihet e ndryshme, por që në realitet pluskon në një izolim të pajetë dhe të pafrytshëm. Kështu, së bashku me egjirën që refuzojmë, shkullim apo ua marrim frymën mijëra fidanëve që përpiqen të rriten mes kufizimeve të shumta.

233. Në vend që «t'u marrim frymën me një tërësi rregullash, që japin një imazh reduktues dhe moralist të krishterimit, jemi të thirrur të investojmë në guximin e tyre dhe t'i edukojmë që t'i marrin përsipër përgjegjësitë e tyre, të sigurt se edhe gabimi, dështimi dhe kriza janë përvoja që e forcojnë njerëzimin e tyre».<sup>[127]</sup>

234. Në Sinod është bërë thirrje për ndërtimin e një baritoreje rinore të aftë për të krijuar hapësira përfshirëse, ku të ketë vend për çdo lloj të riu dhe ku të dëftohet realisht se jemi një Kishë me dyer të hapura. Dhe nuk është e nevojshme as që një njeri t'i pranojë plotësisht të gjitha mësimet e Kishës, që të marrë pjesë në disa prej hapësirave tona kushtuar të rinjve. Mjafton një qëndrim i hapur ndaj të gjithë atyre që kanë dëshirën dhe gatishmërinë të takohen prej të vërtetës së zbuluar nga Hyji. Disa propozime baritore mund të kërkojnë që të rinjtë të kenë bërë njëfarë ecje feje, por kemi nevojë për një baritore rinore popullore që të hapë dyert dhe t'u krijojë hapësirë të gjithëve dhe secilit me dyshimet, traumat, problemet dhe kërkimin e tyre të identitetit, me gabimet, historitë, përvojat e mëkatit dhe me të gjitha vështirësitë e tyre.

235. Duhet të ketë hapësirë edhe «për të gjithë ata që kanë këndvështrime të tjera për jetën, që dëshmojnë fe të tjera apo që deklarojnë se horizonti fetar është i huaj për ta. Të gjithë të rinjtë, pa përjashtim, janë në zemrën e Hyjit dhe prandaj edhe në zemrën e Kishës. Por me sinqeritet pranojmë se jo gjithmonë ky pohim që jehon në buzët tona gjen shprehje reale në veprimin tonë baritor: shpesh mbetemi të mbyllur në mjediset tona, ku zëri i tyre nuk arrin, ose u kushtohemi veprimtarive më pak kërkuese dhe më shumë kënaqëse, duke i zënë frymën atij shqetësimi të shëndoshë baritor që na bën të dalim prej sigurive tona të hamendësuar. E pra, Ungjilli na kërkon që të guxojmë dhe duam ta bëjmë këtë pa mendjemadhësi dhe pa bërë prozelitizëm, duke dëshmuar dashurinë e Zotit dhe duke ua shtrirë dorën të gjithë të rinjve të botës».<sup>[128]</sup>

236. Baritorja rinore, kur resht së qeni elitare dhe pranon të jetë “popullore”, e bën këtë gjë përmes një proces të ngadalshëm, respektues, të durueshëm, plot besim, të palodhur dhe të dhimbshëm. Në Sinod është paraqitur shembulli i nxënësve të Emausit (krh. Lk 24,13-35), që mund të jetë edhe model i asaj që ndodh në baritoren rinore.

237. «Jezusi ecën me dy nxënës që nuk e kanë kuptuar domethënien e ngjarjes së tij dhe janë duke u larguar prej Jerusalemit dhe bashkësisë. Për të ndenjur në shoqëri të tyre, bën rrugën me ta. I pyet dhe vendoset në një dëgjim të durueshëm të versionit të tyre të fakteve, që t'i ndihmojë ta njohin atë që janë duke jetuar. Pastaj, me dashuri dhe energji, u shpall atyre Fjalën, duke i bërë t'i interpretojnë në dritën e Shkrimeve ngjarjet që kanë përjetuar. Pranon ftesën për t'u ndalur me ta në të errur: hyn në natën e tyre. Në dëgjimin e vëmendshëm zemra e tyre ngrohet dhe mendja e tyre ndriçohet, në thyerjen e bukës sytë e tyre hapen. Janë ata vetë që zgjedhin të kthejnë rrugë, për t'u kthyer në bashkësi, duke bashkëndarë përvojën e takimit me të Ngjallurin».<sup>[129]</sup>

238. Shfaqjet e ndryshme të përshpirtërisë popullore, veçanërisht shtegtimet, tërheqin të rinj që nuk përfshihen lehtë në strukturat kishtarë dhe janë një shprehje konkrete e besimit në Hyjin. Këto forma të kërkimit të Hyjit, të pranishme veçanërisht te të rinjtë më të varfër, por edhe në sektorë të tjerë të shoqërisë, nuk duhet të përbuzen, por duhet të inkurajohen dhe të nxiten. Sepse përshpirtëria popullore «është një mënyrë e ligjshme për ta jetuar fenë»<sup>[130]</sup> dhe është «shprehje e veprimit misionar spontan të popullit të Hyjit».<sup>[131]</sup>

#### GJITHMONË MISIONARË

239. Dua të kujtoj se nuk është e nevojshme të bëhet një rrugëtim i gjatë që të rinjtë të bëhen misionarë. Edhe më të dobëtit, të kufizuarit e të plagosurit mund të jenë misionarë në mënyrën e tyre, sepse duhet lejuar gjithmonë që e mira të komunikohet, edhe kur shoqërohet me brishtësi. Një i ri që shkon në shtegtim për t'i kërkuar ndihmë Zojës së Bekuar dhe fton një mik apo një shok që ta shoqërojë atë, me këtë gjest të thjeshtë është duke bërë një veprim të çmueshëm misionar. Së bashku me baritoren popullore rinore është i pranishëm, në mënyrë të pandashme, edhe një mision popullor, i pakontrollueshëm, që i prish të gjitha skemat kishtarë. Le ta shoqërojmë atë, le ta inkurajojmë, por të mos pretendojmë ta rregullojmë më tepër seç duhet.

240. Nëse dimë ta dëgjojmë atë që është duke na thënë Shpirti Shenjt, nuk mund të mos dimë se baritorja rinore duhet të jetë gjithmonë një baritore misionare. Të rinjtë pasurohen shumë kur kapërcejnë druajtjen dhe gjejnë guximin të shkojnë e të vizitojnë shtëpitë dhe në këtë mënyrë hyjnë në kontakt me jetën e personave, mësojnë të shikojnë përtej familjes dhe grupit të tyre, fillojnë ta shohin jetën nga një perspektivë më e gjerë. Në të njëjtën kohë, feja dhe ndjenja e tyre e përkatësisë në Kishë forcohen. Misionet rinore, që zakonisht organizohen gjatë pushimeve pas një periudhe përgatitore, mund të nxisin një përtëritje të përvojës së fesë dhe afrime serioze thirrore.

241. Por të rinjtë janë të aftë të krijojnë forma të reja misioni, në fushat më të ndryshme. Për shembull, meqenëse lëvizin kaq mirë në rrjetet sociale, duhet të përfshihen në mënyrë që t'i mbushin ato me Hyjin, me vëllezëri, me angazhim.

#### SHOQËRIMI NGA ANA E TË RRITURVE

242. Të rinjtë kanë nevojë të respektohen në lirinë e tyre, por kanë nevojë edhe të shoqërohen. Familja duhet të jetë hapësira e parë e shoqërimit. Baritorja rinore propozon një projekt jete të bazuar në Krishtin: ndërtimi i një shtëpie, i një familjeje mbi shkëmb (krh. Mt 7,24-25). Ajo familje, ai projekt, për pjesën më të madhe të tyre do të konkretizohet në martesë dhe në dashurinë bashkëshortore. Prandaj është e nevojshme që baritorja rinore dhe baritorja familjare të jenë në një vazhdimësi të natyrshme, duke vepruar në mënyrë të koordinuar dhe të integruar, që ta shoqërojë siç duhet procesin thirror.

243. Bashkësia kryen një rol shumë të rëndësishëm në shoqërimin e të rinjve dhe është bashkësia në tërësi ajo që duhet të ndihet përgjegjëse për t'i pranuar, për t'i motivuar, për t'i inkurajuar dhe për t'i nxitur ata. Kjo kërkon që të rinjtë të shikohen me mirëkuptim, vlerësim e dashuri dhe që të mos gjykohen vazhdimisht apo të kërkohet prej tyre një përsosmëri që nuk i përgjigjet moshës së tyre.

244. Në Sinod «shumë vetë kanë vënë në dukje mungesën e personave ekspertë dhe që i kushtohen shoqërimit. Të besosh në vlerën teologjike dhe baritore të dëgjimit kërkohet që të përtërihen format me të cilat zakonisht shërbesa baritore shprehet dhe që të bëhet një verifikim i përparësive të kësaj shërbesë. Gjithashtu, Sinodi pranon nevojën e përgatitjes së të kushtuarve dhe të laikëve, burra e gra, të kualifikuar për shoqërimin e të rinjve. Karizma e dëgjimit që Shpirti Shenjt bën të lindë në bashkësi mund edhe të marrë një formë njohjeje institucionale për shërbimin kishtar».<sup>[132]</sup>

245. Gjithashtu, duhet të shoqërohen veçanërisht të rinjtë që paraqiten si udhëheqës të mundshëm, që të formohen e të përgatiten. Të rinjtë që janë mbledhur para Sinodit kanë kërkuar që të zhvillohen «programe të reja udhëheqjeje për formimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të të rinjve udhëheqës. Disa vajza perceptojnë një mungesë të figurave femërore të referimit brenda Kishës, të cilës edhe ato dëshirojnë t'i dhurojnë talentet e veta intelektuale dhe profesionale. Mendojmë gjithashtu se seminaristët dhe rregulltarët duhet të jenë edhe më të aftë që t'i shoqërojnë të rinjtë, që mbulojnë këto role përgjegjësie».<sup>[133]</sup>

246. Vetë të rinjtë na kanë përshkruar se cilat janë karakteristikat që shpresojnë të gjejnë te ata që i shoqërojnë dhe e kanë shprehur shumë qartë këtë gjë: «Një shoqërues i tillë duhet të ketë disa cilësi: të jetë një i krishterë besnik i angazhuar në Kishë dhe në botë; të jetë në kërkim të vazhdueshëm të shenjtërisë; të jetë një njeri i besueshëm që nuk gjykon; t'i dëgjojë aktivisht nevojat e të rinjve dhe të japë përgjigje të përshtatshme; të jetë plot dashuri dhe vetëdije; t'i pranojë kufizimet e veta dhe të jetë ekspert i gëzimeve dhe i dhimbjeve të jetës shpirtërore. Një cilësi me rëndësi parësore te shoqëruesit është njohja e njerëzimit të tyre, pra se janë qenie njerëzore dhe për këtë arsye të gabueshëm: jo persona të përsosur, por mëkatarë të falur. Nganjëherë shoqëruesit vendosen në pedestal dhe rrëzimi i tyre mund të ketë efekte shkatërruese, pasi të rinjtë mund të vendosin që të mos angazhohen më në Kishë. Shoqëruesit nuk duhet t'i drejtojnë të rinjtë sikur këta të ishin

ndjekës pasivë, por të ecin përkrah tyre, duke u lejuar atyre që të jenë pjesëmarrës aktivë të ecjes. Duhet të respektojnë lirinë që bën pjesë në procesin e shoshitjes së një të riu, duke u dhënë atyre mjetet për ta kryer sa më mirë atë. Një shoqërues duhet të jetë thellësisht i bindur për aftësinë që një i ri ka për t'u përfshirë në jetën e Kishës. Një shoqërues duhet të kultivojë farat e fesë të rinjtë, pa pritur që t'i shohë menjëherë frytet e veprimit të Shpirtit Shenjt. Roli i shoqëruesit nuk është dhe nuk duhet të jetë vetëm për meshtarë dhe persona të kushtuar, por edhe laikëve duhet t'u krijohej mundësia që ta mbulojnë këtë detyrë. Të gjithë shoqëruesit duhet të marrin një formim të qëndrueshëm dhe të angazhohen në formimin e tyre të përhershëm».<sup>[134]</sup>

247. Pa dyshim institucionet edukative të Kishës janë një mjedis i bashkësisë, shoqërimi i të cilës mundëson orientimin e shumë të rinjve, sidomos kur «përpiqen t'i pranojnë të gjithë të rinjtë, pavarësisht zgjedhjeve të tyre fetare, prejardhjes kulturore dhe situatës personale, familjare apo shoqërore. Në këtë mënyrë Kisha jep një ndihmesë themelore në edukimin e tërësishëm të të rinjve kudo që ata të ndodhen».<sup>[135]</sup> Do ta kufizonin pa të drejtë funksionin e tyre nëse do të vendosnin kritere të ngurta për pranimin e studentëve apo për qëndrimin e tyre, sepse do të linin jashtë shumë të rinj, duke i privuar kështu nga një shoqërim që në fakt do ta pasuronte jetën e tyre.

## KAPITULLI I TETË

### THIRRJA

248. Fjala “thirrje” mund të merret në kuptimin e gjerë, si thirrje e Hyjit. Ajo përfshin thirrjen në jetë, thirrjen në miqësinë me Të, thirrjen në shenjtëri, e kështu me radhë. ajo ka një vlerë të madhe, sepse e vendos gjithë jetën tonë përballë atij Hyji që na do dhe na mundëson të kuptojmë se asgjë nuk është fryt i një kaosi pa kuptim, por përkundrazi gjithçka mund të përfshihet në një ecje përgjigjeje ndaj Zotit, që ka një plan të mrekullueshëm për ne.

249. Në Nxitjen *Gaudete et exsultate* kam dëshiruar të ndalem në thirrjen e të gjithëve për t'u rritur për lavdinë e Hyjit dhe i kam vënë vetes qëllim «që të bëjë të jehojë edhe një herë thirrja në shenjtëri, duke bërë përpjekje që ajo të mishërohet në kontekstin aktual, me rreziqet, sfidat dhe mundësitë e veta».<sup>[136]</sup> Koncili II i Vatikanit na ka ndihmuar që ta përtërijmë vetëdijen për këtë thirrje drejtuar secilit: «Të gjithë besimtarët e çdo gjendjeje e kushtimi janë të thirrur prej Zotit, secili në rrugën e vet, në një shenjtëri, përsosmëria e të cilës është ajo e vetë Atit qiellor».<sup>[137]</sup>

### THIRRJA NË MIQËSINË ME TË

250. Gjëja themelore është të shohim dhe të zbulojmë se ajo që Jezusi dëshiron nga çdo i ri është para së gjithash miqësia me Të. Kjo është shoshitja themelore. Në dialogun e Zotërisë së ngjallur me mikun e vet Simon Pjetrin, pyetja e madhe ishte: «Simon Gjoni, a më do ti mua?» (Gjn 21,16). Me fjalë të tjera: a më do si mik? Misioni që Pjetri merr për t'u kujdesur për delet dhe qingjat e tij do të jetë gjithmonë në marrëdhënie me këtë dashuri falas, me këtë dashuri miqësore.

251. Dhe, po të jetë i nevojshëm një shembull në kuptimin e kundërt, le të kujtojmë takimin mes Zotit dhe të riut të pasur, që na shpreh qartë se si i riu nuk e kishte pranuar vështrimin e ëmbël të Zotit (krh. Mk 10,21). U largua i trishtuar, pasi, edhe kishte ndjekur një frymëzim të mirë, nuk arriti të shkëputej prej gjërave të shumta që kishte (krh. Mt 19,22). Humbi rastin e asaj që me siguri do të kishte qenë një miqësi e madhe. Dhe ne mbetemi pa ditur se çfarë do të kishte mundur të ishte për ne, çfarë do të kishte mundur të bënte për njerëzimin ai i ri unikal, që Jezusi e kishte shikuar me dashuri dhe të cilit i kishte shtrirë dorën.

252. Sepse «jeta që Jezusi na dhuron është një histori dashurie, një histori jete që dëshiron të gërshetohet me tonën dhe të hedhë rrënjë në tokën e secilit. Ajo jetë nuk është një shpëtim i varur “në re”, në pritje që të shkarkohet, as një “aplikacion” i ri që duhet zbuluar apo një ushtrim mendor fryt i teknikave të rritjes personale. Jeta që Hyji na ofron nuk është as një tutorial me të cilin mund të kuptojmë risinë e fundit. Shpëtimi që Hyji na dhuron është një ftesë për të bërë pjesë në një histori dashurie, që gërshetohet me historitë tona, që jeton dhe dëshiron të lindë mes nesh që të japim fryt aty ku jemi, si jemi dhe me kë jemi. Aty vjen Zoti për të mbjellë e për t’u mbjellë».<sup>[138]</sup>

#### TË JESH PËR TË TJERËT

253. Tani do të doja të ndalesha te thirrja e kuptuar në domethënien specifike të thirrjes në shërbimin misionar ndaj të tjerëve. Jemi thirrur prej Zotit për të marrë pjesë në veprën e tij krijuese, duke dhënë ndihmesën tonë për të mirën e përbashkët, në bazë të aftësive që kemi marrë.

254. Kjo thirrje misionare ka lidhje me shërbimin tonë ndaj të tjerëve. Jeta jonë mbi tokë arrin plotësinë e vet kur shndërrohet në dhuratë. Kujtoj se «misioni në zemrën e popullit nuk është një pjesë e jetës sime, ose një zbukurim që mund ta heq, nuk është një shtojcë, ose një moment mes shumë të tillëve në jetë. Është diçka që nuk mund ta çrrënjos prej qenies sime nëse nuk dua ta shkatërroj veten. Unë jam një mision në këtë tokë, dhe për këtë arsye gjendem në këtë botë».<sup>[139]</sup> Si rrjedhojë, duhet të mendojmë se çdo baritore është thirrore, çdo formim është thirror dhe çdo përshtetësi është thirrore.

255. Thirrja jote nuk janë vetëm veprimtaritë që duhet të bësh, edhe pse ajo shprehet në to. Është diçka më shumë, është një rrugëtim që do t’i orientojë shumë përpjekje dhe shumë veprime kah një drejtim shërbimi. Prandaj, në shoshitjen e një thirrjeje është e rëndësishme të kuptohet nëse një njeri i ka aftësitë e nevojshme për këtë shërbim specifik ndaj shoqërisë.

256. Kjo u jep një vlerë të madhe këtyre detyrave, sepse ato reshtin së qeni një shumë veprimesh, që bëhen për të fituar para, për të qenë të zënë ose për t’ua bërë qejfin të tjerëve. E gjithë kjo përbën një thirrje, sepse jemi të thirrur, ka diçka më shumë sesa një zgjedhje e thjeshtë pragmatike nga ana jonë. Si përfundim, bëhet fjalë për të njohur për çfarë jam krijuar, për çfarë kaloj nga kjo tokë, cili është plani i Zotit për jetën time. Ai nuk do të m’i tregojë të gjitha vendet, kohët dhe hollësitë, që unë do t’i zgjedh me maturi, por me siguri Ai do të ma tregojë drejtimin e jetës, sepse është Krijuesi im, poçari im dhe unë kam nevojë ta dëgjoj zërin e tij për të lejuar që Ai të më japë formë e të më bartë. Atëherë do të jem ai që duhet të jem dhe do të jem edhe besnik ndaj realitetit tim personal.

257. Për ta realizuar thirrjen tonë është e nevojshme të zhvillojmë dhe të kultivojmë gjithçka që jemi. Nuk bëhet fjalë për ta krijuar vetveten nga asgjëja, por për ta zbuluar atë në dritën e Hyjit dhe për të bërë që qenia jonë të lulëzojë: «Në planin e Hyjit, çdo njeri është i thirrur për t’u zhvilluar, sepse çdo jetë është thirrje».<sup>[140]</sup> Thirrja jote të orientojë për të dhënë maksimumin tënd për lavdinë e Hyjit dhe për të mirën e të tjerëve. Nuk bëhet fjalë vetëm për të bërë disa gjëra, por për t’i bërë ato me një domethënie, me një orientim. Në lidhje me këtë, Shën Albert Hurtado u thoshte të rinjve se duhet ta marrin seriozisht drejtimin, pasi «në një anije, timonieri i pakujdesshëm pushohet menjëherë nga puna, sepse ajo që ka në dorë është tepër e shenjtë. Po në jetë, a jemi ne të vëmendshëm ndaj drejtimit tonë? Cili është drejtimi yt? Po të ishte e nevojshme që të ndaleshim pak më shumë në këtë ide, do t’i kërkoja secilit prej jush që t’i kushtojë asaj rëndësinë më të madhe, pasi nëse ia arrijmë kësaj gjëje do të thotë thjesht se kemi pasur sukses; por nëse dështojmë, atëherë do të thotë thjesht se dështojmë».<sup>[141]</sup>

258. Kjo “të jesh për të tjerët” në jetën e çdo të riu është normalisht e lidhur me dy çështje themelore: formimi i një familjeje të re dhe puna. Sondazhet e ndryshme të bëra mes të rinjve pohojnë edhe një herë se këto janë dy temat e mëdha për të cilat ushqejnë dëshira dhe shqetësime. Të dyja duhet të jenë objekt i një shoshitjeje të veçantë. Le të ndalemi shkurtimisht tek ato.

#### DASHURIA DHE FAMILJA

259. Të rinjtë e ndiejnë fort thirrjen për të dashur dhe ëndërrojnë të takojnë personin e duhur me të cilin të formojnë një familje dhe të ndërtojnë një jetë së bashku. Pa dyshim, është një thirrje që vetë Hyji e paraqet nëpërmjet ndjenjave, dëshirave, ëndrrave. Mbi këtë temë jam ndalur gjatë në Nxitjen *Amoris laetitia* dhe i ftoj të gjithë të rinjtë që të lexojnë veçanërisht kapitujt 4 e 5.

260. Më pëlqen të mendoj se «dy të krishterë që martohen kanë parë në historinë e tyre të dashurisë thirrjen e Zotit, thirrjen për të formuar nga dy, mashkull e femër, një trup të vetëm, një jetë të vetme. Dhe Sakramenti i martesës e mbështjell këtë dashuri me hirin e Hyjit, e rrënjos në vetë Hyjin. Me këtë dhuratë, me sigurinë e kësaj thirrjeje, njerëzit mund të nisen të sigurt, nuk kanë frikë nga asgjë, mund të përballojnë gjithçka, së bashku!».<sup>[142]</sup>

261. Në këtë kontekst, kujtoj se Hyji na ka krijuar me gjini. Ai vetë «e ka krijuar seksualitetin, që është një dhuratë e mrekullueshme për krijesat e veta».<sup>[143]</sup> Brenda thirrjes për martesë, duhet të pranojmë dhe të jemi mirënjohës për faktin se «seksualiteti, seksi, është një dhuratë e Hyjit. Pa tabu. Është një dhuratë e Hyjit, një dhuratë që Zoti na jep. Ka dy qëllime: për t’u dashur dhe për të lindur jetën. Është një pasion, është dashuri e apasionuar. Dashuria e vërtetë është e apasionuar. Dashuria mes një burri dhe një gruaje, kur është e apasionuar, të bën ta dhurosh jetën përgjithmonë. Gjithmonë. Dhe ta japësh me trup e me shpirt atë».<sup>[144]</sup>

262. Sinodi ka theksuar se «familja vazhdon të përfaqësojë pikën kryesore të referimit për të rinjtë. Fëmijët e çmojnë dashurinë dhe kujdesin e prindërve, i kanë për zemër lidhjet familjare dhe shpresojnë të arrijnë të formojnë edhe ata vetë një familje. Pa dyshim shtimi i ndarjeve, i divorceve, i bashkimeve të dyta dhe i familjeve me një prind mund të shkaktojë te të rinjtë vuajtje të mëdha dhe kriza identiteti. Nganjëherë duhet të marrin përsipër përgjegjësi që nuk janë në përpjesëtim me moshën e tyre, që i detyrojnë të bëhen të rritur para kohe. Gjyshërit japin shpesh një ndihmesë vendimtare në dashurinë dhe në edukimin fetar: me urtinë e tyre janë një hallkë vendimtare në marrëdhënien mes brezave».<sup>[145]</sup>

263. Këto vështirësi të ndeshura në familjen e prejardhjes me siguri i bëjnë shumë të rinj që ta pyesin veten nëse ia vlen të formojnë një familje të re, të jenë besnikë, të jenë zemërgjerë. Dua t’ju them po, se ia vlen të vini bast për familjen dhe se në të do të gjeni nxitjet më të mira për t’u pjekur dhe gëzimet më të bukura për t’i bashkëndarë. Mos lejoni që t’jua vjedhin mundësinë për të dashur seriozisht. Mos u mashtroni nga ata që propozojnë një jetë të çrregullt individualiste, që çon në izolim dhe në vetminë më të keqe.

264. Sot sundon një kulturë e kalimtares, që është një iluzion. Të besojmë se asgjë nuk mund të jetë përfundimtare është një mashtrim dhe një rrenë. «Ka njerëz që thonë se sot martesë është “jashtë mode”. [...] Në kulturën e të përkohshmes, të relatives, shumë predikojnë se e rëndësishme është “ta shijosh” momentin, se nuk ia vlen të angazhohesh për gjithë jetën, të bësh zgjedhje përfundimtare. [...] Ndërsa unë ju kërkoi që të jeni revolucionarë, ju kërkoi të shkoni kundër rrymës; po, në këtë ju kërkoi të ngreni krye kundër kësaj kulture të së përkohshmes, që, në fund të fundit, beson se ju nuk jeni në gjendje të merrni përsipër përgjegjësi, beson se ju nuk jeni të aftë të doni me të vërtetë».<sup>[146]</sup> Ndërsa unë kam besim në ju, prandaj ju nxis të zgjidhni martesën.

265. Për martesë njeriu duhet të përgatitet dhe kjo kërkon që ai ta edukojë vetveten, të zhvillojë virtytet më të mira, veçanërisht dashurinë, durimin, aftësinë për dialog e shërbim. Kërkon edhe që të edukojë seksualitetin e vet, në mënyrë që të jetë gjithnjë e më pak një mjet për t'i përdorur të tjerët dhe gjithmonë e më shumë një aftësi për t'iu dhuruar plotësisht një personi në mënyrë ekskluzive e bujare.

266. Ipeshkvijtë e Kolumbisë na kanë mësuar se «Krishti e di se të martuarit nuk janë të përsosur dhe se kanë nevojë t'i kapërcejnë dobësitë e paqëndrueshmëritë e tyre, në mënyrë që dashuria të rritet dhe të zgjasë në kohë. Prandaj, u jep bashkëshortëve hirin, njëkohësisht dritë dhe forcë, që u mundëson atyre realizimin e planit të tyre të jetës martesore në përputhje me planin e Hyjit».<sup>[147]</sup>

267. Për ata që nuk janë të thirrur në martesë apo në jetën kushtuar Zotit, duhet të kujtojmë gjithmonë se thirrja e parë dhe më e rëndësishme është thirrja pagëzimore. Personat e pamartuar, edhe jo për zgjedhje, mund të bëhen në mënyrë të veçantë dëshmitarë të kësaj thirrjeje në ecjen e tyre të rritjes personale.

#### PUNA

268. Ipeshkvijtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë vënë në dukje me qartësi se rinia, pasi arrihet mosha madhore, «shënon shpesh hyrjen e një personi në botën e punës. “Çfarë bën për të jetuar?” është argumenti kryesor i bisedës, sepse puna është një pjesë shumë e rëndësishme e jetës së tyre. Për të rinjtë e rritur, kjo përvojë është shumë e ndryshme, sepse kalojnë nga një punë në tjetrën, si edhe nga një karrierë në tjetrën. Puna mund të përcaktojë përdorimin e kohës dhe mund të përcaktojë se çfarë mund të bëjnë apo të blejnë. Mund të përcaktojë edhe cilësinë dhe sasinë e kohës së lirë. Puna përcakton identitetin dhe konceptin për vetveten të një të riu të rritur dhe është një vend themelor ku zhvillohen miqësitë dhe marrëdhëniet e tjera, sepse zakonisht njeriu nuk punon vetëm. Të rinjtë, meshkuj e femra, flasin për punën si përmbushjen e një funksioni dhe si diçka që jep një domethënie. U mundëson të rinjve të rritur të plotësojnë nevojat e tyre praktike, si dhe – gjë edhe më e rëndësishme – të kërkojnë kuptimin dhe realizimin e ëndrrave dhe të vizioneve të tyre. Edhe pse puna mund t'i ndihmojë në realizimin e ëndrrave të tyre, është e rëndësishme që të rinjtë e rritur të kultivojnë një vizion, të mësojnë të punojnë në një mënyrë me të vërtetë personale dhe të kënaqshme për jetën e tyre, si edhe të vazhdojnë ta shohisin thirrjen e Hyjit».<sup>[148]</sup>

269. I ftoj të rinjtë që të mos presin të jetojnë pa punuar, duke u varur nga ndihma e të tjerëve. Kjo nuk është gjë e mirë, sepse «puna është një nevojë, është pjesë e kuptimit të jetës në këtë tokë, rrugë e pjekurimit, e zhvillimit njerëzor dhe e realizimit personal. Në këtë kuptim, të ndihmuarit e të varfërve me para duhet të jetë gjithmonë një zgjidhje e përkohshme për t'u bërë ballë disa emergjencave».<sup>[149]</sup> Prej kësaj del se «përshtirëria e krishterë, së bashku me mahnitjen soditëse për krijesat që e gjejmë te Shën Françesku i Asizit, ka zhvilluar edhe një kuptim të pasur dhe të shëndetshëm të punës, siç mund të gjejmë, për shembull, në jetën e të lumit Sharl de Fuko' dhe të nxënësve të tij».<sup>[150]</sup>

270. Sinodi ka theksuar se bota e punës është një fushë në të cilën të rinjtë «përfuturojnë forma përjashtimi dhe mënjanimi. E para dhe më e rënda është papunësia rinore, që në disa vende arrin nivele të tepruara. Përveçse i bën të varfër, mungesa e punës u heq të rinjve aftësinë për të ëndërruar e për të shpresuar dhe i privon nga mundësia për të dhënë një ndihmesë në zhvillimin e shoqërisë. Në shumë vende kjo situatë varet prej faktit se disa kategori të popullsisë rinore nuk kanë aftësitë e duhura profesionale, edhe për shkak të mangësive të sistemit edukativ e formues. Puna e përkohshme, që i mundon të rinjtë, u përgjigjet interesave ekonomike që shfrytëzojnë punën».<sup>[151]</sup>

271. Është një çështje shumë delikate që politika duhet ta konsiderojë si një problematikë parësore, në veçanti sot që shpejtësia e zhvillimeve teknologjike, së bashku me obsesionin për uljen e kostos

së punës, mund të çojë shpejt në zëvendësimin e vendeve të panumërta të punës me makineri. Bëhet fjalë për një çështje themelore të shoqërisë, sepse puna për një të ri nuk është thjesht një veprimtari që sjell të ardhura. Është një shprehje e dinjitetit njerëzor, është një ecje e pjekurisë dhe një përfshirje shoqërore, është një nxitje e vazhdueshme për t'u rritur në drejtim të përgjegjësisë dhe të krijimtarisë, është një mbrojtje kundër prirjes ndaj individualizmit dhe rehatisë, është edhe lavdi që i jepet Hyjit përmes zhvillimit të aftësive personale.

272. Jo gjithmonë një i ri e ka përgjegjësinë të vendosë se cilës gjë duhet t'ia kushtojë përpjekjet e veta, për çfarë detyrash duhet t'i shpenzojë energjitë e veta dhe aftësinë e vet për risi. Sepse, përtej dëshirave të veta dhe shumë përtej aftësive të veta të shoshitjes që një person mund të bëjë, ekzistojnë kufizimet e ashpra të realitetit. Është e vërtetë se nuk mund të jetosh pa punuar dhe se nganjëherë do të duhet të marrësh atë që gjen, por kurrë mos hiq dorë prej ëndrrave të tua, mos e varros kurrë një herë e përgjithmonë një thirrje, mos u dorëzo kurrë. Vazhdo gjithmonë të kërkosh, minimumi, modalitete të pjesshme apo të papërsosura të të jetuarit të asaj që në shoshitjen tënde e sheh si një thirrje të njëmendtë.

273. Kur një njeri zbulon se Hyji e thërret për diçka, se është bërë për këtë – mund të jetë infermieristika, zdrukthëtaria, komunikacioni, inxhinieria, mësimdhënia, arti apo çfarëdo pune tjetër – atëherë do të jetë i aftë t'i vërë në punë aftësitë e tij më të mira të flijimit, të bujarisë dhe të përkushtimit. Të diturit se gjërat nuk bëhen veç sa për t'u bërë, por me kuptim, si përgjigje ndaj një thirrjeje që jehon në thellësinë e qenies për t'u dhënë diçka të tjerëve, bën që këto veprimtari t'i japin zemrës një përvojë të veçantë plotësie. Kjo është ajo që thoshte libri biblik i Kishtarit: «Këndeje edhe e mora vesh se s'ka gjë më të mirë për njeriun sesa ta gëzojë mundin e vet» (3,22).

THIRRJE NË NJË PËRKUSHTIM TË VEÇANTË

274. Nëse nisemi nga bindja se Shpirti vazhdon të nxisë thirrje në meshtari dhe në jetën rregulltare, mund "t'i hedhim përsëri rrjetat" në emër të Zotit, me besim të plotë. Mundemi – dhe duhet – të kemi guxim që t'i themi çdo të riu që ta pyesë veten në lidhje me mundësinë për ta ndjekur këtë rrugë.

275. Disa herë ua kam bërë këtë propozim disa të rinjve, që më janë përgjigjur pothuajse me ton tallës duke thënë: «Jo, me të vërtetë, unë nuk shkoj në atë drejtim». Megjithatë, vite më vonë disa prej tyre ishin në Seminar. Zoti nuk mund të mos e mbajë premtimin e vet për të mos e lënë Kishën pa barinj, pa të cilët ajo nuk mund të jetojë dhe nuk mund ta kryejë misionin e vet. Dhe kur disa meshtarë nuk japin një dëshmi të mirë, Zoti gjithsesi nuk resht së thirruri. Përkundrazi, Ai e dyfishon thirrjen, pikërisht sepse nuk resht së kujdesuri për Kishën e vet të dashur.

276. Në shoshitjen e një thirrjeje nuk duhet të përjashtohet mundësia për t'iu kushtuar Hyjit në meshtari, në jetën rregulltare apo në forma të tjera të kushtimit. Pse të përjashtohet? Le ta kesh sigurinë se, nëse e pranon thirrjen e Hyjit dhe e ndjek atë, kjo do të jetë gjëja që do t'i japë plotësi jetës tënde.

277. Jezusi ecën mes nesh, ashtu siç bënte në Galile. Kalon rrugëve tona, ndalet dhe na shikon në sy, pa nxitim. Thirrja e tij është tërheqëse, është mahnitëse. Por, sot, ankthi dhe shpejtësia e shumë nxitjeve që na bombardojnë bëjnë që të mos ketë hapësirë për atë heshtje të brendshme në të cilën perceptohet vështirimi i Jezusit dhe dëgjohet thirrja e tij. Ndërkohë, merr shumë propozime të konfeksionuara mirë, që paraqiten të bukura dhe të forta, por me kalimin e kohës do të të lënë të zbrazët, të lodhur dhe vetëm. Mos lejo që të të ndodhë kjo, sepse vorbulla e kësaj bote të tërheq në një vrap pa kuptim, pa orientim, pa objektiva të qarta dhe kështu shumë përpjekje të tuat do të shkojnë dëm. Kërko më mirë ato hapësira qetësie dhe heshtjeje që të lejojnë të reflektosh, të lutesh, ta shikosh më mirë botën që të rrethon dhe në atë pikë, bashkë me Jezusin, mund ta kuptosh se cila është thirrja jote.



## KAPITULLI I NËNTË

### SHOSHITJA

278. Në lidhje me shoshitjen në përgjithësi, po ndalem në Nxitjen apostolike *Gaudete et exsultate*. Më lejoni të marr disa prej atyre reflektimeve dhe t'i përdor për shoshitjen e thirrjes personale në botë.

279. Kujtoj se të gjithë, por «sidomos të rinjtë, rrezikojnë një *zapping* të vazhdueshëm. Kemi mundësi të lundrojmë në dy apo tre ekrane njëkohësisht dhe të ndërveprojmë në të njëjtën kohë në skenare të ndryshme virtuale. Pa urtinë e shoshitjes mund të bëhemi me lehtësi kukulla që i nënshtrohen prirjeve të çastit».<sup>[152]</sup> Dhe «kjo është veçanërisht e rëndësishme kur në jetën tonë shfaqet një risi, dhe prandaj duhet të shohisim nëse është vera e re që vjen prej Hyjit apo një risi mashtruese e shpirtit të botës apo e shpirtit të djallit».<sup>[153]</sup>

280. Kjo shoshitje, «Edhe pse përfshin arsyen dhe maturinë, i tejkalon ato, sepse na ndihmon të shohim misterin e planit të vetëm e të papërsëritshëm që Hyji ka për secilin prej nesh. [...] Është në lojë kuptimi i jetës sime para Atit që më njeh dhe më do, kuptimi i vërtetë, për të cilin unë mund të jap ekzistencën time, dhe që askush nuk e njeh më mirë sesa Ai».<sup>[154]</sup>

281. Pikërisht në këtë kuadër vendoset formimi i ndërgjegjes, i cili bën të mundur që shoshitja të rritet në kuptimin e thellësisë dhe të besnikërisë ndaj Hyjit: «Formimi i ndërgjegjes është ecja e gjithë jetës në të cilën mësojmë të ushqejmë po ato ndjenja që kishte edhe Jezu Krishti duke marrë kriteret e zgjedhjeve të tij dhe qëllimet e të vepruarit të tij (krh. Fil 2,5)».<sup>[155]</sup>

282. Ky formim kërkon që ta lejojmë veten të shndërrohemi prej Krishtit dhe, në të njëjtën kohë, kërkon «një praktikë të zakonshme të së mirës, të verifikuar në shqyrtimin e ndërgjegjes: një ushtrim në të cilin nuk bëhet fjalë vetëm për të dalluar mëkatet, por edhe për të njohur veprën e Hyjit në ekzistencën tonë të përditshme, në ngjarjet e historisë dhe të kulturave ku jemi të përfshirë, në dëshminë e shumë burrave dhe grave të tjera që na kanë paraprirë apo na shoqërojnë me urtinë e tyre. E gjithë kjo na ndihmon që të rritemi në virtytin e maturisë, duke përcaktuar orientimin global të ekzistencës me zgjedhjet konkrete që bëjmë, me vetëdijen e kthjellët për dhuratat dhe kufizimet tona».<sup>[156]</sup>

### SI TA SHOSHITËSH THIRRJEN TËNDE

283. Një shprehje e shoshitjes është angazhimi për ta njohur thirrjen tonë. Është një detyrë që kërkon hapësira vetmie dhe heshtjeje, sepse bëhet fjalë për një vendim shumë personal, që asnjë tjetër nuk mund ta marrë në vendin tonë: «Edhe pse Zoti na flet në mënyra shumë të ndryshme gjatë punës sonë, nëpërmjet të tjerëve dhe në çdo moment, nuk është e mundur që të mos e marrim parasysh heshtjen e lutjes së zgjatur për ta perceptuar më mirë atë gjuhë, për të interpretuar domethënien reale të frymëzimeve që mendojmë se kemi marrë, për t'i qetësuar ankthet e për ta rindërtuar tërësinë e ekzistencës sonë në dritën e Hyjit».<sup>[157]</sup>

284. Kjo heshtje nuk është një formë izolimi, sepse «duhet të kujtojmë se shoshitja në lutje kërkon që të nisemi nga gatishmëria jonë për ta dëgjuar Zotin, të tjerët, vetë realitetin që gjithmonë na thërret në mënyra të reja. Vetëm ai që është i gatshëm ta dëgjojë atë është i lirë që të heqë dorë prej këndvështrimit të vet të pjesshëm dhe të pamjaftueshëm. [...] kështu është realisht i gatshëm të pranojë një thirrje që i prish siguritë e tij, por që e çon drejt një jete më të mirë, sepse nuk mjafton

që gjithçka të shkojë mirë, që gjithçka të jetë e qetë. Ndoshta Hyji është duke na ofruar diçka më shumë dhe ne, të shpërqendrimin tonë dembel, nuk e kuptojmë».<sup>[158]</sup>

285. Kur bëhet fjalë për të shoshitur thirrjen tonë, është e nevojshme që t'i bëjmë vetes pyetje të ndryshme. Nuk duhet të fillojmë duke pyetur se ku mund të fitohet më shumë, ose se ku mund të arrihet më shumë famë e përparësi shoqërore, por nuk duhet as të fillojmë duke pyetur se çfarë detyrash do të na jepnin më shumë kënaqësi. Për të mos gabuar, duhet të ndryshojmë perspektivë dhe të pyesim veten: a e njoh unë vetveten, përtej paraqitjeve të jashtme dhe përshtypjeve të mia? A e di se çfarë i jep gëzim zemrës sime dhe çfarë e trishton atë? Cilat janë pikat e mia të forta dhe pikat e mia të dobëta? Viojnë menjëherë pyetje të tjera: si mund të shërbej më mirë dhe si mund të jem më i dobishëm për botën dhe Kishën? Cili është vendi im në këtë tokë? Çfarë mund t'i ofroj unë shoqërisë? Viojnë edhe të tjera shumë realiste: a i kam aftësitë e nevojshme për ta bërë këtë shërbim? Ose, a mund t'i fitoj dhe t'i zhvilloj këto aftësi?

286. Këto pyetje duhet t'i bëhen jo aq vetes sonë, nëse i kemi apo jo këto prirje, sesa nëse i shfaqim në marrëdhëniet me të tjerët, përballë tyre, në mënyrë që shoshitja ta impostojë jetën tonë duke pasur si referim të tjerët. Për këtë arsye dua të kujtoj se cila është pyetja e madhe: «Shumë herë, në jetë, humbasim kohë duke pyetur veten: “Po kush jam unë?”. Ti mund ta pyesësh veten se kush je dhe të kalosh gjithë jetën duke kërkuar se kush je. Më mirë pyete veten: “Për kë jam unë?”».<sup>[159]</sup> Ti je për Hyjin, pa dyshim. Por Ai ka dashur që ti të jesh edhe për të tjerët dhe ka vendosur në ty shumë cilësi, prirje, dhurata e karizma që nuk janë për ty, por për të tjerët.

#### THIRRJA E MIKUT

287. Për ta shoshitur thirrjen tonë, duhet të pranojmë se ajo është thirrja e një miku: Jezusit. Miqve, kur u bëhet një dhuratë, u dhurohet gjëja më e mirë. Dhe kjo nuk është domosdoshmërisht gjëja më e kushtueshme apo më e vështirë për t'u gjetur, por ajo që ne e dimë sesa do ta gëzojë tjetrin. Një mik ka një perceptim aq të qartë për këtë, sa mund ta imagjinojë mikut e vet me buzë në gaz ndërsa hap dhuratën e vet. Kjo shoshitje miqësie është ajo që u propozoj të rinjve si model nëse duan të kuptojnë se cila është vullnesa e Hyjit për jetën e tyre.

288. Dua që ta dini se kur Zoti mendon për secilin prej nesh, për atë se çfarë do të na dhuronte, mendon për ne si për një mik të vetin personal. Dhe nëse ka vendosur të të dhurojë një hir, një karizëm që do të të bëjë ta jetosh jetën tënde në plotësi dhe do të të shndërrorë në një person të dobishëm për të tjerët, në dikë që lë një gjurmë në histori, do të jetë me siguri diçka që do të të bëjë të lumtur dhe do të të entuziazmojë më shumë sesa çdo gjë tjetër në këtë botë. Jo sepse ajo që është duke të të dhënë është një karizmë e jashtëzakonshme apo e rrallë, por sepse do të jetë sipas masës sate, sipas masës së jetës sate.

289. Dhurata e thirrjes pa dyshim do të jetë një dhuratë kërkuese. Dhuratat e Hyjit janë ndërvepruese dhe për t'i shijuar ato duhet të futesh në lojë, duhet të rrezikosh. Megjithatë, nuk do të jetë kërkesa për një detyrë të imponuar prej një tjetri nga jashtë, por diçka që do të të nxisë të rritesh dhe të bësh disa zgjedhje në mënyrë që kjo dhuratë të piqet e të bëhet një dhuratë për të tjerët. Kur Zoti nxit një thirrje, Ai mendon jo vetëm për atë që je, por për gjithçka që, së bashku me Të dhe me të tjerët, do të bëhesh.

290. Fuqia e jetës dhe forca e personalitetit vetjak ushqejnë njëra-tjetrën brenda çdo të riu dhe e nxisin atë të shkojë përtej çdo kufizimi. Mungesa e përvojës bën që ky kufizim të shkojë më tej, edhe pse shumë shpejt kjo gjë kthehet në përvojë, disa herë të dhimbshme. Është e rëndësishme që kjo dëshirë për «të pafundmen e kohës kur ende nuk ishte provuar të fillohej»<sup>[160]</sup> të vihet në kontakt me miqësinë e pakushtëzuar që Jezusi na ofron. Para çdo ligji dhe çdo detyre, ajo që Jezusi na propozon të zgjedhim është një ndjekje, si ajo e miqve që e ndjekin, që e kërkojnë dhe që e gjejnë

njëri-tjetrin thjesht për miqësi. Të gjitha të tjerat vijnë më pas, madje edhe dështimet e jetës mund të jenë një përvojë e çmueshme e kësaj miqësie që nuk priset kurrë.

## DËGJIMI DHE SHOQËRIMI

291. Ka meshtarë, rregulltarë, rregulltare, laikë, profesionistë dhe të rinj të kualifikuar që mund t'i shoqërojnë të rinjtë në shoshitjen e tyre thirrore. Nëse ndihmojmë një tjetër që ta shohisë rrugën e jetës së tij, gjëja e parë është ta dëgjojmë atë. Ky dëgjim nënkupton tri ndjeshmëri apo vëmendje të dallueshme prej njëra-tjetrës dhe përplotësuese.

292. Ndjeshmëria e parë apo vëmendja e parë është ndaj personit. Bëhet fjalë për ta dëgjuar tjetrin që është duke na dhënë vetveten nëpërmjet fjalëve të veta. Shenja e këtij dëgjimi është koha që i kushtoj tjetrit. Nuk është çështje sasive, por që tjetri të ndiejë që koha ime është e tij: koha për të cilën ai ka nevojë që të më shprehë atë që do. Duhet të ndiejë se e dëgjoj në mënyrë të pakushtëzuar, pa u fyer, pa u shkandulluar, pa u acaruar, pa u lodhur. Ky dëgjim është ai që Zoti ushtron kur fillon të ecë pranë nxënësve të Emausit dhe i shoqëron për një copë të mirë rruge, që shkonte në drejtimin e kundërt të rrugës së duhur (krh. Lk 24,13-35). Kur Jezusi bën sikur duhet të vazhdojë, sepse ata të dy kanë arritur në shtëpi, atëherë kuptojnë se u kishte dhuruar atyre kohën e vet dhe në atë pikë i dhurojnë të vetën, duke i ofruar mikpritje. Ky dëgjim i vëmendshëm dhe i painteres tregon vlerën që personi tjetër ka për ne, përtej ideve e zgjedhjeve të tij të jetës.

293. Ndjeshmëria e dytë apo vëmendja e dytë është shoshitja. Bëhet fjalë për të gjetur pikën e duhur në të cilën dallohet hiri prej tundimit. Sepse nganjëherë gjërat që përshkojnë përfytyrimin tonë janë vetëm tundime që na largojnë prej rrugës sonë të vërtetë. Këtu duhet të pyes veten se çfarë është duke më thënë saktësisht ai person, çfarë dëshiron të më thotë, çfarë dëshiron që unë të kuptoj nga ajo që është duke i ndodhur. Janë pyetje që na ndihmojnë të kuptojmë se si lidhen mes tyre argumentet që e nxisin tjetrin dhe të ndiejmë peshën dhe ritmin e ndjenjave të tij të ndikuara nga kjo logjikë. Ky dëgjim ka si qëllim shoshitjen e fjalëve shpëtimtare të Shpirtit të mirë, që na propozon të vërtetën e Zotit, por edhe kurthet e shpirtit të keq, mashtrimet dhe joshjet e tij. Duhet të kemi guximin, dashurinë dhe delikatesën e nevojshme për ta ndihmuar tjetrin që të njohë të vërtetën dhe mashtrimet apo pretekstet.

294. Ndjeshmëria e tretë apo vëmendja e tretë është dëgjimi i shtytjeve “përpara”, që tjetri përjeton. Është dëgjimi i thellë i asaj se “ku dëshiron të shkojë me të vërtetë tjetri”. Përtej asaj që ndien dhe mendon në të tashmen dhe asaj që ka bërë në të kaluarën, vëmendja është e drejtuar nga ajo që ai do të donte të ishte. Nganjëherë kjo kërkon që personi të mos shikojë edhe aq atë që i pëlqen, dëshirat e veta sipërfaqësore, por atë që i pëlqen më shumë Zotit, planin që Zoti ka për jetën e tij dhe që shprehet në një prirje zemre, përtej asaj që shikojmë dhe që ndiejmë. Ky dëgjim është vëmendje ndaj qëllimit të fundit, i cili në fund vendos për jetën, sepse ekziston Dikush si Jezusi që e kupton dhe e çmon këtë qëllim të fundit të zemrës. Prandaj Ai është gjithmonë i gatshëm ta ndihmojë secilin që ta njohë, dhe prandaj i mjafton që dikush t'i thotë: «O Zot, më shpëto! Ki mëshirë për mua!».

295. Vetëm atëherë shoshitja bëhet një mjet i fortë angazhimi për ta ndjekur më mirë Zotin.<sup>[161]</sup> Në këtë mënyrë, dëshira për ta njohur thirrjen personale merr një intensitet të epërm, një cilësi të ndryshme dhe një nivel të epërm, që i përgjigjet shumë më mirë dinjitetit të jetës personale. Sepse, në fund të fundit, një shoshitje e mirë është një ecje lirie që e ndriçon atë realitet unikal të çdo personi, atë realitet që është aq i tij, aq personal, sa vetëm Hyji e njeh. Të tjerët nuk mundën as ta kuptojnë plotësisht dhe as ta parashikojnë nga jashtë se si do të zhvillohet.

296. Prandaj, kur dikush e dëgjon tjetrin në këtë mënyrë, në njëfarë pike duhet të zhduket për ta lejuar atë që ta ndjekë rrugën që ka zbuluar. Të zhduket siç zhduket Zoti prej syve të nxënësve të

vet, duke i lënë vetëm me zjarrin e zemrës, që shndërrohet në një shtytje të parezistueshme për t'u vënë në ecje (krh. Lk 24,31-33). Kur të kthehen në bashkësi, nxënësit e Emausit do të marrin konfirmimin se Zoti është ngjallur me të vërtetë (krh. Lk 24,34).

297. Meqenëse «koha është superiore ndaj hapësirës»,<sup>[162]</sup> duhet të nxisim dhe të shoqërojmë procese, jo të imponojmë rrugëtime. Bëhet fjalë për procese personash që janë gjithmonë unikalë dhe të lirë. Prandaj është e vështirë të shkruhen receta, edhe kur të gjitha shenjat janë pozitive, sepse «bëhet fjalë për t'ia nënshtruar faktorët pozitivë shoshitjes së kujdesshme, që të mos izoloohen nga njëri-tjetri dhe të mos bien në kundërshtim mes tyre, duke u absolutizuar dhe duke luftuar kundër njëri-tjetrit. E njëjta gjë duhet thënë për faktorët negativë: nuk duhet të përjashtohen në bllok dhe pa bërë asnjë dallim, sepse në secilin prej tyre mund të fshihet ndonjë vlerë, që pret të lirohet dhe të çohet drejt të vërtetës së vet të plotë».<sup>[163]</sup>

298. Por për t'i shoqëruar të tjerët në këtë ecje, është e nevojshme para së gjithash që ti të jesh i ushtruar mirë për ta përshkuar vetë atë. Maria e ka bërë këtë, duke u përballuar me pyetjet dhe vështirësitë e veta kur ishte shumë e re. Ajo e përtëriftë rininë tënde me forcën e lutjes së vet dhe të shoqëroftë gjithmonë me praninë e saj prej Nënë.

\* \* \*

DHE PËR TË PËRFUNDUAR... NJË DËSHIRË

299. Të dashur të rinj, do të jem i lumtur t'ju shoh të vraponi më shpejt sesa ata që janë të ngadaltë e frikacakë. Vraponi «të tërhequr nga ajo Fytyrë shumë e dashur, që e adhurojmë në Eukaristinë e shenjtë dhe e njohim në trupin e vëllait që vuan. Shpirti Shenjt ju nxittë në këtë vrapim përpara. Kisha ka nevojë për hovin tuaj, për intuitat tuaja, për fenë tuaj. Kemi nevojë për to! Kur të arrini aty ku ne nuk kemi arritur ende, kini durimin të na prisni».<sup>[164]</sup>

*Loreto, pranë Shenjtërores së Shtëpisë së Shenjtë,  
25 mars, e Kremtja e Lajmërimit të Zotit,  
e vitit 2019, i shtati i pontifikatit.*

**FRANÇESKU**

## SHËNIME

- [1] E njëjta fjalë greke që do të thotë “i ri” përdoret për të shprehur “të riun”.
- [2] Rrëfimet, X, 27: PL 32, 795.
- [3] Shën Ireneu, Contro le eresie, II, 22, 4: PG 7, 784.
- [4] Documento Finale della XV Assemblea Generale Ordinaria del Sinodo dei Vescovi, 60. Tani e tutje ky dokument do të citohet me siglën DF. Ai mund të gjendet në [http://www.vatican.va/roman\\_curia/synod/documents/rc\\_synod\\_doc\\_20181027\\_doc-final-instrumentum-xvassemblea-giovani\\_it.html](http://www.vatican.va/roman_curia/synod/documents/rc_synod_doc_20181027_doc-final-instrumentum-xvassemblea-giovani_it.html)
- [5] Katekizmi i Kishës Katolike, 515.
- [6] Ibid., 517.
- [7] Catechesi (27 qershor 1990), 2-3: Insegnamenti 13, 1 (1990), 1680-1681.
- [8] Nxit. ap. passinod. *Amoris laetitia* (19 mars 2016), 182: AAS 108 (2016), 384.
- [9] DF 63.
- [10] Messaggio all’umanità: Ai giovani (8 dhjetor 1965): AAS 58 (1966), 18.
- [11] Ibid.
- [12] DF 1
- [13] Ibid, 8.
- [14] Ibid., 50.
- [15] Ibid., 53.
- [16] Krh. Konc. II Ekum. i Vat., Kusht. dogm. *Dei Verbum*, 8.
- [17] DF 150.
- [18] Discorso nella Veglia con i giovani alla XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (26 janar 2019): L’Osservatore Romano, 28-29 janar 2019, 6.
- [19] Preghiera al termine della Via Crucis della XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (25 janar 2019): L’Osservatore Romano, 27 janar 2019, 12.
- [20] DF 65.
- [21] Ibid., 167.
- [22] Shën Gjon Pali II, Discorso ai giovani a Torino (13 prill 1980), 4: Insegnamenti 3, 1 (1980), 905.
- [23] Benedikti XVI, Messaggio per la XXVII Giornata Mondiale della Gioventù (15 mars 2012): AAS 104 (2012), 359.
- [24] DF 8.
- [25] Ibid.
- [26] Ibid., 10.
- [27] Ibid., 11.
- [28] Ibid., 12.
- [29] Ibid., 41.
- [30] Ibid., 42.
- [31] Discorso ai giovani a Manila (18 janar 2015): L’Osservatore Romano, 19-20 janar 2015, 7.
- [32] DF 34.
- [33] Documento della Riunione pre-sinodale in preparazione alla XV Assemblea Generale Ordinaria del Sinodo dei Vescovi (24 mars 2018), I, 1.
- [34] DF 39.
- [35] Ibid., 37.
- [36] Krh. Let. enc. *Laudato si’* (24 maj 2015), 106: AAS 107 (2015), 889-890.
- [37] DF 37.
- [38] Ibid., 67.

- [39] Ibid., 21.
- [40] Ibid., 22.
- [41] Ibid., 23.
- [42] Ibid., 24.
- [43] Documento della Riunione pre-sinodale in preparazione alla XV Assemblea Generale Ordinaria del Sinodo dei Vescovi (24 mars 2018), I, 4.
- [44] DF 25.
- [45] Ibid.
- [46] Ibid., 26.
- [47] Ibid., 27.
- [48] Ibid., 28.
- [49] Ibid., 29.
- [50] Discorso al termine dell'Incontro su "La protezione dei minori nella Chiesa" (24 shkurt 2019): L'Osservatore Romano, 25-26 shkurt 2019, 10.
- [51] DF 29.
- [52] Lettera al Popolo di Dio (20 gusht 2018), 2: L'Osservatore Romano, 20-21 gusht 2018, 7.
- [53] DF 30.
- [54] Discorso alla I Congregazione generale della XV Assemblea Generale Ordinaria del Sinodo dei Vescovi (3 tetor 2018): L'Osservatore Romano, 5 tetor 2018, 8.
- [55] DF 31.
- [56] Ibid.
- [57] Konc. II Ekum. i Vat., Kusht. barit. *Gaudium et spes*, 1.
- [58] DF 31.
- [59] Ibid., 31.
- [60] Discorso al termine dell'Incontro su "La protezione dei minori nella Chiesa" (24 shkurt 2019): L'Osservatore Romano, 25-26 shkurt 2019, 11.
- [61] Francisco Luis Bernárdez, "Soneto", te Cielo de tierra, Buenos Aires, 1937.
- [62] Nxit. ap. *Gaudete et exsultate* (19 mars 2018), 140.
- [63] Omelia nella Messa della XXXI Giornata Mondiale della Gioventù a Cracovia (31 korrik 2016): AAS 108 (2016), 923.
- [64] Discorso nella cerimonia di apertura della XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (24 janar 2019): L'Osservatore Romano, 26 janar 2019, 12.
- [65] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 1: AAS 105 (2013), 1019.
- [66] Ibid., 3: 1020.
- [67] Discorso nella Veglia della XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (26 gennaio 2019): L'Osservatore Romano, 28-29 janar 2019, 6.
- [68] Discorso nell'incontro con i giovani durante il Sinodo (6 tetor 2018): L'Osservatore Romano, 8-9 tetor 2018, 7.
- [69] Benedikti XVI, Let. enc. *Deus caritas est* (25 dhjetor 2005), 1: AAS 98 (2006), 217.
- [70] Pedro Arrupe, Enamórate.
- [71] Shën Pali VI, Discorso per la beatificazione di Nunzio Sulprizio (1 dhjetor 1963): AAS 56 (1964), 28.
- [72] DF 65.
- [73] Omelia nella Messa con i giovani a Sydney (2 dhjetor 1970): AAS 63 (1971), 64.
- [74] Rrëfimet, I, 1, 1: PL 32, 661.
- [75] Dio è giovane. Una conversazione con Thomas Leoncini, Milano 2018, 16.
- [76] DF 68.
- [77] Discorso ai giovani a Cagliari (22 shtator 2013): AAS 105 (2013), 904-905.
- [78] Cinque pani e due pesci. Dalla sofferenza del carcere una gioiosa testimonianza di fede, Milano 2014, 20.
- [79] Konferenca Ipeshkvnore Zvicerane, Prendre le temps: pour toi, pour moi, pour nous, 2 shkurt 2018.

- [80] Krh. Shën Toma i Akuinit, *Summa Theologiae* II-II, q. 23, neni 1.
- [81] Discorso ai volontari della XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (27 janar 2019): *L'Osservatore Romano*, 28-29 janar 2019, 11.
- [82] S. Oscar A. Romero, Omelia (6 nëntor 1977): *Su pensamiento*, I-II, San Salvador 2000, 312.
- [83] Discorso alla cerimonia di apertura della XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (24 janar 2019): *L'Osservatore Romano*, 26 janar 2019, 12.
- [84] Krh. Incontro con i giovani nel Santuario Nazionale di Maipú, Santiago del Cile (17 janar 2018): *L'Osservatore Romano*, 19 janar 2018, 7.
- [85] Krh. Romano Guardini, *Le età della vita: Opera omnia* IV/ 1, Brescia 2015, 209.
- [86] Nxit. ap. *Gaudete et exsultate* (19 mars 2018), 11.
- [87] Cantico Spirituale B, Prologo, 2.
- [88] *Ibid.*, XIV-XV, 2.
- [89] Konferenca Ipeshkvnore e Ruandës, Lettera dei Vescovi cattolici ai fedeli durante l'anno speciale della riconciliazione in Ruanda, Kigali (18 janar 2018), 17.
- [90] Saluto ai giovani del Centro Culturale Padre Félix Varela all'Avana (20 shtator 2015): *L'Osservatore Romano*, 21-22 shtator 2015, 6.
- [91] DF 46.
- [92] Discorso nella Veglia della XXVIII Giornata Mondiale della Gioventù a Rio de Janeiro (27 korrik 2013): *AAS* 105 (2013), 663.
- [93] *Ustedes son la luz del mundo*, Discorso en el Cerro San Cristóbal, Chile, 1940: <https://www.padrealbertohurtado.cl/escritos-2/>.
- [94] Omelia nella Messa della XXVIII Giornata Mondiale della Gioventù a Rio de Janeiro (28 korrik 2013): *AAS* 105 (2013), 665.
- [95] Konferenca Ipeshkvnore Katolike e Koresë, Lettera pastorale in occasione del 150° anniversario del martirio durante la persecuzione Byeong-in (30 mars 2016).
- [96] Krh. Omelia nella Messa per la XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (27 janar 2019): *L'Osservatore Romano*, 28-29 janar 2019, 12.
- [97] Preghiera "Signore, fa' di me uno strumento della tua pace", e frymëzuar nga Shën Françesku i Asizit.
- [98] Discorso nella Veglia della XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (26 janar 2019): *L'Osservatore Romano*, 28-29.01.2019, 6.
- [99] DF 14.
- [100] Krh. Let. enc. *Laudato si'* (24 maj 2015), 145: *AAS* 107 (2015), 906.
- [101] Video-messaggio per l'Incontro mondiale dei giovani indigeni a Panama (17-21 janar 2019): *L'Osservatore Romano*, 19 janar 2019, 8.
- [102] DF 35.
- [103] Krh. Lettera ai giovani, I, 2: PG 31, 565.
- [104] Krh. *La saggezza del tempo*. In dialogo con Papa Francesco sulle grandi questioni della vita. A cura di Antonio Spadaro, Venezia 2018.
- [105] *Ibid.*, 12.
- [106] *Ibid.*, 13.
- [107] *Ibid.*
- [108] *Ibid.*
- [109] *Ibid.*, 162-163.
- [110] Eduardo Pironio, Messaggio ai giovani argentini nell'incontro nazionale giovanile a Cordoba (12-15 shtator 1985), 2.
- [111] DF 123.
- [112] *L'essenza del cristianesimo*, Brescia 1984, 12.
- [113] N. 165: *AAS* 105 (2013), 1089.
- [114] Discorso nella visita alla Casa del Buon Samaritano a Panama, (27 janar 2019): *L'Osservatore Romano*, 28-29 janar 2019, 10.
- [115] DF 36.

- [116] Krh. Kusht. ap. *Veritatis gaudium* (8 dhjetor 2017), 4: AAS 110 (2018), 7-8.
- [117] Discorso nell'incontro con gli studenti e il mondo accademico in Piazza San Domenico a Bologna (1 tetor 2017): AAS 109 (2017), 1115.
- [118] DF 51.
- [119] Ibid. 47.
- [120] Sermo 256, 3: PL 38, 1193.
- [121] DF 47.
- [122] Discorso a una delegazione di "Special Olympics International" (16 shkurt 2017): L'Osservatore Romano, 17 shkurt 2017, 8.
- [123] Lettera ai giovani, VIII, 11-12: PG 31, 580.
- [124] Konferenca Ipeshkvnore Argjentinase, Declaración de San Miguel, Buenos Aires, 1969, X, 1.
- [125] Rafael Tello, La nueva evangelización, Tomo II (Anexos I y II), Buenos Aires, 2013, 111.
- [126] Krh. Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 44-45: AAS 105 (2013), 1038-1039.
- [127] DF 70.
- [128] Ibid., 117.
- [129] Ibid., 4.
- [130] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 124: AAS 105 (2013), 1072.
- [131] Ibid., 122: 1071.
- [132] DF 9.
- [133] Documento della Riunione pre-sinodale in preparazione alla XV Assemblea Generale Ordinaria del Sinodo dei Vescovi (24 mars 2018), 12.
- [134] Ibid., 10.
- [135] DF 15.
- [136] N. 2.
- [137] Kusht. dogm. *Lumen gentium*, 11.
- [138] Discorso nella Veglia con i giovani alla XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù a Panama (26 janar 2019): L'Osservatore Romano, 28-29 janar 2019, 6.
- [139] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 273: AAS 105 (2013), 1130.
- [140] Sh. Pali VI, Let. enc. *Populorum progressio* (26 mars 1967), 15: AAS 59 (1967), 265.
- [141] Meditación de Semana Santa para jóvenes, shkruar në bordin e një anijeje mallrash, në kthim nga Shtetet e Bashkuara, 1946: <https://www.padrealbertohurtado.cl/escritos-2/>.
- [142] Incontro con i giovani dell'Umbria ad Assisi (4 tetor 2013): AAS 105 (2013), 921.
- [143] Nxit. ap. pas-sinod. *Amoris laetitia* (19 mars 2016), 150: AAS 108 (2016), 369.
- [144] Udiencia ai giovani della diocesi di Grenoble-Vienne, Francia (17 shtator 2018): L'Osservatore Romano, 19 shtator 2018, 8.
- [145] DF 32.
- [146] Incontro con i volontari della XXVIII Giornata Mondiale della Gioventù a Rio de Janeiro (28 korrik 2013): Insegnamenti, 1, 2 (2013), 125.
- [147] Konferenca Ipeshkvnore e Kolumbisë, Mensaje Cristiano sobre el matrimonio (14 maj 1981).
- [148] Konferenca Ipeshkvnore e Shteteve të Bashkuara, Sons and Daughters of Light: A Pastoral Plan for Ministry with Young Adults, 12 nëntor 1996, I, 3.
- [149] Let. enc. *Laudato si'* (24 maj 2015), 128: AAS 107 (2015), 898.
- [150] Ibid., 125: 897.
- [151] DF 40.
- [152] Nxit. ap. *Gaudete et exsultate* (19 mars 2018), 167.
- [153] Ibid., 168.
- [154] Ibid., 170.
- [155] DF 108.
- [156] Ibid.
- [157] Nxit. ap. *Gaudete et exsultate* (19 mars 2018), 171.
- [158] Ibid., 172.



- [159] Discorso nella Veglia di preghiera in preparazione alla XXXIV Giornata Mondiale della Gioventù, Basilica di S. Maria Maggiore, (8 prill 2017): AAS 109 (2017), 447.
- [160] Romano Guardini, *Le età della vita: Opera omnia IV/ 1*, Brescia 2015, 209.
- [161] Krh. Nxit. ap. *Gaudete et exsultate* (19 mars 2018), 169.
- [162] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 222: AAS 105 (2013), 1111.
- [163] Shën Gjon Pali II, Nxit. ap. pas-sinod. *Pastores dabo vobis* (25 mars 1992), 10: AAS 84 (1992), 672.
- [164] Incontro e preghiera con i giovani italiani al Circo Massimo a Roma (11 gusht 2018): *L'Osservatore Romano*, 13-14 gusht 2018, 6.

## TREGUESI

Paraqitje ..... fq. 5

### KAPITULLI I PARË

Ç' thotë Fjala e Hyjit  
në lidhje me të rinjtë? ..... 11  
Në Besëlidhjen e Vjetër ..... 11  
Në Besëlidhjen e Re ..... 14

### KAPITULLI I DYTË

Jezu Krishti gjithmonë i ri ..... 20  
Rinia e Jezusit ..... 20  
Rinia e tij na ndriçon ..... 25  
Rinia e Kishës ..... 27  
Një Kishë që e lë veten të përtërihet ..... 28  
Një Kishë e vëmendshme  
ndaj shenjave të kohëve ..... 30  
Maria, vajza e Nazaretit ..... 33  
Të rinj të shenjtë ..... 37

### KAPITULLI I TRETË

Ju jeni e tashmja e Hyjit ..... 42  
Pozitivisht ..... 42  
Shumë rini ..... 44  
Disa gjëra që u ndodhin të rinjve ..... 46  
Të rinjtë e një bote në krizë ..... 46  
Dëshira, plagë dhe kërkime ..... 52  
Mjedisi dixhital ..... 54  
Migrantët si paradigmë e kohës sonë ..... 58  
T'i jepet fund çdo forme abuzimi ..... 61  
Ka një rrugëdalje ..... 67

### KAPITULLI I KATËRT

Shpallja e madhe për të gjithë të rinjtë ..... 71  
Një Hyj që është dashuri ..... 71  
Krishti të shpëton ..... 75  
Ai jeton! ..... 79  
Shpirti jep jetë ..... 82

## KAPITULLI I PESTË

Rrugëtime rinore .....	85
Kohë ëndrrash dhe zgjedhjesh .....	86
Dëshira për të jetuar dhe për të eksperimentuar .....	91
Në miqësi me Krishtin .....	94
Rritja dhe pjekurimi .....	98
Rrugëtime vëllazërie .....	103
Të rinj të angazhuar .....	106
Misionarë të guximshëm .....	111

## KAPITULLI I GJASHTË

Të rinj me rrënjë .....	114
Që të mos të të shkulin nga toka .....	114
Marrëdhënia jote me të moshuarit .....	119
Ëndrra e vegime .....	121
Të rrezikojmë së bashku .....	124

## KAPITULLI I SHTATË

Baritorja e të rinjve .....	128
Një baritore sinodale .....	129
Linja të mëdha veprimi .....	131
Mjedise të përshtatshme .....	135
Baritorja e institucioneve edukative .....	139
Fusha të ndryshme të zhvillimit baritor .....	142
Një baritore rinore popullore .....	147
Gjithmonë misionarë .....	153
Shoqërimi nga ana e të rriturve .....	154

## KAPITULLI I TETË

Thirrja .....	159
Thirrja në miqësinë me Të .....	160
Të jesh për të tjerët .....	162
Dashuria dhe familja .....	165
Puna .....	169
Thirrje në një përkushtim të veçantë .....	174

## KAPITULLI I NËNTË

Shoshitja .....	176
Si ta shoshitësh thirrjen tënde .....	178
Thirrja e Mikut .....	181
Dëgjimi dhe shoqërimi .....	183
Dhe për të përfunduar... një dëshirë .....	188
SHËNIME .....	189
TREGUESI .....	201